



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA PUKË
KËSHILLI BASHKIAK



Pukë, më 12.02.2026

Nr. 172/2 Prot :

VENDIM

Nr.06 , datë 11.02. 2026

“Për miratimin e paketës FISKALE 2026”

Këshilli i Bashkisë në mbledhjen e tij të datës **11.02. 2026** , në zbatim të pikës 3, të nenit 34, pikës 1, 2, 3, 4, dhe 5 të nenit 35, germës “ f ”, të nenit 54, pikës 3, të nenit 55, të ligjit nr.139 /2015, " Për vetëqeverisjen vendore ", ligjit nr.68 / 2017, datë 27.04.2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ", ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), ligjit nr.25 /2022, " Për mbështetjen dhe zhvillimin e startu – eve " (i ndryshuar), ligjit nr.29 /2023, " Për tatimin mbi të ardhurat " (i ndryshuar) , ligjit nr.9723, datë 03.05.2007 " Për Qendrën Kombëtare të Biznesit " (i ndryshuar), ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar), ligjit nr.10081, datë 23.02.2009 " Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar), ligjit nr.10304, datë 15.07.2010 " Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë ", ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 " Për taksat kombëtare " (i ndryshuar), ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 " Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje " (i ndryshuar) , ligjit nr.107 /2014, " Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit " (i ndryshuar) , ligjit nr.24 /2017, datë 09.03.2017 " Për administrimin e ujitjes dhe kullimit ", ligjit nr.93 /2015, " Për turizmin " (i ndryshuar), ligjit nr.10465 /2011 " Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar), ligjit nr.8450, datë 24.2.1999 " Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre " (i ndryshuar), ligjit nr.57, datë 30.4.2020 " Për pyjet ", ligjit nr.9693, datë 19.3.2007 " Për fondin kullosor " (i ndryshuar), ligjit nr.10279, datë 20.05.2010 " Për kundravajtjet administrative ", ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 " Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore " (i ndryshuar), ligjit nr.10463, datë 22.09.2011 " Për menaxhimin e integruar të mbetjeve " (i ndryshuar), ligjit nr.152 /2015, " Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin " (i ndryshuar), ligjit nr.89 /2022 " Për Policinë Bashkiake ", ligjit nr.8378, datë 22.07.1998 " Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë " (i ndryshuar), VKM nr.132 datë 7.3.2018, " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës , si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës " (i ndryshuar) , VKM nr.315, datë 11.05.2022 " Për përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që duhet të plotësojnë startu – et dhe lehtësuesit e startu – eve , si dhe miratimin e procedurave dhe afateve të thirrjes për fitimin e granteve dhe masave lehtësuese ", VKM nr.783, datë 10.11.2011 " Për procedurat e ndarjes së të ardhurave të taksës vjetore të mjeteve të përdorura me njësitë e qeverisjes vendore " (i ndryshuar), VKM nr.438, datë 08.06.2016 " Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore " (i ndryshuar) , VKM nr.297, datë 17.5.2023 " Për miratimin e procedurave për kryerjen e veprimtarive të shfrytëzimit në fondin pyjor kombëtar nga individë apo subjekte të licencuara ", VKM nr.559 datë 29.7.2022 " Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim / përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore " (i ndryshuar) , VKM nr.396, datë 21.06.2006 " Për kriteret e transferimit dhe të përdorimit të pyjeve nga njësitë e qeverisjes vendore ", VKM nr.632, datë 11.06.2009 " Për tarifat në sektorin e kullotave " (i ndryshuar) , VKM nr.54, datë 05.02.2014 " Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore " (i ndryshuar) , VKM nr.922, datë 09.12.2015 " Për përcaktimin për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 05.02.2014 të Këshillit të Ministrave " (i ndryshuar), e kriterëve, dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore " VKM nr.344, datë 19.4.2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970, datë 2.12.2015 të KM " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe

nënprodukteve të saj ", VKM nr.319, datë 31.5.2018 " Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve " (i ndryshuar), VKM nr.575, datë 24.06.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte ", VKM nr.707, datë 16.10.2016 " Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, të ofruar nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi, në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH-së ", VKM nr.1108, datë 30.12.2015 " Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të ujërave të Bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve rajonale të Kullimit ", VKM nr.7, datë 4.01.2012 " Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së rentës minerare " (i ndryshuar), VKM nr. 408, datë 13.05.2015 " Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit " (i ndryshuar), Udhëzimit të MF nr.1, datë 12.01.2007 " Për përcaktimin e veprimtarive që trajtohen si veprimtari tregëtare apo shërbimi, ambulante si dhe procedurat e regjistrimit të tyre në organin tatimor " (i ndryshuar), Udhëzimit të Përbashkët (Ministri i Financave & Ministri i Drejtësisë) nr.665/1, datë 03.09.2015 " Për përcaktimin uniformitetit të standarteve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore ", Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar), Udhëzimit nr.17, datë 20.06.2022 " Për përcaktimin e uniformitetit minimal të standardeve procedurale për mbledhjen e detyrimeve të taksave e tarifave vendore " Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008 " Për taksat kombëtare " (i ndryshuar), Udhëzimit nr.5, datë 30.01.2006 " Për tatimin mbi të ardhurat " (i ndryshuar), Udhëzimit nr.26, datë 08.09.2023 " Për tatimin mbi të ardhurat ", Udhëzimit nr.29, datë 30.7.2018, " Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme " (i ndryshuar), Udhëzimit nr.32, datë 31.12.2013 " Për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël " (i ndryshuar), si dhe shkresës nr.30/2 prot, datë 06.05.2025 të Drejtorisë Përgjithshme të Taksës Pasurisë " mbi problematikat e konstatuara në Vendimin e Këshillit Bashkiak të Bashkisë Pukë nr.65, datë 27.12.2024 ", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak pas shqyrtimit;

V E N D O S I :

I. Të miratojë Paketën fiskale 2026 si vijon:

KAPITULLI I- rë : **TAKSAT VENDORE :**

Ky kapitull trajton taksat vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët :
- Lloji, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështet e pagimit, kohat kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë .

TAKSA MBI PASURINË E PALUAJTSHME:

PËRKUFIZIME :

" Pasuri e paluajtshme ", sipas nenit 3, pika 2 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), janë trualli, toka bujqësore dhe ndërtesat mbi dhe nën tokë, sipas përcaktimit të Kodit Civil dhe legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme .
" Kadastra Fiskale ", sipas nenit 3, pika 2.1 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), është regjistri qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme që shërben për qëllime të administrimit të taksës mbi pasurinë e paluajtshme .
" Zyrë e taksave ", sipas nenit 3, pika 3 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), është njësi organizative që, me Vendimin e Këshillit të Bashkisë, ngarkohet për administrimin e taksave vendore .
" Niveli tregues i taksës ", sipas nenit 3, pika 5 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), janë nivelet e taksave të parashikuara sipas këtij ligji, si dhe në anekset bashkëlidhur ligjit .
" Arka regjistruese ", sipas nenit 3, pika 6 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), janë kasat regjistruese elektronike, të detyrueshme për lëshimin e kuponave tatimorë nga biznesi, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave dhe me udhëzimin e Ministrit të Financave .

❖ " Përcaktimi dhe llojet ", neni 20 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore "
(i ndryshuar).

1. Taksës mbi pasurinë e paluajtshme i nënshtrohen të gjithë personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, pronarë apo përdorues të pasurive të mësipërme, në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre pasurive. Bëjnë përjashtim rastet kur në ligj parashikohet ndryshe. Detyrimin për taksën mbi pasurinë e paluajtshme e ka, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente pronësie.

2. Në taksat mbi pasurinë e paluajtshme përfshihen:

a) taksa mbi ndërtesat;

b) taksa mbi tokën bujqësore;

c) taksa mbi truallin.

3. Brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat rajonale të regjistrimit të pasurisë së paluajtshme u ofrojnë bashkive dhe të dhënat e regjistrimit elektronik të pasurisë.

❖ " Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme ", neni 21 nr.9632 /2006
" Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar).

1. Taksat llogariten si detyrim vjetor i taksapaguesit. Nëse pasuria e taksueshme krijohet, tjetërsohet ose zhduket brenda kësaj periudhe, detyrimi i taksapaguesit llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e të drejtës së pronësisë.

2. Këshilli i Ministrave miraton metodologjinë për përcaktimin e vlerës së tatueshme të pasurisë së paluajtshme - ndërtesa.

2.1 Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 1, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

5. Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:

a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kritereve të përcaktuara në nivel kombëtar;

b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.

TAKSA MBI NDËRTESET :

❖ " Taksa mbi ndërtesat ", neni 22 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore ",
(i ndryshuar).

1. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendas apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.

3. Taksës mbi ndërtesat i nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlllogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzim i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

5. Taksa vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Pagesa e taksës bëhet çdo muaj apo për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave .

BAZA E TAKSËS :

❖ " Baza e taksës ", neni 22/1 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore ", (i ndryshuar).

Baza e taksës mbi ndërtesat është vlera e ndërtesës, që llogaritet në përputhje me metodologjinë dhe procedurat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave, në bazë të vjetërsisë së ndërtesës, mund të specifikojë nënkategori përkatëse.

SHKALLA E TAKSËS :

❖ " Shkalla e taksës ", neni 22/2 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore ", (i ndryshuar) .

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si përqindje e bazës së taksës, është si më poshtë:

- a) 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim;
- b) 0,2% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;
- c) 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

❖ KATEGORITE E NDERTESAVE DHE NIVELI TAKSËS MBI NDERTESAT :

Tab.I

Nr.	Ndertesat qe perdoren, shfrytezohen per banim, si dhe ndertesat qe perdoren shfrytezohen per veprimtari ekonomike .	Njesia	Vlera e takses per ndertesat qe perdoren, shfrytezohen per banim .		Vlera e takses per ndertesat qe perdoren, shfrytezohen per veprimtari ekonomike .	
			Njesia	Nj.Ad.	Njesia	Nj.Ad.
			Ad. Pukë	Tjera	Ad. Pukë	Tjera
			Bashkia Pukë ka reduktuar normën e tatimit mbi pasurinë e paluajtshme për ndërtesa banimi / apartamente) me (-30 %) për të gjitha Njësitë Administrative		Bashkia Pukë ka reduktuar çmimin mesatar referues me (- 35%) për Njësitë Administrative Gjegjan, Rrape, Qerret dhe Qelez	
1	Ndërtesa banimi	lekë/m ² /vit	7.7	5.01		
2	Ndërtesa të privatizuara me ligjin nr.7652 dt.23.12.1992 " Për privatizimin e banesave shtetërore " (i ndryshuar), vetem në rastin e shitjes së pare	lekë/m ² /vit	5.39	3.5		

	të pasurisë pas privatizimit. Në çdo rast tjetër të transferimit të pronësisë pas realizimit të shitjes së parë, përfshirë shitjet e mëvonshme, dhurimet, shkëmbimet apo forma të tjera të kalimit të pronësisë, zbatohet çmimi referues i plotë i zonës (100%), sipas legjislacionit në fuqi.					
3	Ndërtesa / sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi etj.	lekë/m ² /vit			66	42.9
4	Ndërtesa / sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume e të tjera të ngjashme me to.	lekë/m ² /vit	5.39	3.5	30.8	20.02
5	Ndërtesa / sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishine e hapur, ambiente sportive të hapura e të tjera të ngjashme me to.	lekë/m ² /vit	2.31	1.5	13.2	8.58
6	Ndërtesa / sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale si dhe objekte të tjera të ngjashme me to.	lekë/m ² /vit			22	14.3
7	Ndërtesa / sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori apo veprimtari mbështetëse e të tjera të këtij lloji.	lekë/m ² /vit			13.2	8.58

❖ " Informacioni lidhur me taksën mbi ndërtesën ", neni 22/3 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore ", (i ndryshuar) .

Këshilli i Ministrave përcakton rregulla në lidhje me:

- natyrën dhe prioritetin e informacionit që do të përdoret në lidhje me përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat, në raste mospërputhjes të informacionit të marrë nga burime të ndryshme;
- prioritetin e të dhënave që do të përdoren në lidhje me vlerën e tatueshme.

❖ "Përgjegjësitë e Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë", neni 22/4 i ligjit nr.9632 /2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë :

- a) menaxhon regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
 - b) udhëheq, nga pikëpamja metodologjike, në lidhje me administrimin e taksës mbi pasuritë e paluajtshme;
 - c) vlerëson vlerën e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat me metodat e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe detyrimin për taksën e pasurisë ndërtesë.
- Këshilli i Ministrave vendos kritere dhe rregulla në lidhje me procedurat dhe elementet që përdoren për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.

❖ "Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore", neni 22/5 i ligjit nr.9632 /2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për administrimin e taksës mbi ndërtesat nën juridiksionin e saj, përmes ushtrimit të funksioneve të mëposhtme:
 - a) mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale;
 - b) përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale);
 - c) mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën;
 - d) korrigjimin e të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës, në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj.;
 - e) shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.
2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbledhet nëpërmjet agentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.
3. Të ardhurat e mbledhura nga taksa mbi pasurinë e paluajtshme derdhen për llogari të buxhetit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në territorin e së cilës ndodhet pasuria, dhe përdoren në përputhje me ligjin "Për financat e vetëqeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë".

❖ "Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave", neni 24 i ligjit nr.9632 /2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit përpagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

❖ "Pronat që shtrihen në territorin e më shumë se një njësie të qeverisjes vendore", neni 25 i ligjit nr.9632 /2006 "Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).

Në rast se një pronë shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie, pavarësisht nga vendbanimit i pronarit, secila njësi vendore e trajton pjesën e pronës, që ndodhet brenda territorit të vet, si pronë më vete dhe zbaton mbi të dispozitat e këtij ligji.

▪ **Neni 1 i VKM Nr.132 /2018 (i ndryshuar)** .

❖ **Për qëllim të zbatimit të metodologjisë për përcaktimin e bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme " ndërtesë ", termat e mëposhtëm kanë kuptimin si më poshtë vijon :**

1. " **Çmim vlerësues** ", njësia matëse e vlerës për metër katror të sipërfaqes së ndërtimit të pasurisë së paluajtshme. Ky çmim mund të jetë çmimi i tregut ose çmimi i vlerësuar i përcaktuar me këtë metodologji.

2. " **Ndarje/nënndarje zonale** ", një rajon territorial brenda njësisë së vetëqeverisjes vendore me emër dhe numër kadastral unik. Këto ndarje/nënndarje paraqiten në parcela tokësore me kufij të përcaktuar, që i ndajnë ato nga njëra-tjetra.

3. " **Ndërtesë** ", objekti/objektet e ndërtuara mbi/nën sipërfaqen e tokës ose të lidhura me tokën dhe që përfaqëson një strukturë ndërtimore me një ose më shumë njësi pronësore, e cila është objekt i taksës mbi ndërtesën sipas përcaktimit të dhënë në ligj.

4. " **Ndërtesë e papërfunduar** ", objekti ndërtimor në tërësi ose/edhe ajo pjesë e ndërtesës ekzistuese, për të cilin zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi, por që nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

5. " **Njësi pronësore** ", ndërtesa ose pjesë e saj, e cila është në pronësi/përdorim të individit, të një personi fizik apo të një personi juridik, dhe që është e ndarë ligjërisht nga pronat e tjera të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë". Njësia pronësore mund të përdoret për qëllim banimi ose/edhe për qëllim veprimtarie ekonomike etj.

6. " **Ndarje e njësisë pronësore për banim** ", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim banimi.

7. " **Ndarje e njësisë pronësore për veprimtari ekonomike** ", pjesa e njësisë pronësore që përdoret për qëllim veprimtarie ekonomike.

8. " **Përdorues** ", individ, personi fizik ose personi juridik, që ka në përdorim ndërtesën/ njësinë pronësore për qëllime banimi, veprimtarie ekonomike apo për veprimtari joekonomike, pavarësisht nga fakti nëse kjo ndërtesë/njësi pronësore ka titull pronësie ose jo.

9. " **Regjistër qendror i bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme " (Kadastra fiskale)** ", sistemi qendror i bazës së të dhënave, i cili shërben për hedhjen, përpunimin, korrektimin e të dhënave, të cilat lidhen me pasurinë e paluajtshme dhe që shërbejnë për efekt të llogaritjes së shumës së taksës së pasurisë së paluajtshme për t'u paguar nga çdo taksapagues. Ky regjistër ofron informacion për përdoruesit.

10. " **Taksapagues** ", çdo individ, person fizik ose juridik, vendës ose i huaj, pronar apo përdorues i pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave. Detyrimin për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme "ndërtesë" e kanë, sipas rastit, pronari ose bashkëpronari, sipas pjesës që zotëron, apo përdoruesi i pasurisë së paluajtshme, për pasuritë që nuk janë të pajisura me dokumente të pronësisë, personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

11. " **Vlerë e pasurisë** ", vlera aktuale e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore e njohur me dokumente ligjore ose vlera e përcaktuar me një nga metodat e përshkruara në këtë metodologji. Vlera e pasurisë është baza e taksueshme mbi të cilën aplikohet shkalla e taksës së pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore. Vlera e pasurisë llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror me sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore.

12. " **Veprimtari ekonomike** ", çdo veprimtari e kryer nga prodhuesit, tregtarët, personat që furnizojnë mallra dhe shërbime, përfshirë veprimtaritë nxjerrëse, industriale, tregtare, të shërbimit, bujqësore dhe veprimtaritë profesionale. Veprimtari ekonomike konsiderohet, gjithashtu, shfrytëzimi i pasurisë së trupëzuar ose të patrupëzuar, me qëllim realizimin e të ardhurave me karakter të vazhdueshëm .

▪ **Neni 2 i VKM Nr.132 /2018 (i ndryshuar)** .

▪ " Metodologjia për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme (ndërtesa) ".

1. " Përcaktimi i çmimit vlerësues dhe i sipërfaqes së ndërtesës/njesisë pronësore ". Përcaktimi i vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore bazohet mbi prioritetet e vlerësimit, duke ndjekur një radhë të caktuar. Baza e vlerësimit mbështetet te vetëdeklarimi, si një detyrim për çdo taksapagues, për të vijuar më tej edhe me metodat alternative, nëse vetëdeklarimi nuk bëhet, nuk është i saktë apo nuk disponohen të dhëna të plota për një vlerësim të drejtë të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore, që duhet të taksohet. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për efekt të përcaktimit të bazës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesë, ndjekin këtë radhë vlerësimi:

1.1 " Vetëdeklarimi ". Çdo taksapagues duhet të vetëdeklarojë të dhënat për pasurinë e tij të paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që ka në pronësi apo në përdorim. Vetëdeklarimi bëhet pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore apo çdo institucioni të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të marrë dhe për të përpunuar informacionin e vetëdeklarimit të taksapaguesit, për qëllim të zbatimit të legjislacionit përkatës të taksës mbi pasurinë e paluajtshme. Në rast se vlera e vetëdeklaruar nga taksapaguesi rezulton e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmim e vlerësuar, të përcaktuar me këtë metodologji, si vlerë e bazës së taksës do të merret vlera më e lartë. Në fazën fillestare të zbatimit të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, mund të merren në konsideratë dhe të përdoren të dhënat e siguruara nga institucione të autorizuar nga qeveria apo njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat shërbejnë për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme dhe përcaktimin e bazës së taksës.

1.2 " Përcaktimi i çmimit të vlerësuar dhe i sipërfaqes së ndërtesës, bazuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme të mbajtur nga zyrat vendore (ZVRPP) ". Për përcaktimin e bazës së taksës për ndërtesën/njësinë pronësore, si referencë, në këtë rast, do të shërbejë vlera e përcaktuar nga rivlerësimi i pasurisë të regjistruar pranë ZVRPP-ve. Nëse në informacionin e marrë nga ZVRPP-ja konstatohet se për ndërtesën/njësinë pronësore është kryer një transaksion shitblerjeje gjatë 3 viteve të fundit, atëherë si bazë e taksueshme do të merret vlera më e lartë midis transaksionit dhe vlerës të regjistruar në ZVRPP.

1.3 " Përcaktimi i çmimit të vlerësuar sipas çmimeve mesatare të shitblerjes së ndërtesave/ njësive pronësore ". Kur vlerësimi sipas pikave 1.1 dhe 1.2 më lart është i pamundur, çmimi i vlerësuar për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore do të korrespondojë me çmimin mesatar referues të ndërtesave që përdoren për qëllime banimi sipas qyteteve, të përcaktuara në aneksin 1 që i bashkëngjitet dhe është pjesë përbërëse e këtij vendim . Për nënkategorizime të ndërtesave, që nuk shërbejnë për banim, sipas qëllimit të përdorimit, zbatohen çmimet mesatare për metër katror sipërfaqe ndërtimi, të përcaktuara në aneksin 2 që i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij. Nëse çmimi për metër katror për banesë/njësi pronësore, i vënë në dispozicion nga ZVRPP-ja, dhe çmimet minimale fiskale janë të ndryshme, atëherë merret si çmim vlerësues ai çmim që ka vlerën më të lartë.

2. " Vlera e pasurisë së paluajtshme (ndërtesë), referuar verifikimeve në terren ". Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në përputhje me kompetencat e kuadrit ligjor në fuqi, kryejnë korrektime në regjistrin e bazës së të dhënave. Korrektime kryhen bazuar në verifikimet periodike në terren për sipërfaqen e ndërtesës/ njesisë pronësore. Verifikimi në terren shërben edhe për të regjistruar për herë të parë ndërtesa/njësi pronësore ose nënndarje të saj. Në këtë rast, njësitë e vetëqeverisjes vendore kërkojnë informacion nga burime zyrtare, nëse ka, për sipërfaqen e ndërtesës/njesisë pronësore apo nënndarjen dhe e krahasojnë me verifikimin e kryer. Nëse nuk sigurojnë informacione lidhur me sipërfaqen e ndërtesave të identifikuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë vetëvlerësimin e ndërtesës/njesisë pronësore mbi sipërfaqen e verifikuar në terren. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas procedurave të përcaktuara në këtë metodologji, në çdo rast, pasi bëjnë vlerësimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme, hedhin të dhënat në regjistrin e bazës së të dhënave, për efekt të përcaktimit të bazës së taksës dhe llogaritjes së shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.

2.1 " Sipërfaqja e prezumuar ". Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e ndërtesës/njesisë pronësore, përdoren vlerat referuese për sipërfaqe, si më poshtë vijojnë:

- a) 100 (njëqind) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim;
- b) 70 (shtatëdhjetë) metër katror sipërfaqe për njësi pronësore, për ndërtesat për banim, të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992, "Për privatizimin e banesave shtetërore", të ndryshuar. Për ndërtesat e tjera, të cilat nuk shërbejnë për qëllime banimi, njësitë e vetëqeverisjes vendore bëjnë verifikimin në terren, për të përcaktuar sipërfaqen dhe për të llogaritur bazën e taksës. Kur gjatë verifikimeve në terren konstatohen dëmtime të ndërtesave për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmytje etj.), të cilat ndryshojnë vlerën e kësaj pasurie, njësia e vetëqeverisjes vendore, sipas rastit që i paraqitet, ngre një komision, i cili vlerëson dhe korrekton vlerën e ndërtesës. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet ndërtesa e dëmtuar.

3. " Nënndarja zonale / nënzonale brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ".

Njësitë e vetëqeverisjes vendore mund të miratojnë nënndarje zonale / nënzonale të territorit, brenda juridiksionit tyre, për zbatimin e niveleve të shkallës së taksës brenda kufijve plus 30 (tridhjetë) për qind ose minus 30 (tridhjetë) për qind.

Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore, jo më shpesh se një herë në vit, për banesat në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të qeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.115 /2014, mund të reduktojë çmimin mesatar referues të përcaktuar në aneksin 1 , deri në masën minus 35 (tridhjet e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Nivelet e miratuara sipas zonave / nënzonave të teritorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore i bëhen të ditura zyrtarisht edhe Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë .

4. " Vlera e pasurisë së paluajtshme për ndërtesat e papërfunduara në shkelje të afatit të lejes së ndërtimit ".

Për ndërtesat e pajisura me leje ndërtimi, por që nuk kanë arritur të përfundojnë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi, përcaktimi i bazës së taksueshme bazohet mbi koston e parashikuar të ndërtimit, sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga njësia përkatëse e vetëqeverisjes vendore apo KKT-ja. Në këtë rast, vlera e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet për të gjithë ndërtesën, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi, pavarësisht fazës në të cilën gjendet ndërtesa e papërfunduar. Baza e taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës të përcaktuar me ligj, shumëzuar me koston e ndërtimit të parashikuar në lejen e miratuar të ndërtimit. Në rast kur ndërtesa përbëhet nga më shumë se një njësi pronësore, të parashikuara për t'u përdorur për qëllime të ndryshme apo për t'u tjetërsuar në pronësi të më shumë se një pronari/përdoruesi, si bazë e taksës do të shërbejë kostoja e plotë e ndërtimit të të gjitha njësive përbërëse të ndërtesës, pavarësisht fazës në të cilën gjendet e gjithë ndërtesa e papërfunduar. Në qoftë se njësitë e ndërtesës, bazuar në lejen e miratuar të ndërtimit, janë parashikuar për qëllime të ndryshme përdorimi (për shembull, disa për banim dhe disa për veprimtari ekonomike/joekonomike), vlera e pasurisë së paluajtshme për përcaktimin e bazës së taksës së ndërtesës llogaritet në masën 30 (tridhjetë) për qind të shkallës së taksës së përcaktuar me ligj, sipas llojit të përdorimit, shumëzuar me koston e ndërtimit për njësi të ndërtesës. Në rast se zhvilluesit kanë lidhur kontratë shitjeje për tjetërsimin e pronësisë së ndërtesës së papërfunduar apo të njësive të veçanta të saj, si bazë e vlerësimit të pasurisë së paluajtshme, për efekt të llogaritjes së taksës së ndërtesës, do të shërbejnë kontratat e shitjes. Në qoftë se nga krahasimi rezulton se vlera e kontratave të shitjes është e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmimin vlerësues, atëherë si bazë e taksës përcaktohet vlera më e lartë. Kur nga verifikimi në terren rezulton se ndërtesa apo njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim/shfrytëzim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet e plotë për pjesën në përdorim/shfrytëzim. Në këtë rast, baza e taksueshme llogaritet me koston e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe me çmimet vlerësuese për pjesët e vëna në përdorim. Për pjesë të ndërtesës të vëna në përdorim, baza e taksës do të jetë e plotë. E njëjta situatë vlen edhe kur nuk është dhënë leja e shfrytëzimit të ndërtesës apo nuk është bërë regjistrimi në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Në të gjitha rastet e përmendura në pikën 4 të këtij neni, personi që ka për detyrim pagesën e taksës së llogaritur është zhvilluesi. Në rastin kur njësi të

veçanta të ndërtesës janë vënë në përdorim dhe taksa paguhet e plotë, paguesi i taksës së llogaritur është përdoruesi.

5. " Llogaritja e shumës së taksës së ndërtesës/ njësisë pronësore ". Njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke përdorur të dhënat e mbledhura për ndërtesën/njësinë pasurore, përcaktojnë bazën e taksës dhe llogarisin shumën e taksës vjetore të ndërtesës për t'u paguar nga çdo taksapagues. Baza e llogaritjes së taksës së ndërtesës është vlera e ndërtesës/njësisë pronësore, përcaktuar me një nga metodat e parashikuara në këtë metodologji. Për efekt të llogaritjes së taksës për ndërtesën/ njësi pronësore, baza e taksës shumëzohet me shkallën në përqindje të taksës së miratuar me ligj, sipas kategorive të ndërtesave, si më poshtë:

a) **0,05%**, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për banim;

b) **0,2%**, për ndërtesën/njësinë pronësore që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike;

c) **30%** e shkallës së taksës përkatëse, për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë, sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

6. " Procedura e mbledhjes së informacionit nga verifikimi në terren " . 6.1) Verifikimi në terren për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme bëhet, në çdo rast, me urdhër të titullarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet ndërtesa/njësia pronësore që do të vlerësohet. Urdhri i verifikimit përmban: a) të dhënat identifikuese për ndërtesën/njësinë pronësore (adresën, njësinë administrative, vendndodhjen, pronarin/përdoruesin etj.) dhe taksapaguesin (emrin e individit, personin fizik, personin juridik); b) qëllimin e kryerjes së procesit të vlerësimit të ndërtesës/njësisë pronësore; c) kohën kur do të kryhet verifikimi dhe afatin e mundshëm për procesin e verifikimit; ç) emrin/emrat e punonjësve të njësisë së vetë-qeverisjes vendore, që do të kryejnë verifikimin; d) datën dhe orën kur punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore do të paraqiten për të kryer verifikimin. Në qoftë se procesi i verifikimit kërkon plotësimin e formularëve përkatës, këta formularë i dërgohen paraprakisht personit të taksueshëm, së bashku me kopjen e urdhrin për verifikim. Urdhri për njoftimin e kryerjes së procesit të verifikimit dërgohet me postë ose dorazi, kundrejt firmës së personit të taksueshëm, që e ka marrë në dorëzim. Në rast të dërgimit me rrugë postare, konsiderohet se urdhri është marrë në dorëzim pas 10 (dhjetë) ditëve të dorëzimit të tij në zyrën postare. **6.2)** Paraprakisht, në njoftimin për kryerjen e verifikimit, taksapaguesi duhet të njihet me objektin e procedurës së verifikimit në vend, arsyet për të cilat kërkohet të kryhet ky verifikim, të drejtat e taksapaguesit për të shprehur mendimet, vërejtjet apo kundërshtitë lidhur me procesin e verifikimit të kryer nga punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore në përfundim të këtij procesi, si dhe të informohet se, në rast moskryerjeje të këtij procesi, njësia e vetëqeverisjes vendore ka të drejtën të bëjë vlerësimin me metoda alternative dhe të përcaktojë shumën e taksës vjetore për t'u paguar mbi bazën e këtij vlerësimi. **6.3)** Në rast të mosgjendjes së personit të taksueshëm në ditën dhe orën e caktuar për kryerjen e procesit të verifikimit, njësia e vetëqeverisjes vendore bën njoftim të dytë dhe, nëse përsëritet e njëjta situatë, punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore bëjnë vlerësimin, duke përdorur metodat alternative të përcaktuara në këtë metodologji. **6.4)** Në rastin e verifikimit në terren, punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të detyruar të hartojnë aktin e verifikimit, si dhe të shënojnë datën e përfundimit të procesit të verifikimit, emrin, mbiemrin bashkë me firmën në fund të aktit të plotësuar prej tyre. **6.5)** Punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore janë të detyruar të informojnë taksapaguesin mbi rezultatin e verifikimit, duke e lexuar me zë të qartë dhe në prani të tij përmbajtjen e materialit të shkruar në aktin e verifikimit dhe, në përfundim, të kërkojnë edhe kundërfirmën prej taksapaguesit, për sa përmban akti i verifikimit. Taksapaguesi ka të drejtë të bëjë shënimet e veta përkatëse, nëse dëshiron, lidhur me përmbajtjen e aktit të verifikimit, vërejtjet apo kundërshtitë që ka. Gjithashtu, taksapaguesi, krahas emrit, mbiemrit dhe firmës, vendos dhe datën kur ai ka bërë nënshkrimin e tij. **6.6)** Kur taksapaguesi pengon punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore të ushtrojnë detyrën e tyre, sipas urdhrin të lëshuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore për këtë qëllim, ndaj tyre do të llogaritet taksa e plotë. Në këtë rast, sipërfaqet do të vlerësohen duke përdorur metodat alternative të vlerësimit, siç përcaktohet në këtë

metodologji. 6.7) Në rastet kur nga verifikimi në terren konstatohen ndërtesa/njësi pronësore për të cilat nuk ka informacion paraprak të plotë ose të pjesshëm, atëherë punonjësi i njësisë së vetë-qeverisjes vendore, me anë të një procesverballi, merr masa për plotësimin e të dhënave identi-fikuese, si më poshtë: **a)** Adresën, koordinatat e vendndodhjes gjeo-grafike, sipërfaqen e ndërtesës/njësisë pronësore; **b)** Qëllimin e përdorimit të ndërtesës/njësisë pronësore; **c)** Të dhënat identifikuese të siguruara për taksapaguesin; **ç)** Emrin/emrat e punonjësve të njësisë së vetëqeverisjes vendore që kanë bërë verifikimin; **d)** Datën dhe orën kur punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore kanë bërë verifikimin; **dh)** Çdo informacion tjetër të nevojshëm, që shërben për identifikimin e ndërtesës/njësisë pronësore, taksapaguesin dhe përcaktimin e bazës së taksueshme. Në këtë rast, taksapaguesi duhet të njoftohet për detyrimin e taksës së llogaritur. 6.8) Afati kohor i hedhjes së të dhënave të siguruara nga verifikimi në terren në sistemin e bazës së të dhënave të pasurisë së paluajtshme nuk duhet të jetë më vonë se 30 ditë kalendarike nga dita e mbajtjes së aktit të verifikimit. Në çdo rast të ndryshimit të të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave, qoftë nga verifikimi në terren, qoftë dhe si rezultat i korrektimit apo i vendimit të strukturës vendore të apelimit apo pas një vendimi të formës së prerë të marrë nga Gjykata Administrative, hedhja e të dhënave nuk duhet të jetë më vonë se 30 (tridhjetë) ditë kalendarike nga marrja e vendimit. 6.9) Hedhja e të dhënave në sistemin e bazës së të dhënave nuk duhet të dëmtojë funksionalitetin e sistemit. Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, nëse konstaton se hedhja e të dhënave mund të dëmtojë sistemin, ndërhyr dhe realizon hedhjen e të dhënave në sistem.

7. " **Verifikimi periodik në terren i pasurive të paluajtshme (ndërtesa) "** . Njësia e vetëqeverisjes vendore gëzon të drejtën të bëjë çdo vit verifikime në terren deri në 20 (njëzet) për qind të territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore. Në këtë rast, procesi i verifikimit shërben për verifikimin e ndryshimeve të mundshme në ndërtesat/njësitë pronësore ekzistuese, të cilat ndikojnë në ndryshimin e vlerës së pasurisë së paluajtshme dhe, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar. Të tilla ndryshime lidhen me zgjerim të sipërfaqes së ndërtesës/njësisë pronësore, shtesat në kate, përmirësime strukturore, tjetërsim të pronësisë, ndryshim të përdorimit dhe që kërkon ndryshimin e shkallës së taksës, përjashtimin nga taksa apo të humbjes së të drejtës së përjashtimit nga taksa etj. Gjithashtu, ky proces shërben dhe për identifikimin e ndërtesave/njësisve pronësore të reja, të pahedhura në sistem. Në rast të verifikimit të ndërtesave/njësisve pronësore që nuk rezultojnë në sistemin qendror të të dhënave, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të realizojë regjistrimin e plotë të tyre, duke plotësuar të gjitha elementet e informacionit të kërkuar nga sistemi. Në të gjitha rastet e mësipërme, njësia e vetëqeverisjes vendore duhet të bëjë me dije subjektin taksapagues për detyrimin e lindur.

8. " **Verifikimi i të dhënave nga ana e nëpunësit përgjegjës në bashki për taksën e pasurisë së paluajtshme ndërtesë "** . Nëpunësi përgjegjës, për taksën mbi ndërtesën në njësinë e vetëqeverisjes vendore, ka të drejtën dhe detyrimin të bëjë rishikimin dhe verifikimin e të gjithë dokumentacionit të mbledhur gjatë procesit të verifikimit në terren, të aktit të verifikimit të mbajtur, si dhe të konfirmojë saktësinë e tyre. Në rast se dokumentacioni përmban gabime, mangësi apo pasaktësi, ai u kërkon punonjësve, që kanë plotësuar dokumentacionin, rishikimin e tij, si dhe, nëse është e nevojshme, përsëritjen e procedurës së verifikimit.

9. " **Korrigjimi i të dhënave në lidhje me llogaritjen e taksës në rastet e saktësimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale dhe çmimet përkatëse "** . Taksapaguesi, në çdo kohë, kur gjykon se vlerësimi i pasurisë së tij të paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi, është jo i saktë, ka të drejtë të kërkojë korrigjimin e detyrimit. Taksapaguesi, pas marrjes së njoftimit të detyrimit për taksën e pasurisë, kur nuk është dakord me këtë vlerësim, ka të drejtë të bëjë kërkesë për korrigjimin e vlerës: a) në zyrën tatimore vendore të njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse, në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme "ndërtesë", të shoqëruar dhe me dokumentacionin justifikues; ose b) në zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra, shërbimi i korrigjimit ofrohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore me punonjësit e saj. E drejta ose jo e korrigjimit të vlerës përfundim-tare të pasurisë së paluajtshme "ndërtesë" do të përcaktohet pas shqyrtimit të ankimit nga struktura e autorizuar pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe marrjes së një vendimi përfundimtar. Zyra

tatimore vendore, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, bën shqyrtimin e kërkesës së subjektit në lidhje me marrjen ose jo në konsideratë të saj, bën korrigjimin, nëse vlerësimi fillestar ka pasur gabime dhe i kthen përgjigje me shkrim taksapaguesit.

10. " Ankimimi administrativ dhe ankimimi gjyqësor ". Nëse edhe pas marrjes së përgjigjes në lidhje me të drejtën e korrigjimit, taksapaguesi nuk bie dakord me qëndrimin e zyrës tatimore pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore, ai ka të drejtë që, bazuar në nenin 7, "Ankimimi", të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar, t'i drejtohet strukturës vendore të apelimit tatimor të ngritur për këtë qëllim pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore. Struktura vendore e apelimit tatimor jep qëndrimin e saj brenda afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin tatimor. Nëse taksapaguesi përsëri nuk bie dakord me vendimin e dhënë nga struktura vendore e apelimit tatimor, i drejtohet Gjykatës Administrative. Vendimi i Gjykatës Administrative konsiderohet përfundimtar dhe do të shërbejë për korrigtimin e vlerës së bazës së taksueshme, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi.

11. " Lindja e detyrimit për taksën e pasurisë ndërtesë/njësi pronësore pas konstatimit të ndryshimeve nga verifikimi në terren ". Në rastet kur nga verifikimet në terren rezulton ndryshim në vlerën e bazës së taksës, shuma e taksës së llogaritur reflektohet në shumën e taksës për t'u paguar, nisur nga dita e konstatimit në terren të mbajtur në aktin e verifikimit përkatës. Në çdo rast, akti i verifikimit duhet të jetë i firmosur nga taksapaguesi, të cilit i është konstatuar ky ndryshim gjatë verifikimit të kryer.

12. " Ndryshimi i përdorimit të ndërtesës nga sa është regjistruar në sistemin e bazës së të dhënave". Në qoftë se njësiti e vetëqeverisjes vendore konstatojnë ndryshime të përdorimit të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore apo pjesë të njësisë pronësore, të cilat sjellin, për pasojë, edhe ndryshimin e vlerës së bazës së taksës, për rrjedhojë, edhe të shumës së taksës për t'u paguar nga taksapaguesi, shuma e taksës për t'u paguar, pas ndryshimit të konstatuar për pjesën e mbetur të vitit, korrigjohet dhe mbledhja e taksës bëhet për shumën faktike të taksës së korrigjuar. Ndryshimet për detyrimin për t'u paguar fillojnë nga data e konstatimit të mbajtur në aktin e verifikimit. Në çdo rast, akti i verifikimit duhet të jetë i firmosur nga taksapaguesi, të cilit i është konstatuar ky ndryshim gjatë verifikimit të kryer.

▪ **Neni 3 i VKM Nr.132 /2018 (i ndryshuar)** .

❖ **" Nënkategori specifike ndërtesash dhe qëllimi i përdorimit "**

Nënkategorizimi i ndërtesave/njësi pronësore që nuk përdoren për banim, sipas qëllimit të përdorimit dhe të shfrytëzimit të tyre, përcaktohen në aneksin 2, bashkëngjitur këtij vendimi. Nënkategoritë e ndërtesave/njësi pronësore, që shfrytëzohen për banim/strehim, jepen si më poshtë:

1. Ndërtesa e cila u shërben njerëzve për nevoja themelore banimi, duke përfshirë shtëpitë, apartamentet, banesat dhe ndërtesat e ngjashme;

2. Garazhet e mbyllura;

3. Bodrumet;

4. Çdo ndërtesë tjetër e ngjashme, mbi apo nën tokë, që nuk përdoret apo shfrytëzohet për qëllime të tjera veç atij të banimit.

▪ **Neni 4 i VKM Nr.132 /2018 (i ndryshuar)** .

❖ **" Natyra e informacionit dhe e të dhënave që përdoret për përcaktimin e bazës së taksës mbi ndërtesat dhe informimi i publikut "** .

1. Burimet e informacionit (të dhënat parësore) Burimet e mundshme të informacionit, për efekt të administrimit të taksës mbi ndërtesat, janë: **a)** Të dhënat e vetëdeklaruara nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësinë e ndërtesës në pronësi/ përdorim të tij; **b)** Të dhënat e disponuara nga ZVRPP-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to; **c)** Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit; **ç)** Të dhënat e zyrave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave; **d)** Të dhënat e ALUIZNI-t për ndërtesat në proces legalizimi; **dh)** Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësiti e

vetëqeverisjes vendore; e) Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile; ë) Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të përmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtese, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin; f) Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së.

2. Informacioni për të dhënat parësore duhet të përmbajë: 2.1) Të dhënat identifikuese për pasurinë e paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore; 2.2) Destinacionin apo destinacionet e përdorimit të ndërtesës/njësi pronësore apo njësite të veçanta të tyre; 2.3) Të dhënat identifikuese për taksapaguesin; 2.4) Të dhënat mbi statusin juridik të taksapaguesit në lidhje me pasurinë objekt taksimi dhe pjesën e tij për t'u taksuar.

3. Të dhënat parësore për ndërtesat për efekt identifikimi dhe vlerësimi Të dhënat për ndërtesat përfshijnë: 3.1) Njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe njësinë administrative në territorin në juridiksion të të cilave ndodhet ndërtesa/njësia pronësore; 3.2) Zonën kadastrale ku përfshihet ndërtesa, të përcaktuar sipas legjislacionit specifik të fushës; 3.3) Adresën e saktë të ndërtesës/njesisë pronësore, ku përfshihet rruga, numri i ndërtesës (hyrja dhe apartamenti, kur ndërtesa është njësi pronësore në bashkëpronësi), si dhe të dhëna të tjera, që identifikojnë vendndodhjen e saktë të ndërtesës/njesisë pronësore; 3.4) Llojin e ndërtesës: a) Ndërtesë e veçantë; b) Ndërtesë në bashkëpronësi (e përbërë nga njësi pronësore, secila me pronar më vete); 3.5) Kufizimet e ndërtesës në të gjitha anët e saj; 3.6) Numrin e kateve të ndërtesës, i cili përfshin: a) Numrin e përgjithshëm të kateve mbi sipërfaqen e tokës; b) Numrin e përgjithshëm të kateve nën sipërfaqen e tokës; 3.7) Vitin e ndërtimit dhe sipërfaqen e ndërtuar; 3.8) Elemente të tjera identifikuese.

4. Sistemi qendror i llogaritjes së vlerës së bazës së taksueshme për pasuritë e paluajtshme duhet të përmbajë të dhënat për njësi pronësore, si më poshtë: 4.1) Numrin unik identifikues të pasurisë së paluajtshme; 4.2) Numrin e hyrjes, të apartamentit, të njesisë së veçantë të ndërtesës/njesisë pronësore dhe që i bashkëngjitet emrit të rrugës dhe numrit të hyrjes; 4.3) Katin ku ndodhet njësia pronësore; 4.4) Sipërfaqen në metër katror, që jep sipërfaqen e destinuar/shfrytëzuar për një qëllim të caktuar, të shprehur në metra katrorë gjithsej. Matja e sipërfaqes së njesisë pronësore bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara për këtë qëllim në legjislacionin e fushës. 4.5) Bodrumet dhe nënçatitë e ndërtesave/ njesisë pronësore, që, nga verifikimi në vend, rezultojnë se janë të destinuara apo shfrytëzohen për: a) magazinim të sendeve familjare, pa pasur ndonjë qëllim fitimi, regjistrohen me komentin "bodrum/nënçati (sipas rastit) për mbajtjen e sendeve familjare"; b) qëllime banimi, regjistrohen me komentin "për qëllim banimi"; c) qëllime fitimprurëse, regjistrohen me komentin "për qëllime fitimprurëse". Në rastet e shkronjave "a", "b" dhe "c", më lart, llogaritja e vlerës së njesisë pronësore bëhet më vete, kur pjesa e ndërtesës është si njësi më vete e veçuar e ndërtesës, edhe pse nuk është në pronësi të një personi të identifikuar, por është në përdorim dhe përdoret prej tij për një nga këto qëllime. Kur kjo njësi pronësore është në përdorim të përbashkët nga disa pronarë/përdorues të njesisë të tjera pasurore të së njëjtës ndërtesë, shuma e llogaritur e vlerës së bazës së taksës, si dhe pjesa takuese e taksës së llogaritur, përpjesëtohet në mënyrë të barabartë për të gjithë përdoruesit e saj. 4.6 Vitin e ndërtimit; 4.7 Zonën kadastrale të vlerësimit; 4.8 Kategorinë e vlerësimit sipas çmimeve minimale fiskale (vlerësuese); 4.9 Destinacionin e përdorimit: a) Banim; b) Tregti, shërbime; c) Prodhim, përpunim, magazinim, mbajtje apo mbarëshitim të gjësë së gjallë; e) E braktisur; d) E papërfunduar; dh) Të tjera, të paspecifikuara në klasifikimet si më sipër. 4.10 Koordinatat e GPS-së.

5. Sistemi qendror i llogaritjes së vlerës së bazës së taksueshme për pasuritë e paluajtshme duhet të përmbajë të dhënat për taksapaguesin, si më poshtë: 5.1) Numrin personal identifikues të pronarit/ përdoruesit të pasurisë së paluajtshme (taksapaguesit); 5.2) Emrin, atësinë, mbiemrin e personit taksapagues, pronarit/përdoruesit të pasurisë së paluajtshme; 5.3) NIPT-in/NUIS-in (për individët, personat fizikë apo personat juridikë që ushtrojnë veprimtarinë ekonomike në pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi); 5.4) Emrin e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të veprimtarisë ekonomike; 5.5) Emrin e përfaqësuesit juridik të subjektit të

taksueshëm: **5.6)** Adresën e vendndodhjes së pasurisë së paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi; **5.7)** Emrin e njësisë së vetëqeverisjes vendore (bashkisë), si dhe të njësisë administrative në territorin e së cilës gjendet pasuria e paluajtshme ndërtesë, objekt taksimi; **5.8)** Çdo të dhënë tjetër identifikuese, që plotëson identifikimin e saktë të personit të taksueshëm dhe vendndodhjen e pasurisë së paluajtshme, objekt taksimi.

6. Sistemi qendror i llogaritjes së vlerës së bazës së taksueshme për pasuritë e paluajtshme Akti i krijimit të sistemit qendror të llogaritjes së taksueshme për pasuritë e paluajtshme bëhet me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

7. Informimi i publikut **7.1)** Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të sqarojnë në mënyrë të vazhdueshme taksapaguesit në territorin e tyre lidhur me procedurat dhe kriteret për llogaritjen e taksës, të drejtat e taksapaguesve për korrigjim dhe apelim, mënyrën e pagesës, si dhe masat që zbatohen në rast mospagimi të taksës. **7.2)** Informimi i publikut i shërben transparencës së njësive të vetëqeverisjes vendore, por, njëkohësisht, shërben edhe për të mundësuar marrjen e informacionit në dobi të lehtësimit të procesit të vlerësimit të pasurisë së paluajtshme dhe objektivitetit të vlerës së llogaritur, nëpërmjet informacionit që vetë taksapaguesit duhet t'u japin njësive të vetëqeverisjes vendore për pasurinë e paluajtshme në pronësi/përdorim. **7.3)** Informimi i publikut bëhet nëpërmjet mjeteve të informimit elektronik, medias, njofti-meve publike dhe çdo forme tjetër komunikimi me publikun, e cila mund të shfrytëzohet për këtë qëllim. **7.4)** Njoftimet kanë për qëllim të informojnë publikun për: **a)** regjistrimin e objekteve të reja të pasurisë së paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore; **b)** objektet e pasurisë së paluajtshme ndërtesë/ njësi pronësore, që kanë pësuar ndryshime në përdorim apo destinim; **c)** pasurinë e paluajtshme ndërtesë/njësi pronësore të rrënuar, të braktisur apo të papër-dorshme; **ç)** rezultatet nga verifikimet e kryera në terren. **d)** vendimet e marra nga njësia e vetëqeverisjes vendore për taksën e pasurisë së paluajtshme, nivelet e vendosura për shumën e taksës për t'u paguar sipas ndarjeve/nëndarjeve zonale apo nënzonale etj.

ANEKSI 1: ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR BANESAT (zëvendësuar me VKM nr. 168, datë 27.2.2019, nr. 457, datë 26.7.2023).

Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së:

a) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve.

a/1) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi, sipas qyteteve, për çdo bashki, sipas qarqeve (me përjashtim të Bashkisë Tiranë).

Tab.

Nr. r. qarkut	Qarku	Nr. r. bashki	Bashkia	Nr. r. qytete	Nr. r. qytet i qarkut	Qytetet	Lek/m2 sipërfaqe shfrytëzimi
10	Shkodër	45	Shkodër	50	1	Shkodër	58 000,00 lekë
		46	Vau i Dejës	51	2	Vau i Dejës	24 300,00 lekë
		47	Malësi e Madhe	52	3	Koplik	40 500,00 lekë
		48	Pukë	53	4	Pukë	22 000,00 lekë
		49	Fushë-Arës	54	5	Fushë-Arës	7 500,00 lekë

a/2) Çmimet mesatare referuese të shitblerjes së ndërtesave që përdoren për qëllim banimi për Bashkinë Tiranë

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për banim në njësitë administrative jashtë qytetit përkatës, të cilat iu bashkuan njësive të vetëqeverisjes vendore pas hyrjes në fuqi të ligjit nr.115 /2014, "Për ndarjen administrative - territorjare të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", reduktohet derin në 35 (tridhjet e pesë) për qind, krahasuar me çmimin e zonës më të afërt, përjashtuar zonat rezidenciale. Në zonat që përfshihen në Bashkinë e Tiranës, ky reduktim është deri në 30 (tridhjetë) për qind krahasuar me çmimin e zonës më të afërt.

- c) Për ndërtesat e privatizuara me ligjin nr.7652, datë 23.12.1992, " Për privatizimin e banesave shtetërore ", të ndryshuar, çmimi-për metër katror është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit sipas zonave të tabelës, vetëm në rastin e shitjes së parë .

ANEKSI 2 : ÇMIMET MESATARE REFERUESE PËR METËR KATROR SIPËRFAQE NDËRTIMI PËR VLERËSIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME PËR NDËRTIME DHE AMBIENTE JOBANIMI (zëvendësuar me VKM nr.168, datë 27.2.2019, ndryshuar shkronjat "c" dhe "ç" me vendimin nr.144, datë 13.2.2020, nr.457, datw 26.7.2023) .

a) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për veprimtari ekonomike tregtimi shërbimi është 1.5 (një pikë pesë) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori përfshihen edhe njësitë tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhimi, tregtimi apo shërbimi me pakicë. Në zonat që përfshihen në Bashkinë Tiranë ky koeficient është 2 (dy) herë më i lartë.

b) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 (shtatëdhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

c) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ambiente parkim i hapur, pishinë e hapur, ambiente sportive të hapura, të tilla si: fusha futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisi, golfi, pista për gara të ndryshme sportive të atletikës, motorike, garave me kuaj e të tjera të ngjashme me to; porte dhe aeroporte të çdo kategorie, për të gjithë sipërfaqen e shtrirë që ato zënë, është 30 (tridhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve, ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë.

ç) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi të destinuara për veprimtari industriale, të tilla si: prodhim, përpunim apo magazinim të lëndëve të para, të gjysmëprodukteve apo të produkteve të gatshme industriale, si: fabrika, magazina, depo, silos, magazina frigoriferike të produkteve ushqimore (përfshijë ato të njësive të tregtimit dhe të shërbimit), si dhe objektet e tjera të ngjashme me to, është 50 (pesëdhjetë) % e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, sipas qyteteve ose sipas njësive administrative për Bashkinë Tiranë. Në këtë kategori përfshihen dhe ndërtesat që shërbejnë për veprimtari arsimore jopublike të çdo niveli, si dhe ambientet sportive të mbyllura, përfshirë dhe pishinat e mbyllura.

d) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimi që përdoren për bujqësi dhe blegtori, apo veprimtari mbështetëse, si: grumbullim, magazinim dhe ruajtje të produkteve bujqësore dhe blegtorale, është 30 (tridhjetë) për qind e çmimit të sipërfaqeve të banesave të zonës përkatëse, me përjashtim të përpunimit ushqimor.

dh) Çmimi për metër katror sipërfaqe ndërtimore për ndërtimet e reja regjistruar sipas lejes së përdorimit në ASHK, pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të indeksohet me koeficientin 0.2 (zero pikë dy) herë më i lartë se çmimi i sipërfaqes së apartamentit të banimit sipas listës së përcaktuar aneksin 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi, për 5 vitet e para pas regjistrimit të lejes së përdorimit në ASHK.

❖ **Vlera e taksës vjetore për metër katror në lekë për sipërfaqe që përdoren / shfrytëzohen për banim dhe veprimtari ekonomike .**

Tab.1/1

Çmimi mesatar referues sipas VKM 132/2018 (i ndryshuar)			Apl. Red. Çm. Ref. VKM 132, nenit 2, pika 3, paragrafi 2	Ndryshimi miratuar i çmimit referues	Çmimi referues miratuar	Reduktimi normës taksës		Rritja normës taksës		Vlera e takses per ndertesat qe perdoren, shfrytezohen per banim				Vlera e takses per ndertesat qe perdoren, shfrytezohen per veprimtari ekonomike			
						Familje	Business	familje	Business	Shtëpi/ Apartament (1)	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Banesa të privatizuara me ligjin nr. 7652, datë 23.12.1992 (0.7)	Njësi tregtimi dhe shërbimi (1.5)	Parkim i mbuluar ose bodrum (0.7)	Parkim i hapur (0.3)	Njësi industriale, prodhimtari, magazinimi (0.5)
22,000	0	0	22,000	30%	0%	0%	0%	7.7	5.39	2.31	5.39	66	30.8	13.2	22	13.2	
22,000	deri 35 %	35%	14,300	30%	0%	0%	0%	5.01	3.5	1.5	3.5	42.9	20.02	8.58	14.3	8.58	
22,000	deri 35 %	35%	14,300	30%	0%	0%	0%	5.01	3.5	1.5	3.5	42.9	20.02	8.58	14.3	8.58	
22,000	deri 35 %	35%	14,300	30%	0%	0%	0%	5.01	3.5	1.5	3.5	42.9	20.02	8.58	14.3	8.58	
22,000	deri 35 %	35%	14,300	30%	0%	0%	0%	5.01	3.5	1.5	3.5	42.9	20.02	8.58	14.3	8.58	

- ✓ Për ndërtesat e privatizuara në bazë të ligjit nr.7652, datë 23.12.1992 " Për privatizimin e banesave shtetërore ", shkronjës c) të Aneksit 1, të VKM Nr.132/2018 (i ndryshuar), çmimi për metër katror, për efekt të llogaritjes së detyrimeve tatimore vendore, përcaktohet në masën (70%) të çmimit referues të zonës, vetëm në rastin e shitjes së parë të pasurisë pas privatizimit.
- ✓ Me " shitje e parë pas privatizimit ", kuptohet transferimi i parë i së drejtës së pronësisë nga subjekti përfitues i privatizimit ose trashëgimtarët e tij, nëpërmjet kontratës së shitblerjes.
- ✓ Në çdo rast tjetër të transferimit të pronësisë pas realizimit të shitjes së parë, përfshirë shitjet e mëvonshme, dhurimet, shkëmbimet apo forma të tjera të kalimit të pronësisë, zbatohet çmimi referues i plotë i zonës (100%), sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ " Për kategorinë e familjarëve /abonentët familjarë ", bazuar në pikën 3, të nenit 2, të VKM Nr.132 /2018 (indryshuar), Bashkia Pukë ka reduktuar normën e tatimit mbi pasurinë e paluajtshme për (ndërtesa banimi / apartamente) me (-30 %) për të gjitha Njësitë Administrative.
- ✓ " Për të gjitha kategoritë tjera ", bazuar në pikën 3, të nenit 2, të VKM Nr.132 /2018 (indryshuar), Bashkia Pukë ka reduktuar çmimin mesatar referues me (-35%) për Njësitë Administrative Gjegjan, Rrape, Qerret dhe Qelez.
- ❖ Përfshirjet ose lehtësimet nga detyrimi për pagimin e taksës mbi pasurinë e paluajtshme sipas pikës 5, të nenit 21 dhe pikës 6, të nenit 22, të ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore", (i ndryshuar).
- ❖ Këshilli bashkiak vendos për lehtësimin ose përjashtimin nga detyrimi për pagimin e taksave për:
 - a) personat, të cilët kanë të ardhura nën minimumin jetik, sipas kriterëve të përcaktuara në nivel kombëtar;
 - b) taksapaguesin, pasuria e të cilit është dëmtuar nga veprimi i forcave madhore. Në këtë rast, lehtësimi ose përjashtimi është i përkohshëm dhe kohëzgjatja përcaktohet nga këshilli bashkiak, në raport me dëmin e shkaktuar deri në vlerën 75 për qind.
- ✓ Taksapaguesit, pasuria e të cilëve është dëmtuar si pasojë e veprimit të forcave madhore (si fatkeqësi natyrore, zjarre, përmbytje, rrëshqitje dheu apo ngjarje të tjera të ngjashme), përfitojnë lehtësime apo përjashtime të përkohshëm nga detyrimet tatimore vendore për taksën e pasurisë.
- ✓ Lehtësimi apo përjashtimi nga detyrimi tatimor vendor për taksën e pasurisë është në masën prej 75 për qind të detyrimit tatimor përkatës, për vitin kalendarik (korent) përkatës, bazuar në dokumentacionin si procesverbal konstatimi i dëmit, shkresës ose vërtetim nga organet kompetente shtetërore, dokumentacion fotografik ose deklarata e taksapaguesit që vërteton dëmin e pësuar.

❖ Përfshihen nga taksa mbi ndërtesat:

- a) pronat e shtetit dhe të njërive të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse;
- b) pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore;
- c) ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara;
- ç) banesat sociale në pronësi të bashkive;
- d) pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale;
- dh) ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre;
- e) strukturat akomoduese "Hotel/Resort me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht "brand name";
- f) ndërtesat e banimit, të deklaruara si vendbanim nga kryefamiljarët që përfitojnë pension pleqërie/pension social, kur familja e tyre përbëhet vetëm nga pensionistë, ose dhe me persona në ngarkim të tyre, që janë të pa aftë për punë;
- g) ndërtesat e banimit të kryefamiljarëve që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- gj) ndërtesat kulturore, nën mbrojtje të përkohshme ose të përhershme, për kohën në të cilën deklarohet mbrojtja, sipas legjislacionit në fuqi për monumentet e kulturës dhe/ose trashëgiminë kulturore, të cilat përdoren vetëm për qëllime jofitimprurëse.

ARKËTIMI I TAKSËS SË NDËRTESAVE :

Si bazë për llogaritjen e detyrimit për këtë taksë për subjektet është vlera e ndërtesës së shfrytëzueshme për qëllime aktiviteti . Kur biznesi i krijuar (regjistruar) gjatë vitit merr në përdorim ndërtesa të krijuara në vitet paraardhëse , taksa e ndërtesës llogaritet dhe arkëtohet e plotë si detyrim vjetor , pavarësisht nga data e regjistrimit të tij . Në rastet kur kjo taksë është paguar njëherë dhe vërtetohet me mandat pagese , në Zyren e Taksave dhe Tarifave Vendore bëhet paraqitja e dokumentit të arkëtimit të taksës për ndërtesën , zbritet detyrimi për vitin kalendarik dhe vendoset në dosjen e biznesit .

MENYRA E PAGESËS :

Detyrimi për taksën mbi ndërtesën është vjetor . Për të gjitha kategoritë e biznesit ky detyrim paguhet me një kësht

A) Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e taksës së pasurisë (ndërtesë) është deri 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e taksës së pronës me zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore , likuidimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të taksës së pasurisë , dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjorbë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit . (neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar)

B) Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e taksës së pasurisë (ndërtesë) është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor , dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjorbë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit .

C) Likuidimi do bëhet pranë Degës së Raiffeisen Bank . Për familjarët likuidimi është gjithëvjetor me likuidim të menjëhershëm , ose ndarë në muaj me faturën e ujit pijshëm , ku agjent tatimor është N^{UK}-ja Pukë .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS :

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi ndërtesat për biznesin e të gjitha kategorive është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë . Për vjeljen e taksës së ndërtesës për qëllime banimi , ngarkohet Ndërmarrja Ujësjellës Kanalizime sh.a Pukë për vjeljen e taksës së ndërtesës për familjarët që kanë kontratë me Ujësjellësin . Për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjellës - Kanalizime sh.a Pukë , struktura përgjegjëse për vjeljen e kësaj takes është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Pukë , në bashkëpunim me njësitë administrative përkatëse .

❖ Popullimi i vazhdueshëm i të dhënave në RQTVPP, për efekt të vlerësimit të bazës së taksueshme për ndërtesat, për rrjedhojë edhe të taksës vendore të ndërtesës, bëhet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore nën monitorimin dhe asistencën e DPTP-së, në bazë të aksesit për territorin në juridiksionin administrativ përkatës.

❖ **BAZA LIGJORE :** nenet 20, 21, 22, 22/1, 22/2, 22/3, 22/4, 22/5, 24 dhe 25 të ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , nenet 1 deri në 5 të VKM Nr.132 /2018 " Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës " (i ndryshuar) , Udhëzimi nr.3, datë 28.12.2016 " Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave " (i ndryshuar)

" TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE " :

▪ " Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme " : 21 i ligjit nr.9632 /2006

Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

2.1 Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Këshilli bashkiak vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 1, në kufijtë plus-minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse.

4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

▪ " Përgjegjësitë e njësisë së vetëqeverisjes vendore " : 22/5 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mbledhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.

▪ " Taksa mbi tokën bujqësore " : 23 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

1. Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi në përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i tokës bujqësore bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së tokës bujqësore, pranë bashkisë ku ndodhet toka. Kategoritë minimale të tokave bujqësore jepen në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për hektar. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 1 të këtij ligji.

NIVELI I TAKSËS MBI TOKËN BUJQËSORE :

Tab 2.

Kategoritë minimale dhe nivelet treguese të taksës vendore mbi pasurinë e paluajtshme tokë bujqësore	Njësia	Niveli i taksës mbi tokën bujqësore			
		Për Njësinitë Administrative Pukë		Për Njësinitë Administrative Gjegjan , Rrape , Qerret dhe Qelez .	
		Sipas Ligjit	Propozimi	Sipas Ligjit	Propozimi
KATEGORIA TOKËS VII-X	Lekë/ha/vit	700	500	700	500

3. Përjashtohen nga taksa tokat bujqësore, që mbillen me kultura drufrutore dhe vreshtari për pesë vitet e para nga çasti i mbjelljes.

4. Taksa e mbledhur në mbështetje të këtij ligji paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

▪ " Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave ": 24 i ligjit nr.9632 /2006

Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërblim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE TË TAKSËS VENDORE MBI PASURINË E PALUAJTSHME TOKË BUJQËSORE

KLASIFIKIMI SIPAS BASHKIVE

KATEGORIA 1	KATEGORIA 2	KATEGORIA 3	KATEGORIA 4
Durrës	Berat	Devoll	Bulqizë
Shijak	Polican	Dibër	Gramsh
Fier	Ura Vajguore	Gjirokastrë	Has
Patos	Delvinë	Dropull	Kolonjë
Roskovec	Elbasan	Libohovë	Kukës
Kavajë	Belsh	Librazhd	Fushë Arrëz
Rrogozhinë	Cërrik	Përrenjas	Malësi e Madhe
Krujë	Korçë	Mallakastrë	Mirditë
Lezhë	Maliq	Mat	Pukë
Lushnjë	Pustec	Klos	Tropojë
Divjakë	Kuçovë	Përmet	
Sarandë	Kurbin	Këlcyrë	
Konispol	Peqin	Pogradec	
Finiq	Shkodër	Skrapar	
Tiranë	Vau i Dejës	Tepelenë	
Vorë		Memaliaj	
Kamëz			
Vlorë			
Himarë			
Selenicë			

KLASIFIKIMI SIPAS KATEGORISË SË TOKËS BUIQËSORE

KATEGORIA E TOKËS	VLERA E TAKSËS NË LEKË PËR HEKTARË NË VIT (lekë/ha/vit)			
	KATEGORIA 1	KATEGORIA 2	KATEGORIA 3	KATEGORIA 4
I	5,600	4,200	2,800	1,400
II	4,900	3,500	2,100	1,200
III	4,200	2,800	1,400	1,100
IV	3,600	2,300	1,350	1,000
V	3,000	1,900	1,250	900
VI	2,400	1,600	1,200	800
VII - X	1,800	1,400	1,100	700

Shënim: Klasifikimi sipas kategorive të tokës bujqësore bëhet nga strukturat e ministrisë përgjegjëse për bujqësinë

MËNYRA E PAGESËS :

Detyrimi për taksën mbi tokën bujqësore është vjetor . Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst.

A) Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e taksës së pasurisë (tokë bujqësore) është deri me 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e taksës së pronës (tokë bujqësore) me zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore , likuidimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të taksës së pasurisë (tokë bujqësore) , dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjorbë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit . (neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar) .

B) Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e taksës së pasurisë (tokë bujqësore) është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor , dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjorbë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit .

C) Likuidimi do bëhet pranë Degës së Raiffeisen Bank . Për familjarët likuidimi i taksës së pasurisë (tokë bujqësore) është gjithëvjetor me likuidim të menjëhershëm , ose ndarë në muaj me faturën e ujit pijshëm , kur agjent tatimor është NUK-ja Pukë .

D) Për kategoritë biznes , afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 20 Mars është 30 ditë pas lindjes së detyrimit . Për pronat e njohura nga komisioni i kthimit të pronave sqarojmë se : për personat që i zoterojnë këto prona aplikohet taksa sipas natyrës së pronës, nëse është tokë bujqësore , trajtohen si të tilla nëse janë pyje ose inproduktive sipas ligjeve në fuqi .

❖ **BAZA LIGJORE:** Pikat 2.1, 3, dhe 4 të nenit 21, pikës 2, të nenit 22/5, nenit 23, nenit 24, dhe Aneksit 1, të ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS : Struktura e ngarkuar për llogaritjen e taksës mbi tokën bujqësore , për të gjitha kategoritë , është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë . Ngarkohet Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë , për vlerësimin e kategorisë së tokës si dhe saktësimin dhe verifikimin e periudhës së mbjelljes me kultura drufrutore dhe vreshtari , për çdo fermer / fermë . Ngarkohet Sektori i Zhvillimit Rural dhe Bujqësisë , për përcaktimin e sipërfaqes në pronësi sipas personave, duke pasqyruar dhe ndryshimet e herëpashershme , duke ia përcjellë këtë informacion me shkrim Zyres së Taksave dhe Tarifave Vendore me qëllim llogaritjen e detyrimit .

" TAKSA MBI TRUALLIN " :

- **" Rregulla të përbashkëta të taksës mbi pasurinë e paluajtshme " : 21 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .**

2.1 Kategoritë minimale të bazës së taksës sipas klasifikimit dhe nivelet respektive të taksës mbi tokën bujqësore dhe mbi truallin (jo hapësirë publike), jepen përkatësisht, në anekset 1 dhe 2, që i bashkëngjiten këtij ligji dhe janë pjesë përbërëse e tij.

4. Kur për një kategori minimale të bazës së taksës, këshilli bashkiak miraton nënkategori, ai, detyrimisht, përcakton edhe nivelin e taksës për secilën nënkategori. Niveli i taksës për çdo nënkategori është brenda kufijve të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni.

- **" Përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore " : 22/5 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .**

2. Taksa mbi ndërtesën, sipas dispozitave të këtij ligji, mund të mblidhet nëpërmjet agjentëve të taksave, të cilët kanë shtrirje territoriale, sistem elektronik të bazës së të dhënave e të gjenerimit të detyrimeve dhe që autorizohen me vendim të Këshillit të Ministrave në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurat tatimore. Këshilli i Ministrave përcakton edhe masën e përfitimit të agjentit të autorizuar, mbi të ardhurat e arkëtuara nga taksa e ndërtesave.

- **" Taksa mbi truallin " : 23/1 i ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .**

1. Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit, në metër katror, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së

truallit në përdorim, pranë bashkisë ku ndodhet trualli. Kategoritë minimale të truallit jepen në aneksin 2, që i bashkëlidhet këtij ligji. Për çdo kategori minimale të truallit, këshilli bashkiak mund të miratojë nënkategorizime.

2. Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror. Detyrimi i taksës llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tatueshme. Nivelet treguese të taksës, për çdo kategori minimale të bazës së taksës, jepen në aneksin 2, të këtij ligji.

NIVELI I TAKSËS MBI TRUALLIN:

Tab 3.

TAKSA MBI TRUALLIN	NIVELI TAKSËS SË TRUALLIT	PËR TË GJITHA NJËSITË ADMINISTRATIVE	
		Sipas Ligjit	Propozimi
✓ Vlera e taksës së truallit për qëllime banimi nga individët.	Lekë /m ² /vit	0.14	0.14
✓ Vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi.	Lekë /m ² /vit	12	12

3. Taksa e mbledhur, në mbështetje të këtij ligji, paguhet në buxhetin e bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet prona e taksueshme.

▪ " Vërtetimi i pronësisë për efekt të detyrimit për pagimin e taksave ": 24 i ligjit nr.9632 /2006

Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

Për efekt të detyrimit për pagimin e taksave të taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë dhe të njohin dokumentet e vërtetimit të pronësisë, sipas regjistrimit të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Për këtë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme u japin të dhëna, pa shpërbllim, bashkive dhe për pasuritë e paluajtshme të regjistruara pranë tyre. Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme njoftojnë rregullisht, çdo 3 muaj, bashkitë dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Taksës së Pasurisë për regjistrimet e reja të kryera dhe ndryshimet e gjendjes së pronave. Nëse prona nuk është e regjistruar në regjistrin e pasurisë së paluajtshme, për efekt të detyrimit për pagimin e taksës nga taksapaguesit, zyrat e taksave të bashkisë, për vërtetim pronësie njohin vërtetimin e pronësisë, vendimet e komisionit të kthimit dhe kompensimit të pronës, vendimet e privatizimit ose dokumentet e tjera, të lëshuara nga organet përkatëse shtetërore, në përputhje me legjislacionin përkatës. Në rastin e mungesës së dokumentacionit të vërtetimit të pronësisë, bashkia vendos madhësinë e sipërfaqes së tatueshme, bazuar në vendimin e komisionit të verifikimit të pasurisë së paluajtshme. Organet e pushtetit vendor ngrenë komisionin e verifikimit të pasurive të paluajtshme, në rast mungese të dokumentacionit ligjor. Detyrat dhe funksionet e këtij komisioni përcaktohen me vendim të këshillit të bashkisë.

Zyrat e regjistrimit të pasurisë së paluajtshme nuk bëjnë regjistrimin apo çregjistrimin e pasurisë së paluajtshme, ndërtesë apo tokë bujqësore, nëse dokumentacioni i vërtetimit të pronësisë nuk shoqërohet edhe me vërtetimin e bashkisë, i cili konfirmon pagesën e taksave respektive që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

KATEGORITË MINIMALE DHE NIVELET TREGUESE TË TAKSËS VENDORE MBI PASURINË E PALUAJTSHME TRUALL (JO HAPËSIRË PUBLIKE)

NIVELI I TAKSËS SË TRUALLIT NË LEKË PËR METËR KATROR NË VIT	KATEGORITË E BASHKIVË			
	I	II	III	IV
	TIRANË DURRËS KAVAJË KRUJË LEZHË LUSHNJË FIER VLORE SARANDË	SHKODËR ELBASAN BERAT KORÇË DELVINË KURBIN PEQIN KUÇOVË	GJIROKASTËR PËRMET POGRADEÇ LIBRAZH DIBËR MAT SKRAPAR MALLAKASTËR DEVOLL TEPELENE	TË GJITHË BASHKITË E TJERA
Vlera e taksës së truallit për qëllime banimi nga individët	0,56 lekë/m ² /vit	0,42 lekë/m ² /vit	0,28 lekë/m ² /vit	0,14 lekë/m ² /vit
Vlera e taksës së truallit për qëllime biznesi	20 lekë/m ² /vit	18 lekë/m ² /vit	15 lekë/m ² /vit	12 lekë/m ² /vit

MËNYRA E PAGESËS :

Detyrimi për taksën mbi truallin është vjetor . Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst .

A) Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e taksës së pasurisë (truall) është deri me 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e taksës së pronës (truall) me zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore , likuidimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të taksës së pasurisë (truall) , dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjorbë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit . (neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar) .

B) Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e taksës së pasurisë (truall) është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor , dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjorbë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit .

C) Likuidimi do bëhet pranë Degës së Raiffeisen Bank . Për familjarët likuidimi i taksës së pasurisë (truall) është gjithëvjetor me likuidim të menjëhershëm , ose ndarë në muaj me faturën e ujit pijshëm , kur agjent tatimor është NUK-ja Pukë .

D) Për kategoritë biznes , afati i pagesës për detyrimet e lindura pas datës 20 Mars është 30 ditë pas lindjes së detyrimit .

Detyrimi për biznesin llogaritet nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë , dhe Degës së Raiffeisen Bank Pukë .

Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore krye llogaritjen në bazë të sipërfaqes dhe vlerës së taksës sipas tabelës dhe klasifikimit të mësipërm .

❖ **BAZA LIGJORE :** Pikat 2.1, dhe 4 të nenit 21, pikës 2, të nenit 22/5, nenit 23/1, nenit 24, dhe Aneksit 2, të ligjit nr.9632 /2006 “ Për sistemin e taksave vendore ” (i ndryshuar) .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS :

Detyrimi për familjarët shlyhet si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë nga Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalizimeve Pukë në cilësinë e agjentit tatimor . Familjarët , të cilët nuk kanë kontratë me ujësjellësin , faturohen direkt nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë me bazë vjetore . Detyrimi për biznesin llogaritet nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë dhe shlyhet pranë çdo banke të nivelit të dytë dhe ne sportelet e Postës Shqiptare sh.a dega Pukë .

- Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës mbi truallin për të gjitha kategoritë është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Pukë .

❖ "TATIMI I THJESHTUAR MBI FITIMIN PËR BIZNESIN E VOGËL" .

Çdo subjekt, i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal qarkullim më i vogël ose i barabartë me 8 000 000 (tetë milionë) lekë, u nënshtrohet detyrimeve të parashikuara në këtë kre.

❖ Shkalla tatimore

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 0 (zero).

• <u>Shkalla Tatimore</u>	<u>Njësia</u>	<u>Niveli ligjor i Tatimit</u>	
		<u>NJA</u> <u>Pukë</u>	<u>NJA të tjera</u>
• <u>Me qarkullim vjetor nga 0 - 8.000.000 Lekë</u>	<u>Lekë/vit</u>	<u>0</u>	<u>0</u>

❖ Deklarimi

Çdo tatimpagues, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, është i detyruar që deri më 10 shkurt të vitit që pason periudhën tatimore të dorëzojë një deklaratë vjetore tatimore, ku të jepen hollësisht të ardhurat gjithsej, shpenzimet e zbritshme, fitimi i tatueshëm, si dhe çdo hollësi tjetër e përcaktuar me udhëzim të ministrit të Financave dhe Ekonomisë për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës tatimore vjetore.

❖ Administrimi i tatimit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore është e ngarkuar me vlerësimin dhe kontrollin e tatimpaguesve, subjekt i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Administrata rajonale tatimore krijon një regjistër të veçantë mbi biznesin e vogël, në bazë të të dhënave që merr nga bashkitë. Ky regjistër do të përditësohet me hapjen e biznesve të reja.

❖ Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës / tatimit:

Drejtoria Rajonale Tatimore, në rolin e agjentit tatimor, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël .

- ❖ Baza ligjore: Ligji nr.122/2020 për disa ndryshime në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 Për sistemin e taksave vendore " (të ndryshuar) .

TAKSA E FJETJËS NË HOTEL :

PËRKUFIZIMI : Me " hotel " kuptohet çdo veprimtari , që jep strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel , motel , stabiliment turistik , pension , shtëpi pritjeje , turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim .

PËRKUFIZIMI : Strukturat akomoduese do të përfshijnë kategoritë si më poshtë : **a) " Bujtinë " ; b) " Fjetinë " ; c) " Hostel " ; ç) " Kamping " ; d) " Hotel " ; dh) " Motel " ; e) " Resort " ; ë) " Qendër kurative " ; f) " Fjetje dhe mëngjes " (B&B) .**

Secila kategori e strukturave akomoduese klasifikohet me sistem të veçantë , e shoqëruar me shenjat dalluese përkatëse , sipas përcaktimit të mëposhtëm : " Bujtinë " Standard , " Fjetinë " Standard , Komfort " Kamping " Standard , " Hotel dy yje , tre yje , katër yje , pesë yje " ; " Motel " Standard , Komfort , Superior ; " Resort tre yje , katër yje , pesë yje " ; " Qendër kurative dy yje , tre yje , katër yje , pesë yje " ; " Fjetje dhe mëngjes " (B&B) Standard , Komfort , Superior .

BAZA E TAKSËS : Është numri i netëve të qëndruara në hotel për person .
NIVELI I TAKSËS : Niveli tregues i taksës së fjetjes në hotel paraqitet sipas Aneksit 8 ;
TAKSA E FJETJES NË HOTEL :

Tab 4.

Taksa e fjetjes në hotel	Njësia	Niveli i taksës së fjetjes në hotel	
		Për të gjitha Nj. Administrative	
		Sipas Ligjit	Propozimi
Hotel me 4-5 yje	Lekë/natë qëndrimi/për person	105	105
Bujtinë , fjetinë , motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 93 / 2015 "Për Turizmin " (i ndryshuar) ;	Lekë/natë qëndrimi/për person	35	35

Referuar ligjit , Taksa e fjetjes në hotel përcaktohet mbi bazën e vetdeklarimit të subjekteve , verifikimeve të herëpashërshme mbi bazën e sondazheve nga inspektorët në terren dhe nga verifikimi i kasës fiskale të subjekteve . Baza e vlerësimit të detyrimit është vetëdeklarimi , i cili formalizohet me akt kontrollin mujor që përpilohet në subjekt . Për të monitoruar bazën e taksueshme në mënyrë të vazhdueshme ushtrohen kontrole të ndërmjetme për verifikim numri shtretërisht të zënë (persona të akomoduar) . Gjithashtu në fund të muajit bëhet verifikimi i xhiros së paisjes fiskale të muajit përkatës . Taksa mujore e fjetjes në hotel vendoset duke marrë në referencë nivelin maksimal ndërmjet ketyre verifikimeve të ndërmjetme .

MËNYRA E PAGESËS :

Pagesa kryhet brënda dates 5 të muajit pasardhës . Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel, detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë dhe evidentohet në faturën e hotelit ku shënohet çmimi i fjetjes dhe vlera e taksës .

DETYRIMI DHE KËSTET E PAGIMIT : Detyrimi për taksën llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës së vendosur nga bashkia , për natë qëndrimi , me numrin e netëve të qëndrimit në hotel . Detyrimi për taksën i takon klientit që strehohet në hotel , detyrim i cili mbahet nga hoteli për llogari të bashkisë , në territorin e së cilës ndodhet hoteli . Në faturën e hotelit shënohet çmimi i fjetjes dhe mbi të vlera e taksës . Derdhja e të ardhurave për këtë taksë nga hoteli në favor të bashkisë , në juridiksionin e së cilës ndodhet vendndodhja e tij , bëhet brenda datës 5 të muajit pasardhës .

❖ **BAZA LIGJORE** : Neni 26 , pikat 1-7 të Ligjit Nr. 9632 date 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , Aneksi 8 . Taksa vendore e tabelës sipas kategorive të njesive të vetëqeverisjes vendore (Bashkive) , Kategoria III , (ndryshuar me Ligjin Nr. 95 / 2018, datë 03.12'2018) , nenet 3 dhe 4 e në vijim të Ligjit Nr.93 / 2015 " Për turizmin " (i ndryshuar) ; .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS : Struktura për vjeljen e taksës së fjetjes në hotel është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë .

TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË NGA NDËRTIMET E REJA :

Këshilli bashkiak miraton kategori dhe nënkategori për klasifikimin e investimeve , të cilat mund të përdoren për vendosjen e nivelit të taksës . Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit . E ardhura nga taksa , për çdo rast , mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet , për çdo rast , për llogari të bashkisë , që mbulon territorin ku do të bëhet investimi . *Nëse objekti , për të cilin do të bëhet investimi , shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër , të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre , në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki . Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paguhet përpara dorëzimit të dokumentit të lejes së ndërtimit nga autoriteti përgjegjës i planifikimit .*

BAZA E TAKSËS : Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet sipas **preventivit**, ose vlera në lekë e çmimit të shitjes për metër katror të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë sipas kategorive dhe nënkategorive për klasifikimin e investimeve, është si më poshtë :

NIVELI I TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË :

Tab 5.

Nr.	Llojet e ndërtimeve dhe investimeve .	Njesia matjes	Niveli i taksës së ndikimit në infrastrukturë			
			Nj.A. Pukë		Nj.A të tjera	
			Sipas ligjit	Propozimi	Sipas ligjit	Propozimi
1.	Në rastin e ndërtimeve të destinuara për qëllime banimi apo për njësi tregtimi dhe shërbimi, të cilat kryhen nga shoqëri ndërtimi, shkalla e taksës së ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 (katër) për qind deri 8 (tetë) për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Në këtë kategori investimesh përfshihen edhe ndërtimet zëvendësuese për qëllime banimi, të kushtëzuara për t'u ndërtuar si shkak i zbatimit të një kontrate koncensionare, e cila prek banesat ekzistuese. Gjithashtu, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtimet e destinuara për qendra tregtare apo të biznesit .	Në % të çmimit të shitjes për m ²	4-8%	6%	4-8%	5%
2.	Në rastin e ndërtimeve të ndryshme nga ato të përcaktuara në pikën 2, të nenit 27 të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit dhe është : a) për ndërtime që destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, të industrisë,të ndërtimeve individuale për qëllime të përdorimit vetjak nga individët,të ndërtuara nga vetë individi apo me sipërmarrës, si dhe të ndërtimeve për qëllime publike, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 1 deri në 3 për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është 2 deri në 4 për qind e saj ;	Në % të vlerës së investimit .	1-3%	2%	1-3%	1.5%

	a/1) Për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj .	Në % të vlerës së investimit .	jo më shumë se 1%	0.7%	1%	0.7%
	b) për projekte të infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, të aeroporteve, të tuneleve, të digave, të ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit .	Ne % te vleres se investimit, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.	0,1%	0,1%	0,1%	0,1%
	c) për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi, taksa e ndikimit në infrastrukturë e ndërtimeve të reja është 0,5 për qind e vlerës së investimit .	Në % të vlerës së investimit .	0.5%	0.5%	0.5%	0.5%
3.	d) për ndërtesat, që destinohen për qëllime banimi në zonat malore, taksa e ndikimit në infrastrukturë është 0 deri në 3 për qind e vlerës së investimit. Këshilli bashkiak përcakton me vendim zonat malore për efekt të zbatimit të këtij paragrafi .	Në % të vlerës së investimit .	0-3%	2%	0-3%	1.5 %
4.	ç) Për subjektet që janë në proces aplikimi për t'u pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e strukturave që destinohen për përdorim në sektorin bujqësor dhe blegtoral dhe për objektet sportive sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për sportin, taksa e ndikimit në infrastrukturë është jo më shumë se 1 (një) për qind e vlerës së investimit, ndërsa për Bashkinë e Tiranës është jo më shumë se 2 (dy) për qind e saj .	Në % të vlerës së investimit .	jo më shumë se 1%	0.7%	1%	0.7%

BAZA E TAKSËS : (per piken 1) : është vlera në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së ndërtimeve për qëllime banimi apo të njësisë të tregtimit dhe shërbimit . Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës tregut , sipas përcaktimeve të nxjerra me akt të Këshillit të Ministrave , si dhe me (UKM) " Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave " , që miratohet çdo vit .

BAZA E TAKSËS : (për pikat 2 , 3 dhe 4) : Niveli i taksës shprehet si përqindje e vlerës së investimit .

DETYRIMI DHE KËSTET E PAGIMIT : Detyrimi për taksën i takon investitorit .

MËNYRA E PAGESËS :

Përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet , duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë , ndaj çmimit të shitjes për metër katror ose vlerës së investimit . Në rastet kur një ndërtesë ka funksione të përziera (banim dhe administrative , etj , përlllogaritja e detyrimit nga taksa do të bëhet , duke aplikuar përqindjet përkatëse sipas kategorisë dhe nënkategorisë , ndaj çmimit të shitjes për metër katrorë respektive të pjesës së banimit dhe atë administrative , shërbimi , etj .

LEHTËSIRAT TATIMORE :

Përfshihet për projektet e infrastrukturës , për ndërtimin e rrugëve kombëtare , të porteve , aeroporteve , tuneleve , digave , ndërtimit të infrastrukturës në energji , përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte , taksa e ndikimit në infrastrukturë të ndërtimeve të reja është 0,1 për qind e vlerës së investimit , por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar , kur kostoja nuk është e përfshirë në preventivin e investimit .

PËRJASHTIME :

- Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet kryera për ndërtimin e strukturave akomoduese " Hotel / Resort me pesë yje , status special " , sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit dhe që janë mbajtës të një marke tregtare të regjistruar dhe njohur ndërkombëtarisht " brand - name " .
- Përfshihen nga pagesa e kësaj takse edhe investimet e subjekteve , të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si " agroturizëm " , sipas legjislacionit në fuqi në fushën e turizmit .
- Përfshihen nga pagesa e kësaj takse investimet për rindërtimin , riparimin apo restaurimin e ndërtesave , të dëmtuara si pasojë e fatkeqësive natyrore , sipas përkufizimit të dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile . Kushtet , rregullat dhe dokumentet që shoqërojnë kërkesën për përfshirjen nga detyrimi për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë , sipas kësaj pike , përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave .
- Nga pagesa e kësaj takse përfshihen edhe investimet në kuadër të programeve të rindërtimit sipas dispozitave të ligjit për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore .
- ❖ Autoriteti vendor i planifikimit nuk e paguan taksën e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për zhvillimet e veta me fonde publike si dhe në rastet kur investitor është bashkia , kjo taksë nuk aplikohet .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS : *Struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (Drejtoria e Urbanistikës) . Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore lëshon faturen për arkëtim dhe e ngarkon atë në sistem në menyrë e zaturimit të plotë të procesit sipas përcaktimeve ligjore . Të gjitha subjektet ndërtuese do të tërheqin lejen e ndërtimit pranë bashkisë Pukë , vetëm pasi të kenë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë .*

Garanci financiare për subjektet fizike / juridike , kërkuar i lejës për ndërtimin , riparimin , restaurimin apo shembjen e objektit :

GARANCIA FINANCIARE : Në mbështetje të VKM - se Nr.575 , datë 24.6'2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte " , subjekti fizik / juridik , kërkuar i lejës për ndërtimin , riparimin , restaurimin apo shembjen e objektit , përpara marrjes së lejës së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV- së , e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV- së .

Njësitë e qeverisjes vendore , më konkretisht Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (Drejtoria e Urbanistikës) në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit , riparimit, restaurimit apo shembjes , përcaktojnë se personi fizik ose juridik , të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit , duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave sipas VKM - së Nr.575 , datë 24.06.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte " , brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit , riparimit , restaurimit apo prishjes së objektit , i cili krijon mbetje inerte .
Garancia financiare i kthehet subjektit fizik / juridik pa interes nga bashkia , e cila ka lëshuar lejen e ndërtimit , pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar , sipas përcaktimeve të VKM Nr. 575 datë 24.06.2015 " Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte " , në venddepozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga bashkia .
Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura , bashkia konfiskon garancinë financiare .

❖ **BAZA LIGJORE** : Neni 27 , pikat 1 – 9 , gërmat a , b , c dhe d të ligjit nr. 9632 datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) . (ndryshuar me ligjin nr.142 /2015 , datë 17.12'2015) ; ligjin nr. 106 / 2017 , datë 30.11'2017 ; ligjin nr. 41 / 2018 datë 09.07'2018 ; ligjin nr. 95 / 2018 datë 03.12'2018 , neni 9 i tij ; Shtuar me Aktin Normativ Nr.3 , datë 02.10'2019 ; hequr me ligjin nr.122 /2020 : shtuar me Aktin Normativ nr.19 , datë 23.04'2020) ; shtuar me ligjin nr.67 /2023 , për një ndryshim dhe disa shtesa në ligjin nr.9632 / 2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , ligji nr.107 / 2014 " Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Teritorit " (i ndryshuar) , vendimin nr.408 / 2015 " Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit " (i ndryshuar) .

❖ **STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS** : *Struktura përgjegjëse për llogaritjen dhe vjeljen e garancisë financiare është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (D. Urbanistika) pranë bashkisë Pukë .*

Struktura e ngarkuar për lëshimin e faturës dhe vjeljen e detyrimit është Drejtoria e të Ardhurave Vendore (Zyra e Tatim Taksave dhe Tarifave Vendore) pranë bashkisë Pukë .

Tab 6. TAKSA MBI KALIMIN E SË DREJTËS SË PRONËSISË PËR PASURITË E PALUAJTSHME .
PËRKUFIZIMI : Me kalim të së drejtës së pronësisë (ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore) kuptohet akti i

shitjes, dhurimit apo heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme .

SPECIFIKA MBI TAKSËN : Tatimi mbi të ardhurat nga kalimi i së drejtës së pronësisë paguhet nga individ i që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme . Derdhja bëhet para kryerjes së regjistrimit të sendeve të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore .

BAZA E TAKSËS : Baza e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për ndërtesat është sipërfaqja e ndërtimit, pronësia e së cilës transferohet. Kategoritë e ndërtesave , për efekt të bazës së taksueshme , jepen në aneksin nr.3 që i bashkëlidhet ligjit nr.9632 datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) . Baza e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e tjera të paluajtshme është vlera e shitjes së tyre. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind . Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij .

NIVELI I TAKSËS : Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme vendoset në çastin e kalimit të së drejtës së pronësisë mbi to. Niveli i taksës përcaktohet në përqindje dhe niveli tregues i taksës është 2 për qind . Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij . Niveli i taksës caktohet në lekë për metër katror të bazës së taksës . Detyrimi tatimor llogaritet si shumëzim i nivelit të taksës me bazën e tij .

Kategoritë e ndërtesave	Njësia/ matjes	Niveli i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	
		Nj. Administrative Pukë	Nj. Administrative te tjera

		Sipas Ligjit	Propozimi	Sipas Ligjit	Propozimi
Ndërtesa banimi	Lekë/m ²	100	100	100	100
Ndërtesat e tjera për tregti dhe shërbime	Lekë/m ²	300	300	300	300
Ndërtesa të tjera	Lekë/m ²	200	200	200	200
Pasuri të tjera të paluajtshme		2%	E vlerës së shitjes	2 %	E vlerës së shitjes

PËRJASHTIME :

- Përfshihen nga pagimi i taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme :
 - Enti Kombëtar i Banesave , Ministria e Financave dhe organet e qeverisjes qendrore e vendore ;
 - Personat , të cilët janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat vetjake , në mbështetje të ligjit nr.8438, datë 28.12'1998 " Për tatimin mbi të ardhurat " (i ndryshuar) ;
 - Subjektet që dhurojnë pasuri të paluajtshme kur përfitues të drejtpërdrejtë janë :
 - Institucionet dhe entet shtetërore e publike , qendrore e vendore ;
 - Bashkësitë fetare ose organizatat jofitimprurëse , kur dhurimi lidhet me atë pjesë të veprimtarisë së tyre pa qëllim fitimi . Në këto raste dhuruesi , pasi ka marrë vërtetimin nga këshilli bashkiak për përjashtimin nga taksa , bën regjistrimin e pasurisë së paluajtshme të dhuruar . Në çastin e regjistrimit , dhuruesi paguan pjesën që i takon agjentit të taksave .
- Në rastet kur pranohet nga vetë palët ose kur vërtetohet ligjërisht simulim i dhurimit për llogari të një shitjeje , për shmangie nga taksa , zbatohen taksa sa dyfishi i vlerës , pavarësisht nga përgjegjësitë e tjera sipas ligjeve në fuqi .

DETYRIMI PËR PAGESEN : Taksa paguhet nga personi, që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit, në përputhje me aktet ligjore në fuqi .

MËNYRA E MBLEDHJËS : Agjenti tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme është Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish-Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme) , e cila në rolin e agjentit të taksës përfiton 3% të shumës së arkëtuar dhe diferencën e derdh për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë Pukë, jo më vonë se data 30 e muajit pasardhës .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS : Ngarkohet Drejtoria e të Ardhurave (zyra tatimore vendore) pranë bashkisë Pukë të bëjë rakordimet dhe planifikimin e të ardhurave me Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ish - ZRPP) .

BAZA LIGJORE : Neni 28 , pikat 1 - 4 , Neni 29 , pikat 1 - 2 , gërmat a , b , c , i dhe ii të ligjit nr. 9632 datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , Aneksi 3 " Nivelet e taksës vendore për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi ndërtesat " . (ndryshuar me ligjin nr. 10457, datë 21.07'2011 dhe ligjin nr. 95 / 2018 datë 03.12'2018) ; udhëzimi nr. 29 datë 30.7'2018 " Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme " ; udhëzimi nr.5 datë 30.01'2006 " Për tatimin mbi të ardhurat " (i ndryshuar) .

TAKSAT KOMBËTARE QË NDAHEN ME NJËSITË E QEVERISJES VENDORE ;

TAKSA VJETORE E MJETEVE TË PËRDORURA :

BAZA E TAKSËS : është lloji i mjetit të transportit rrugor .

SPECIFIKA MBI TAKSËN :

Nga shuma e përgjithshme e të ardhurave mujore të arkëtuara nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura njësia vendore , në rolin e përfituesit , përfiton 25 % të të ardhurave vjetore nga taksa vjetore e mjeteve të përdorura .

Të ardhurat nga TVMP-ja, për çdo rast mbledhen nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet drejtorive rajonale, dhe shpërndahen sipas procedurave të përcaktuara. Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor bën ndarjen e të ardhurave nga TVMP-ja për secilën njësi të qeverisjes vendore, mbështetur në vendbanimin e taksapaguesit sipas regjistrat të gjendjes civile ose adresës së ushtrimit të aktivitetit sipas adresës në QKB, sipas procedurave të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave. Nga shuma totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja, drejtoritë rajonale të DPSHTRR-së, pasi mbajnë komisionin prej 5(pesë)% të totalit mujor të arkëtimeve, 25 (njëzet e pesë)% e diferencës (25% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) të arkëtimeve e derdhen në llogarinë bankare të degës së thesarit të rrethit, ku është njësia e qeverisjes vendore. Pjesa tjetër e mbetur prej 75 (shtatëdhjetë e pesë) % (75% e 95% të totalit mujor të arkëtimeve nga TVMP-ja) paguhet për llogari të drejtorisë rajonale tatimore ku është e regjistruar DPSHTRR-ja (Drejtoria Rajonale Tatimore Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj) brenda datës 15 të muajit pasardhës. Rakordimi i pagesës së TVMP-së ndërmjet strukturave të DPSHTRR-së me organet tatimore të qeverisjes qendrore dhe vendore bëhet në bazë të regjistrat ditor të taksës vjetore të mjeteve të përdorura. Llogaritja e taksës bëhet nga sistemi informatik i DPSHTRR-së, pagesa e kësaj takse shoqërohet me faturë. Ky dokument prodhohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor dhe shpenzimet përballohen nga ky institucion në zbatim të nenit 8, pika 3, shkronja "c", të ligjit nr. 9975, datë 28.7.2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar). Fatura e taksës duhet të përmbajë elemente sigurie, për të shmangur falsifikimin e saj.

- ❖ **BAZA LIGJORE** : Neni 25 / b të Ligjit Nr. 68 / 2017, datë 24.04'2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" ; neni 4, pika 3 të Ligjit Nr. 9975 , datë 28.07'2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar) ; Udhëzimi Nr 26 datë 04.09'2008 "Për taksat kombëtare" (i ndryshuar) .

❖ **STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS** : Struktura e mbledhjes së kësaj takse është Drejtoria Rajonale e Shërbimeve të Transportit Rrugor , para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit . Bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore , njëzetepesë përqind (25%) të të ardhurave vjetore nga kjo taksë i kalon përkatësisht bashkisë Pukë në llogarinë e degës së Thesarit Pukë

TË ARDHURA PJESORE NGA TAKSA E RENTËS MINERARE :

BAZA E TAKSËS : Janë burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka çdo person fizik apo juridik , në çastin kur ai shet produktin . Çdo person fizik apo juridik , që është i licencuar dhe / ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjës për ekonominë , duhet të paguajë rentë minerare për burimet natyrore që nxjerr nga nëntoka . Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues , në çastin kur ai shet produkte minerare .

SPECIFIKA MBI TAKSËN :

Njësitë e qeverisjes vendore ku subjekti zotërues i lejes së shfrytëzimit zhvillon aktivitetin minerar, brenda datës 30 të çdo muaji, sipas formularit nr. 8 bashkëlidhur si pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, bëjnë rakordimin me drejtoritë rajonale të tatimeve dhe degët e doganave për rentën minerare të mbledhur prej tyre. Një kopje të rakordimit, njësitë e qeverisjes vendore, brenda datës 5 të muajit pasardhës, e dërgojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave .

Drejtoritë rajonale tatimore dhe degët doganore të cilat janë agjentë tatimorë, brenda datës 30 të çdo muaji dërgojnë informacion analitik pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në Ministrinë e Financave, për vlerën e rentës minerare të mbledhur, subjektin tatimor dhe njësitë e qeverisjes vendore ku kryhet aktiviteti, sipas formularit nr.9 bashkëlidhur këtij udhëzimi si pjesë përbërëse e tij .

Pjesa e të ardhurave nga renta minerale, sipas përqindjes së përcaktuar në Ligj, që u takon njësive të qeverisjes vendore shpërndahet nga strukturat përgjegjëse të buxhetit në Ministrinë e Financave. Ministria e Financave njofton zyrtarisht drejtorinë rajonale të tatimeve/doganave, respektive, dhe njësinë e qeverisjes vendore, për masën e llogaritit të shpërndarjes së të ardhurave nga renta minerale. Drejtoritë Rajonale të tatimeve dhe doganave paraqesin kërkesën për transferimin e fondit në degën përkatëse të thesarit. Dega e thesarit ku ndodhet drejtoria rajonale tatimore e tatimpaguesit procedon, duke përdorur metodën e transferimeve të brendshme në sistemin e informatizuar financiar të qeverisë .

- ❖ **BAZA LIGJORE** : Neni 25 / e të Ligjit Nr. 68 / 2017 datë 24.04'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " ; neni 4 , pika 4 të Ligjit Nr. 9975 datë 28.07'2008 " Për taksat kombëtare " (i ndryshuar) ; VKM Nr.7, datë 04.01'2012 " Për përcaktimin e procedurave dhe të dokumentacionit të nevojshëm për arkëtimin e taksës së Rentës Minerare " (i ndryshuar) ; Udhëzimi Nr. 26 , datë 04.09'2008 " Për taksat kombëtare " (i ndryshuar) .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS : Struktura e mbledhjes e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor . Degët e doganave në rrethe ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente , në rastin e eksportit të produkteve minerare , ndërsa degët e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente , në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit , (5%) e të ardhurave të realizuara nga kjo taksë i kalon përkatësisht bashkisë Pukë në llogarinë e degës së Thesarit Pukë .

TË ARDHURAT NGA TATIMI MBI TË ARDHURAT PËRSONALE :

Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve . Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë , 2 (dy) për qind e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale .

BAZA LIGJORE : Ligji Nr. 68 / 2017 datë 27.04'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " , neni 25 " Të ardhurat nga taksat e ndara " pika 2 , shkronja "ç", 2 % e të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale kalojnë njësitë të qeverisjes vendore ; Ligji Nr.8483 datë 28.12'1998 " Për tatimin mbi të ardhurat " (i ndryshuar) ; Udhëzimi Nr.5 datë 30.01'2006 " Për tatimin mbi të ardhurat " (i ndryshuar) .

TAKSA E TABELËS :

BAZA E TAKSËS : Taksa e tabelës aplikohet për të gjitha subjektet që duhet të vendosin emërtimin e subjektit në pamjen ballore të njësisë ku zhvillojnë veprimtarinë , në hapësira të tjera publike të lejuara ose private , qofshin këto të lëvizshme ose të palëvizshme dhe që shërbejnë për qëllime identifikimi .

Vendosja e tabelës për qëllime identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet me përjashtim të ambulantëve . Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit harton planin për vendosjen e mundshme të tabelave për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike .

NIVELLI I TAKSËS : Niveli i taksës së tabelës sipas kategorizimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, jepen në aneksin 7, bashkëlidhur këtij ligji .

1. Taksa e tabelës zbatohet për të gjithë subjektet, të cilët vendosin tabela, të lëvizshme apo të palëvizshme, për të identifikuar veprimtarinë e tyre ose për qëllime reklamimi të veprimtarisë së tyre apo dhe për të tretë, që vendosen në pamjen ballore të vendodhjes së veprimtarisë, ose brenda territorit të përbashkët në qendrat tregtare, ose në hapësira jashtë vendodhjes së veprimtarisë, qofshin këto publike ose private.

2. Për qëllime të zbatimit të këtij ligji, tabelat kategorizohen në :

i) Tabelë për qëllime identifikimi të veprimtarisë së subjektit, e trupëzuar ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve. Në të tilla tabela shënohet emri ose logo dhe/ose veprimtaria e subjektit. Në rastin e përdorimit të më shumë se një table identifikuese, vetëm njëra do të konsiderohet e tillë.

ii) Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e subjektit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim. Këto tabela shërbejnë vetëm si tabela orientuese dhe vendosen jashtë territorit ku zhvillohet aktiviteti, për orientimin e klientelës apo të publikut drejt vendndodhjes së veprimtarisë së subjektit.

iii) Tabelë për qëllime reklamimi, e lëvizshme ose e palëvizshme, e vendosur në pamje ballore ose jo ballore në vendin ku zhvillohet veprimtaria e subjektit, ose në hapësira të përbashkëta në qendrat tregtare, ose në hapësira të tjera publike apo private, si në tarraca, llozhe, ballkone, fasada, trotuare, shtylla, mbajtëse ajrore mbi pjesë të rrugëve qytetase apo kombëtare, etj., që kanë përmbajtje reklamimi për vete apo të tretët dhe që shërben si reklamë për të njoftuar, tërhequr vëmendjen ose për të joshur blerësit.

iv) Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

3. Taksa e tabelës është taksë vjetore . Bën përjashtim rasti kur tabela vendoset në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panairë, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj., për të cilat taksa llogaritet dhe paguhet vetëm për periudhën kohore të lejes së dhënë nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

4. Tabela përmban shkronja, logo, simbole apo figura, që mundësojnë identifikimin e veprimtarisë së taksapaguesit, apo që shërbejnë për qëllim orientimi, reklamimi ose ekspozimi. Si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës, shërben sipërfaqja në metër katror që zë tabela në të gjithë shtrirjen e saj. Në rastin kur tabela përbëhet vetëm nga germa të veçuara, simbole, logo apo figura të vendosura, të gdhendura, apo të pikturuara mbi një sipërfaqe ekzistuese, si mur, fasadë të jashtme të çdo lloji, shtyllë, kollonë, apo të ngjashme me to, dhe jo nga një sipërfaqe e vetme e shtrirë të shkruar, stampuar, apo pikturuar brenda saj, e cila vendoset mbi një sipërfaqe ekzistuese, si bazë vlerësimi për llogaritjen e taksës shërben sipërfaqja që zenë të gjitha shkronjat, figurat, logo dhe simbolet që formojnë tabelën. Kur në sipërfaqen e tabelës identifikuese përfshihen edhe germa, simbole dhe figura për qëllime reklamimi të një apo më shumë produktesh apo shërbimesh që furnizohen nga vetë njësia ku është vendosur tabela, kjo tabelë vlerësohet si tabelë identifikuese dhe taksa llogaritet për këtë kategori tabelle. Në rast të kundërt, tabela vlerësohet si tabelë reklamimi dhe taksa llogaritet për tabelën për qëllime reklamimi. Në rast të përdorimit nga taksapaguesi të më shumë se një tabelle identifikuese, përveç atyre orientuese, vlerësohet si tabelë identifikuese vetëm ajo tabelë që është e trupëzuar ose jo në njësinë apo brenda territorit ku ushtrohet veprimtaria e taksapaguesit, ose që ndodhet më pranë njësisë, ose vetëm një nga tabelat, kur ka më shumë se një të tillë në njësinë apo territorin ku ushtrohet veprimtaria e tij. Çdo tabelë tjetër e tillë konsiderohet si tabelë për qëllime reklamimi dhe taksa llogaritet dhe paguhet për këtë kategori tabelle.

5. Nivelet e taksës së tabelës sipas kategorizimeve të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, jepen në aneksin 7, bashkëlidhur këtij ligji.

6. Këshilli bashkiak është autoriteti i cili vendos nivelin e bazës së taksës për çdo kategori të tabelës të dhënë në aneksin 7, bashkëlidhur këtij ligji, si dhe miraton procedurën e mbledhjes së kësaj takse.

TAKSA E TABELËS SIPAS KATEGORIVE TË BASHKIVE :

Aneksi 7

Tab. 7

Nr.	LLOJET E TABELAVE	Njësia matëse	Bashki Kat. III^{të}
I.	Taksë tabelle për qëllime identifikimi, të trupëzuarta ose jo, brenda territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimtaritë e të tretëve ku shënohet emri dhe/ose aktiviteti biznesit)		
a.	deri në 2 m²	lekë/m ² /vit	0
b.	mbi 2 m² deri 10 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	7,000
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	11,500
	elektronike	lekë/m ² /vit	15,000
c.	mbi 10 m² deri 20 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	5,950
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	9,775
	elektronike	lekë/m ² /vit	12,750
ç.	mbi 20 m² deri 40 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	3,850
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	6,325
	elektronike	lekë/m ² /vit	8,250
d.	mbi 40 m²		
	e thjeshtë (pa ndriçim)	lekë/m ² /vit	2,800
	me ndriçim të thjeshtë	lekë/m ² /vit	4,600
	elektronike	lekë/m ² /vit	6,000
II.	Tabela për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelave për orientim		

	Tabela identifikuese	lekë/m ² /vit	120
III.	Tabelë për qëllime identifikimi e lëvizëshme e palëvizëshme deri në tavanin maksimal 35 m²		
	e thjeshtë me/pa ndriçim	lekë/m ² /vit	13,500
	elektronike	lekë/m ² /vit	27,000
IV.	Tabela në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.		
	të të gjitha llojeve dhe përmasave	lekë/m ² /vit	1,000

SQARIM : PËR TË GJITHA TABELAT PËR QËLLIME IDENTIFIKIMI APO REKLAMIMI TË CILAT NDODHEN JASHTË TERRITORIT TË OBJEKTIT KU ZHVILLOHET AKTIVITETI , SUBJEKTI PARAQET KËRKESË ME SHKRIM PRANË :

Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (Drejtorisë së Urbanistikës) e cila pasi shqyrton kërkesën e subjektit për leje , vendos për dhënien e saj ose jo . Në lejen e lëshuar detyrimisht përcaktohen vendi i ndodhjes , lloji i tabelës , përmasat etj . Një kopje e lejes së lëshuar dorëzohet në Zyren e Taksave dhe Tarifave Vendore . Kjo e fundit përllogarit dhe ndjek arkëtimin e taksës së reklamës / tabelës për vitin kalendarik nga muaji korent i vendosjes së saj , sipas përcaktimeve në lejen e lëshuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (Urbanistika) .

MËNYRA E PËRLLOGARITJËS :

Në llogaritjen e taksës për tabelat më të mëdha se 10 m², shumës së taksës së llogaritur për sipërfaqen deri 10 m² do ti shtohet shuma e taksës së llogaritur për diferencën e sipërfaqes mbi 10 m² të shumëzuar me tarifën përkatëse të taksës. P.Sh., një tabelë të thjeshtë 15 m², shuma e taksës vjetore do të llogaritet : (10m² * 15,000 lekë) + (5m² * 12,750 lekë) = 150,000 + 63,750 = 213,750 lekë / vit , ose 17,812 lekë / muaj) .
nëjta llogjikë llogaritje do të jetë edhe për sipërfaqet e tabelave mbi 20 m² dhe mbi 40 m² .
Për subjektet taksapaguese që vendosin më shumë se një tabelë identifikuese , vetëm njëra nga dy tabelat identifikuese do të konsiderohet si e tillë , kurse tabela tjetër do të konsiderohet si reklamë .
Çdo tabelë që kalon sipërfaqen 35 m², do të konsiderohet sikur është 35 m² dhe shuma e taksës llogaritet dhe paguhet vetëm për këtë sipërfaqe , pavarësisht madhësisë së saj në m² .

Në kategorinë e reklamës kuptojmë çdo publicitet , formë promovimi që shërben për të njoftuar , tërhequr vëmendjen ose joshur blerësit , të vendosur në pamje joballore , në tarraca , lozhë , ballkone , në pjesë të rrugës , shtylla etj ., që kanë përmbajtje me qëllime reklamimi për vete ose të tretët .

DETYRIMI DHE KËSTËT E PAGESËS : Detyrimi për Taksën e Tabelës është vjetor dhe për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një kësht .

A) Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e taksës së tabelës është deri me 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e taksës së tabelës me zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore, likuidimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të taksës së tabelës , dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë . (neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar) .

B) Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e taksës së tabelës është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

C) Afati i pagesës : Për institucionet afati për likuidimin e taksës së tabelës është deri me 31 Maj të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

Për subjektet , që duan të identifikohen me tabelë të re pas datës 20 qershor , detyrimi llogaritet dhe paguhet menjëherë për periudhën nga deklarimi .

Për subjektet, e reja detyrimi tatimor do të llogaritet që nga muaji korrent që subjekti regjistrohet pranë QKB dhe paguhet menjëherë. Taksa e tabelës për qëllime identifikimi paguhet për çdo njësi kusubjekti zhvillon aktivitetin nga muajikorrent që regjistrohet pranë QKB.

Për kategoritë tjera: detyrimi llogaritet sipas ditëve të përcaktuara në lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat përkatëse të bashkisë Pukë dhe paguhet menjëherë.

- ❖ **BAZA LIGJORE**: Neni 32, pikat 1 – 6, shkronjat (i – iv) të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10'2006 "Për sistemin e taksave vendore" (i ndryshuar), Aneksi 7 (Ndryshuar me ligjin nr. 142 / 2015, datë 17.12'2015; Ligjin Nr. 106 / 2017 datë 30.11'2017; Ligjin Nr. 95 / 2018 datë 03.12'2018;

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJËN E TAKSËS :

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës së tabelës është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Territorit pranë Bashkisë Pukë.

Për Kategorinë Tabelë për qëllime reklamimi, të thjeshta dhe elektronike: Drejtoria e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit (Urbanistika) ngarkohet për shqyrtimin e kërkesës nga ana e subjektit, si dhe për hartimin e dokumentacionit të plotë të marrjes së lejes për vendosjen e reklamave dhe përcaktimin e sipërfaqeve objekt taksimi. Kjo Drejtori njofton në mënyrë periodike Drejtorinë e të Ardhurave (Zyren e Taksave dhe Tarifave Vendore) në lidhje me të gjitha ndryshimet në sipërfaqe (shitesa apo pakësime) që janë objekt i kësaj takse.

KAPITULLI II - të :

TARIFAT VENDORE :

Ky kapitull trajton tarifën vendore në mënyrë nominale duke u nisur nga elementët :

Llojit të shërbimit, nivelit të tarifës bazuar në koston e shërbimit, baza e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, kështu e pagimit, koha e kryerjes së tyre, kushtet lehtësuese, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë.

TARIFA E SHËRBIMEVE PUBLIKE (PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETJEVE , NDRICIMIT DHE DEKORIT).

PËRKUFIZIMI : " Tarifë e pastrimit dhe largimit të mbeturinave " është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të bashkisë Pukë dhe njësisë të saj administrative.

Tarifës së pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Pukë dhe njësisë të saj administrative.

Tarifë e shërbimeve publike paguhet nga familja, personat fizikë e juridikë për çdo vendndodhje të tyre. Nga përlllogaritja e koston e shërbimit të pastrimit dhe blerjes së kazanëve (kontenierëve), të transportit të mbeturinave që ofrohet nga Bashkia Pukë, kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të Tarifës së Pastrimit dhe Largimit të Mbeturinave për Bashkinë Pukë, ku ofrohet ky shërbim, kjo dhe për Njësitë Administrative, janë të shprehura si më poshtë :

Niveli i tarifës së shërbimeve publike (Niveli i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave / mbetjeve)
Kategoritë , nënkategoritë dhe nivelet treguese janë të shprehura si më poshtë :

KATEGORITË TAKSAPAGUESE:

Kategoritë dhe nënkategoritë taksapague, objekt i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave janë si më poshtë:

1) Familjet me dy nënkategori :

- a. Familjet në ndihmë ekonomike
- b. Familjet e tjera (që nuk trajtohen me ndihmë ekonomike)

2) Subjektet private / tregtare dhe kategorizimi i tyre :

- a. Subjektet përsonat fizike
- b. Subjektet përsonat juridik

c. Organizatat jo fitimprurëse , shoqatat , fondacionet etj të ngjashme me to .

d. Ambulantët

3) Subjektet shtetërore ...

a. Institucionet.,

TAKSAPAGUESIT FAMILJARË :

NIVELI I TARIFES SE PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETJEVE KU OFROHET SHERBIMI

Tab. 8

Nr.	Kategoritë , familjarët	Niveli i Tarifës	
		Lekë / Vit	
		Familjet me Nd.Ek	Familjet Pa Nd.Ek
1.	Nj.Ad.Qendër (Bashkia Pukë)	850	1.700
2.	Nj.Ad Gjegjan	300	500
3.	Nj.Ad Rrape	300	500
4.	Nj.Ad Qerret	300	500
5.	Nj.Ad Qelez	300	500

SUBJEKTET PERSONA FIZIK :

TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT .

Tab. 9

Nr.	TARIFA E PASTRIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	Bylmet , fruta , mish , peshk , perime ushqimore e artikuj të tjerë të ngjashme me to .	" "	10.000
2.	Artikuj industrial (veshmbathje , parfumeri , argjendari etj) .	" "	10.000
3.	Bar – Kafe , Fast – food , Kafe – internet , Floktore etj .	" "	10.000
4.	Restorante , mengjezore , e tjera të këtij lloji .	" "	10.000
5.	Njësi shërbimi , këpucar , biçiklist , berber e tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
6.	Lojra kompjuterike për fëmijë e tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
7.	Punime e përpunim duralumini , metalesh , druri etj .	" "	10.000
8.	Prodhime ushqimore , ëmbëltore , byrektore , buke etj .	" "	10.000
9.	Riparim artikuj elektro – shtëpiak , televizor , frigorifer , lavatriçe e tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
10.	Shërbime fotografike , fotokopje , sallone bukurie , rrobaqepësi , bilardo , ambiente sportive , fitnes , palestër , marangoz , këpuctar , lavazh e tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
11.	Shërbime si TV Kabllor e të tjera të ngjashme të këtij lloji .	" "	10.000
12.	Farmacitë bujqësore , veterinarë etj .	" "	10.000
13.	Shitje produktesh farmaceutike dhe të tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
14.	Tregtim artikuj të # industrial veshje , parfumeri , argjendari etj .	" "	10.000
15.	Tregtim materialesh ndertimi e tjerë të ngjashëm me to .	" "	10.000
16.	Bar - Kafe	" "	10.000
17.	Restorante , fast – foode , etj të ngjashme me to .	" "	10.000
18.	Kafe internet , qendra interneti etj .	" "	10.000
19.	Riparimi i artikujve elektro – shtëpiake , radiove , televizorve , frigoriferve , lavatriçe e të tjerë të ngjashëm me to .	" "	10.000
20.	Sherbime agjensi kembimi valute , agjensi turizmi , agjensi sigurimesh etj të ngjashme me to .	" "	10.000
21.	Sherbime fotokopimit , sallon bukurie , autoservise , kurse per makina (autoshkolla) , per kompjuter , parukeri , sallat e lojrave te ndryshme	" "	10.000

	gjimnastike , aerobie , kende lojrash per femije , pingpong e të tjera te ngjashme me to .		
22.	Njësi shërbimi marangoz , rrobaqepës , këpucar , floktore , orëndreqës etj .	" "	10.000
23.	Salla sportive , palestra , fitness e të tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
24.	Lojra me kompjuter , lojra fëmijësh të hapura dhe të mbyllura .	" "	
25.	Avokat , noter , mjek , laborant , stomatolog , ekonomist kontabël i miratuar , mësues , veteriner , agronom , botues , inxhinier , arkitekt , projektues e të tjera profesione te lira të cilat ushtrohen në njësi fikse apo në ambiente të ndryshme e të tjerë të ngjashëm me to .	" "	10.000
26.	Klinika dentare , farmaci humanitare , laboratore mjeksore e të tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
27.	Shërbime artizanale e të tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
28.	Prodhim tulla , tjegulla , blloqe betony , furra gelqereje , nyje inerte e të tjera të ngjashme me to .	" "	10.000
Për njësitë administrative tjera niveli tarifës së shërbimit të pastrimit - 50 % e nivelit tarifar të Bashkisë Pukë sipas emërtesave të mësipërme .			

SUBJEKTET PËRSONA JURIDIK :

TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT .

Tab.10

Nr.	TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT PËR PËRSONAT JURIDIK PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	Me objekt veprimtarie ndërtimi dhe tregtimi me pakicë e shumicë i karburanteve e të tjera të ngjashme me to si : Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi , objekte banimi , shërbimi , të përbëra etj të ngjashme me to , njësi tregtimi lëndësh djegëse , hidrokarbure , karburante , etj të ngjashme me to .	Lekë / vit / njësi	35.000
2.	Me objekt veprimtarie prodhime e të tjera të ngjashme me to si : Punime duralumini , metalesh , druri , përpunim mermeri , prodhim blloqe betoni , furra gëlqereje , prodhim tulla , tjegulla , materiale ndërtimi , prodhim konfeksione etj .	" "	28.000
3.	Me objekt veprimtarie shërbime e të tjera të ngjashme me to si : Riparimi i artikujve elektro - shtëpiake , radiotelevizore , frigoriferë , lavatriçe , paisje fonie , shërbime fotokopjimit , sallone bukurie , kurse për makina (autoshkolla) , agjensi këmbimi valute , agjensi turizmi , agjensi transporti , lavaxeritë , pastrimi kimik , shërbime të rojeve civile , autoserviset , shtëpitë botuese , rrobaqepës , këpucar , floktore , orëndreqës , komplekse , restorante , hotele , palestra , fitnes etj .	" "	21.000
4.	Me objekt veprimtarie transporte e të tjera të ngjashme me to .	" "	21.000
5.	Profesionet e lira e të tjera të ngjashme me to si : farmacist , programues it-je , vlerësues i pasurisë , avokat , noter , permbarues , konsulent / këshillues në ekonomi , ekspert kontabel i regjistruar , kontabilist i miratuar , arkitekt , inxhinier , projektues ,	" "	21.000

	agronom , përkthyes , shoqërues dhe shpjegues në udhëtime , vereriner , mësues , tranues i artit dhe sportit , mjek , dentis , fzioterapist etj .		
6.	Shitje me pakicë dhe shumicë si : Mish , peshk , bulmet , fruta , perime , ushqimore , artikuj industrial , bar kafe , byrektore , fast food restorante , magazina dyqane etj .	" "	21.000
Subjektet e ndërtimit sipas vlerës së investimit dhe kohëzgjatjes sipas kontratës për kantier ndërtimi .			
1.	Për vlera investimi deri në 5.000.000 lekë	Lek/Kan/Vit	50.000
2.	Për vlera investimi deri në 5.000.001 – 15.000.000 lekë	" "	100.000
3.	Për vlera investimi deri në 15.000.001 – 25.000.000 lekë	" "	150.000
4.	Për vlera investimi deri në 25.000.001 – 50.000.000 lekë	" "	200.000
5.	Për vlera investimi deri në 50.000.001 – 100.000.000 lekë	" "	250.000
6.	Për vlera investimi deri në 100.000.001 – 200.000.000 lekë	" "	300.000
7.	Për vlera investimi mbi – 200.000.000 lekë	" "	350.000

SUBJEKTET SHOQËRI AKSIONARE :
TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT .

Tab.10/1

Nr.	TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT PËR SHOQËRIT AKSIONARE PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	" ONE ALBANIA " sh.a , e të tjera të ngjashme me to .	Lekë / vit / njësi	100.000
2.	" VODAFONE ALBANIA " sh.a , e të tjera të ngjashme me to .	" "	100.000
3.	" RAIFFEISEN BANK " sh.a , e të tjera të ngjashme me to .	" "	100.000
4.	" OSHEE GROUP " sh.a , e të tjera të ngjashme me to .	" "	100.000
5.	" FURNIZUESI I SHERBIMIT UNIVERSAL " sh.a , e të tjera të ngjashme me to .	" "	100.000
6.	" UJSJELLES KANALIZIME PUKE " sh.a , e të tjera të ngjashme me to .	" "	100.000

SHOQATAT, FONDACIONET E TE JERA ORGANIZATA JOFITIMPRURESE :
TARIFA E PASTRIMIT DHE LARGIMIT TË MBETJEVE :

Tab. 11

Nr.	TARIFA E PASTRIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	Shoqata, fondacione, organizata jofitimprurese e të tjera të ngjashme me to .(pavarësisht selisë administrative)	Lekë/vit/njësi	10.000

AMBULANTËT :

Tab. 12

Nr.	TARIFA E PASTRIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	Subjekte që nuk kanë një vendndollje fikse, taksi, tregtia ambulante në tregje publike .	Lekë/vit/njësi	1.000

INSTITUCIONET BUXHETORE DHE JOBUXHETORE :
TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT .

Tab. 13

TARIFA E SHËRBIMIT TË PASTRIMIT PËR VITIN 2026		NJËSIA	VLERA
Nr.		Lekë/vit/njësi	
1.	Agjensia Shtetërore e Kadastres Pukë	" "	60.000
2.	Zyra Postare Pukë	" "	60.000
3.	Dega Thesarit Pukë	" "	60.000
4.	Agjensia Lokale Sigurimeve Shoqërore Pukë	" "	60.000
5.	Gjykata e Rrethit Pukë	" "	60.000
6.	Prokuroria e Rrethit Pukë	" "	60.000
7.	Zyra Përmbarimore Pukë	" "	60.000
8.	Zyra Vendore e Punësimit Pukë	" "	60.000
9.	N/Prefektura Pukë	" "	60.000
10.	Komisariati Policisë Pukë	" "	60.000
11.	Drejtoria e Rezervave Materiale të Shtetit Pukë	" "	60.000
12.	Zyra Vendore Arsimore Pukë	" "	80.000
13.	Drejtoria Shërbimit Spitalor Pukë	" "	80.000
14.	Drejtoria Shendetit Publik Pukë	" "	30.000
15.	Qendra Shëndesore Pukë	" "	30.000
16.	Qendra Shëndesore Gjegjan	" "	30.000
17.	Qendra Shëndesore Rrape	" "	30.000
18.	Qendra Shëndesore Qerret	" "	30.000
19.	Qendra Shëndesore Qelez	" "	30.000

Tarifa e Shërbimit Publik (Pastrimit) për bizneset e të gjitha llojeve do të kryhet me një këst të vetëm , të përfshirë në Faturën për Arkëtim , të nxjerrë nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore (Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore) .

- ✓ Për familjarët që kanë kontratë me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A Pukë. Tarifa e Shërbimit Publik do të paguhet me 12 këste të barabarta nga ____ lekë / muaj , të përfshira në faturën e ujit të pijshëm . Kurse për familjarët që nuk kanë kontratë me Ujësjetllës - Kanalizime sh.a – Pukë , taksa e ndërtesës do të paguhet me një këst të vetëm,në të njëjtën kohë me Taksën e Ndërteses dhe Taksën e Tokës Bujqësore për familjet që banojnë në fshat .

Ne rolin e agjencit tatimor është Ujësjetllës - Kanalizime sh.a . Pukë i cili përcaktohet me marrëveshje të veçantë ndërmjet dy institucioneve përkatëse .

MËNYRA E PAGESËS :

Detyrimi për Tarifën e Shërbimeve është vjetorë .

Kategoria I.- rë . " Familjarët " :

Detyrimi paguhet me këste mujore të barabarta ,të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, për abonentët familjarë të cilët kanë kontratë me Ujësjetllës - Kanalizime sh.a Pukë . Për familjet që nuk kanë kontratë me Ujësjetllësin detyrimet paguhet me një këst të vetëm pranë Njesisë Administrative ku ata banojnë. Për çdo familje të krijuar rishtaz, afati i pagesës së tarifës së shërbimeve publike do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj. Detyrimi llogaritet dhe paguhet për familje. Për të llogaritur detyrimin për tarifën e shërbimeve kjo kategori duhet të paraqesë pranë zyres së taksave të Bashkisë Pukë çertifikatën e gjendjes familjare të lëshuar nga zyra e Gjendjes Civile .

Kategoria II.- të . " Biznesi " :

Detyrimi për tarifën e pastrimit dhe largimit të mbetjeve (mbeturinave) është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një këst .

A) Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve (mbeturinave) është deri me 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve me

zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore, likujdimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve, dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjobë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë . (neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar) .

B) Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likujdimin e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve (mbeturinave) është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjobë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

C) Afati i pagesës : Për institucionet afati për likujdimin e tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve (mbeturinave) është deri me 31 Maj të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonësë (Gjobë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

Ç) Likujdimi do bëhet pranë Degës së Raiffeisen Bank. Për familjarët likujdimi i tarifës së pastrimit dhe largimit të mbetjeve (mbeturinave) është gjithëvjetor me likujdim të menjëhershëm, ose ndarë në muaj me faturën e ujit pijshëm, kur agjent tatimor është NUK-ja Pukë .

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 20 Mars është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKB.

Për kategorinë "**Subjekte Ndërtimi**" nënkategorinë " Njësi ndërtimi për çdo kantier ndërtimi, etj. të ngjashëm me to " Rikonstruksione të pjesshme për çdo kantier ndërtimi, rrugë, shkolla, kopshte, objekte banimi e tregtare, etj. të ngjashëm me to", llogaritja e taksës bëhet për periudhën nga momenti i ngritjes së kantierit të ndërtimit deri në momentin e dorëzimit nga subjekti pranë strukturave të bashkisë Pukë të kërkesës për leje shfrytëzimi .

Të gjitha subjektet ndërtuese kontraktuese përpara fillimit të punimeve duhet të aplikojnë në Q.K.B për hapjen e adresës dytësore të vendit të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshme nga selia (sipas vendndodhjes të objektit të kontratës) si dhe të kryejnë të gjitha pagesat për taksat dhe tarifatat vendore ndaj bashkisë Pukë për këtë vendndodhje të ushtrimit të veprimtarisë të ndryshme nga selia administrative .

Struktura e ngarkuar për kontrollin dhe moslejimin e fillimit të punimeve në rast të mos plotësimit të kushteve të mësipërme është Drejtoria e Menaxhimit të Kontratave (sektorët që hartojnë kontratat) pranë Bashkisë Pukë dhe Drejtoria e Financës e cila nuk do kalojë asnjë detyrim kontraktual në rast të mos plotësimit të kushteve të mësipërme .

PËR TË GJITHA KATEGORITË :

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar taksën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë, gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

PËRJASHTIME PËR KATEGORI TË NDRYSHME :

Përfshijet për individët dhe familjet nga tarifa e pastrimit .

Invalidët e punës , të verbërit , të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (Kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit / bashkëshortës) në masën 50 % të vlerës së tarifës .

Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit / bashkëshortës) në masën 50 % të vlerës së tarifës .

Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç)

- a) Nënkategoritë 1-3 përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së pastrimit (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç) .

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë Zyres së Taksave dhe Tarifave Vendore dëshmitë e gjendjes së tyre dhe konkretisht :

- Statusin e invalidit të punës , statusin e të verbërit , librezën për paraplegjik e tetraplegjik , librezën e pensionit etj dokumente të parashikuara në legjislacionin përkatës .

- b) Në kategorinë " Biznesi " , fermerët që janë të regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.11'2014 " Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompesimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar " , përjashtohen nga tarifatat vendore për biznesin .

- c) Përjashtohen nga tarifa vendore : Institucionet , subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Pukë, Institucionet dhe subjektet e varësisë së bashkisë Pukë : Institucionet që shpenzimet operative ja mbulon vetë bashkia Pukë si dhe komunitetet fetare të njohura me ligj .

- ❖ **BAZA LIGJORE:** neni 35, pika 2 e ligjit nr.9632 / 2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), neni 9, pika 1 /3b, neni 32, neni 33, neni 35, pika 5/a, neni 54, pikat "dh" e "f" të ligjit nr.139 / 2015 " Për vetëqeverisjen vendore "(i ndryshuar), neni 2, pika 4, neni 6, pika "c", neni 7, pika 1, neni 14, pika 2, pika 4 dhe 5/b të ligjit nr.68 / 2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar), Vendimi nr.319 / 2018 " Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve " (i ndryshuar) .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TAKSËS :

Për Kategorinë " Familjarët ", struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit , është Ndërmarrja e Ujësjiellës Kanalizimeve Pukë .
Për Kategorinë " Biznesi ", struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së pastrimit , është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Pukë .

TARIFA E GJELBRIMIT :

Përkufizimi : Tarifa e gjelbrimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të bashkisë Pukë dhe njësisë të saj administrative. Tarifa e gjelbrimit paguhet nga familjet të cilat banojnë brenda (qytetit Pukë) dhe janë përfitues direkt nga investimet e realizuara për krijimin dhe shtimin e hapësirave të gjelbërta , si dhe bizneset vendas ose të huaj, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë brenda territorit të bashkisë Pukë, shoqatat dhe institucionet .

Kategoritë, nënkategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbrimit, janë të shprehura si më poshtë :

Tab. 13

Nr.	Kategoritë dhe nivelet treguese të tarifës së gjelbrimit	Lek / Vit njesi	Vlera
1.	Tarifë gjelbrimi për familjet rezident në NjA.Qendër Pukë (Për familjet që banojnë brenda qytetit Pukë)	" "	100
2.	Tarifë gjelbrimi për biznesin e vogël	" "	500
3.	Tarifë gjelbrimi për biznesin e madh	" "	1.000
4.	Tarifë gjelbrimi për shoqatat	" "	500
5.	Tarifë gjelbrimi për institucionet	" "	2.000

Nga kjo tarifë përjashtohen njësitë administrative Gjegjan , Rrape , Qerret dhe Qelez duke përfshirë të gjitha kategoritë e tatimpaguesve .

A) Afati i pagesës : Për kategorinë " Familjarët ", detyrimi paguhet në 12 këste të barabarta, për çdo muaj për çdo familje. Ky detyrim do të evidentohet në faturën e konsumit të ujit pijshëm. Likuidimi i kësaj pagese do të kryhet njëkohësisht me pagesën e konsumit të ujit pijshëm . Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së gjelbrimit do të jetë 30 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjëndjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj .

B) Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e tarifës së gjelbrimit është deri me 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e tarifës së gjelbrimit me zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore, likuidimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të tarifës së gjelbrimit , dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit .(neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar) .

C) Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e tarifës së gjelbrimit është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit .

Ç) Afati i pagesës : Për institucionet afati për likuidimin e tarifës së gjelbrimit është deri me 31 Maj të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 dit .

PËRJASHTIME PËR KATEGORI TË NDRYSHME :

Përfashtimet për individët dhe familjet nga tarifa e gjelbrimit .

Invalidët e punës , të verbërit , të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (Kryefamiljarë) pa përsone madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit / bashkëshortës) në masen 50 % të vlerës së tarifës .

Kryefamiljarë pensionistë pa përsone madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit / bashkëshortës) në masen 50 % të vlerës së tarifës .

Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç) .

- a) Nënkatëgoritë 1-3 përfashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së gjelbrimit (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa përsone madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç) .

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë Zyres së Taksave dhe Tarifave Vendore dëshmitë e gjendjes së tyre dhe konkretisht :

-Statusin e invalidit të punës , statusin e të verbërit , librezën për paraplegjik e tetraplegjik , librezën e pensionit etj dokumente të parashikuara në legjislacionin përkatës .

- b) Në katëgorinë “ Biznesi ” , fermerët që janë të regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.11.2014, “ Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompesimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar ” , përfashtohen nga tarifat vendore për biznesin .

c) Përfashtohen nga tarifa vendore : Institucionet , subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Pukë, Institucionet dhe subjektet e varësisë së bashkisë Pukë : Institucionet që shpenzimet operative ja mbulon vetë bashkia Pukë si dhe komunitetet fetare të njohura me ligj .

ç) Përfashtohen nga tarifa e gjelbrimit njësitë administrative Gjegjan, Rrape, Qerret dhe Qelez duke përfshirë të gjitha katëgoritë e tatimpaguesve .

- ❖ **BAZA LIGJORE:** Neni 9, pika 1.3/b , neni 23/9 të Ligjit nr. 139 /2015 , datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , neni 14 " Tarifat vendore " , pikat 1 - 4 , gërma “e” , e ligjit nr.68 /2017, datë 27.04'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " .

STRUKTURA PËR VJELJËN E KËSAJ TARIFE :

Për Katëgorinë “ Familjarët ” , struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbrimit , është Ndërmarrja e Ujësjellës Kanalimeve Pukë .

Për Katëgorinë “ Biznesi ” , struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbrimit , është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Pukë .

Për Katëgorinë “ Institucione ” , struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së gjelbrimit , është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Pukë .

TARIFA E NDRICIMIT :

Përkufizimi : Tarifa e ndriçimit është një pagesë, që bëhet drejtpërdrejt apo nëpërmjet një nëpunësi tek administrata tatimore vendore në shkëmbim të shërbimit të marrë, për një familje, person fizik apo juridik, vendas ose të huaj, që banojnë/janë rezidentë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë Pukë dhe njësitë të saj administrative .

Në njësitë administrative Pukë , shërbimi i ndriçimit rrugor ofrohet në qytetin Pukë dhe disa lagje të saj , gjithashtu ky shërbim ofrohet dhe në qendrat e Njësitë Ad. Gjegjan dhe Luf- Qerret (qëndra – Gjegjan & qyteza Luf) . Eshatrat apo lagjet e njësitë administrative Pukë , Gjegjan , Rrape , Qerret dhe Qelëz , ku nuk ofrohet shërbimi i ndriçimit rrugor janë të përfashtuara nga kjo tarifë . Të ardhurat nga tarifa e ndriçimit rrugor janë të ardhura vendore dhe derdhen 100% për buxhetin vendor. Destinacioni përdorimit të të ardhurave nga tarifa e ndriçimit rrugor është financimi i shpenzimeve të shërbimit të ndriçimit rrugor. Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki, së bashku me të dhënat për taksën e ndërtesës për katëgorinë e ndërtesave të banimit, tarifës së pastrimit dhe largimit të mbeturinave për abonentët familjarë vënë në dispozicion të Ndërmarrjes së Ujësjellësit listën e familjeve objekt i tarifës së ndriçimit rrugor për katëgorinë familje. Të dhënat për familjet në ndihmë ekonomike merren brenda muajit Janar të vitit ushtrimor nga Zyra e Ndihmës Ekonomike në Bashki. Për subjektet private, ndërmarrjet dhe institucionet, Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashki është përgjegjëse për arkëtimin dhe administrimin e të ardhurave nga tarifa e ndriçimit rrugor .

Niveli tarifës së ndriçimit rrugor për Njësitë Administrative ku ofrohet shërbimi i ndriçimit tarifohe me 50 % të Bashkisë Pukë, ndërsa aty ku nuk ofrohet shërbimi i ndriçimit nuk aplikohet Tarifë Ndriçimi, pasi nuk u kryhet (ofrohet) ky shërbim.

KATEGORITË, NËNKATEGORITË DHE NIVELET TREGUESE TË TARIFËS SË NDRICIMIT TË SHPREHURA SI MË POSHTË VIJON.

TARIFË NDRICIMI PËR FAMILJE :

Tab. 13

Nr.	Kategoritë, familjarët	Niveli Tarifës	
		Lekë/Vitë	
		Familjet me Nd.Ek	Familjet Pa Nd.Ek
1.	Nj.Ad .Qendër (Bashkia Pukë)	100	200

TARIFË NDRICIMI PËR BIZNESIN E VOGËL / PËRSONAT FIZIK :

Tab. 14

Nr.	TARIFA E NDRICIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	BIZNES I VOGEL	Lekë/vit/njësi	1.500

TARIFË NDRICIMI PËR BIZNESIN E MADH / PËRSONAT JURIDIK :

Tab. 15

Nr.	TARIFA E NDRICIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	BIZNES I MADH	Lekë/vit/njësi	2.500

TARIFË NDRICIMI PËR SHOQATAT :

Tab. 16

Nr.	TARIFA E NDRICIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	SHOQATAT	Lekë/vit/njësi	1.500

TARIFË NDRICIMI PËR INSTITUCIONET :

Tab. 17

Nr.	TARIFA E NDRICIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	INSTITUCIONET	Lekë/vit/njësi	20.000

TARIFË NDRICIMI PËR INSTITUCIONETT (QENDRAT SHËNDETËSORE) :

Tab. 18

Nr.	TARIFA E NDRICIMIT PËR VITIN 2026	NJËSIA	VLERA
1.	INSTITUCIONET (Qendrat Shendetësore)	Lekë/vit/njësi	10.000

Kategoria " Familjarët " :

Detyrimi për familjarët shlyhet në bazë mujore si pjesë përbërëse e faturës së shërbimit të furnizimit me ujë ose vetëm për tarifën vendore, pranë Ujësjetellës Kanalizime sh.a Pukë.

Familjarët, të cilët nuk kanë kontratë me ujësjetellësin faturohen direkt nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë, me bazë vjetore. Për çdo familje të re, afati i pagesës së tarifës së pastrimit do të jetë 60 ditë nga dita e regjistrimit të saj në Zyrën e Gjendjes Civile përkatëse dhe detyrimi tatimor do të llogaritet nga muaji korrent i regjistrimit të saj.

Kategoritë " Biznes " :

Detyrimi për tarifën e ndriçimit është vjetor. Për të gjitha kategoritë ky detyrim paguhet me një kësht.

A. Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e tarifës së ndriçimit është deri me 20 Mars të vitit ushtrimor 100 % e tarifës së ndriçimit me zbritje 10 % të vlerës si lehtësi tatimore, likuidimi deri 20 Shtator 100 % e detyrimit të tarifës së ndriçimit, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë (neni 114 i Ligjit nr.9920/2008 i ndryshuar).

B. Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e tarifës së ndriçimit është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

C. Afati i pagesës : Për institucionet afati për likuidimin e tarifës së ndriçimit është deri me 31 Maj të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masen 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

Ç. Likuidimi do bëhet pranë Degës së Raiffeisen Bank. Për familjarët likuidimi i tarifës ndriçimit është gjithëvjetor me likuidim të menjëhershëm, ose ndarë në muaj me faturën e ujit pijshëm, kur agjent tatimor është NUK-ja Pukë .

Afati i pagesës për detyrimet e lindura pas dates 20 Mars është 30 ditë pas lindjes së detyrimit. Për subjektet e regjistruara rishtas detyrimi tatimor do të llogaritet për çdo njësi ku subjekti kryen aktivitet nga muaji korrent i regjistrimit prane QKB .

Për të gjitha kategoritë :

Nëse subjekti taksapagues pushon veprimtarinë gjatë vitit, detyrimi tatimor llogaritet duke shumëzuar tarifën për vitin e plotë kalendarik me numrin e muajve të plotë gjatë të cilëve veprimtaria është kryer (përfshirë muajin korrent për të cilin është bërë kërkesa) dhe duke e pjesëtuar atë me 12 muajt e vitit kalendarik fiskal.

- ❖ **BAZA LIGJORE :** Neni 9, pika 1.3/b , neni 23 pika 5 e Ligjit Nr. 139 /2015 datë 17.12'2015
Për vetëqeverisjen vendore ", neni 14, pikat 1 - 4 të Ligjit Nr.68 /2017 datë 27.04'2017
financat e vetëqeverisjes vendore " .

"
" Për

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Për Kategorinë : " Familjarët ", Rolin e agjentit tatimor e luan Ndërmarrja e Ujësllës Kanalizimeve Pukë e cila në rolin e agjentit tatimor shpërndan dhe arkëton përgjatë gjithë vitit buxhetor (Janar – Dhjetor) detyrimin për tarifën e ndriçimit , pastrimit dhe largimit të mbeturinave , sipas listës pagesave (listës së detyrimit për çdo familje) të vënë në dispozicion nga Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore e bashkisë Pukë. Ndërmarrja e Ujësllës derdh në bankë çdo ditë shumat e arkëtuara nga tarifa e ndriçimit , pastrimit dhe largimit të mbeturinave dhe njëherësh dorëzon listën e personave të cilët kanë shlyer detyrimin konform procedurave të miratuara në **Akt - Marrëveshjen** midis palëve të nënshkruar më parë me Nr. 1994 Prot., datë 25.10'2017 për bashkinë Pukë dhe Nr. 457 Prot., datë 25.10'2017 për NUK – në , bashkia Pukë .

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit, për kategorinë " Familjarët " është Ndërmarrja e Ujësllës Kanalizimeve Pukë .

Për Kategoritë : " Institucione shtetërore administrative, arsimore, kulturore, shëndetsore, sportive, etj...
OJF " dhe " Biznesi " , struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë .

Përjashtime për kategori të ndryshme :

Përjashtimet për individët dhe familjet nga tarifa e ndriçimit .

Nivalidët e punës, të verbërit, të sëmurët paraplegjik dhe tetraplegjik (Kryefamiljarë) pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit / bashkëshortës) në masen 50 % të vlerës së tarifës .

Kryefamiljarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim (përveç bashkëshortit / bashkëshortës) në masen 50 % të vlerës së tarifës .

Kryefamiljarët gra me minimumi një fëmijë në ngarkim (nën 22 vjeç)

- a) Nënkategoritë 1-3 përjashtohen apo lehtësohen nga pagesa e tarifës së pastrimit (vetëm në rastet kur janë familjarë pensionistë pa persona madhorë në ngarkim mbi moshën 22 vjeç)

Këto grupe duhet të dorëzojnë pranë Zyres së Taksave dhe Tarifave Vendore dëshmitë e gjendjes së tyre dhe konkretisht :

-Statusin e invalidit të punës, statusin e të verbërit, librezën për paraplegjik e tetraplegjik, librezën e pensionit etj dokumente të parashikuara në legjislacionin përkatës .

b) Në kategorinë : " Biznesi ", fermerët që janë të regjistruar me NIPT sipas vërtetimit nga Drejtoria Rajonale Tatimore sipas Udhëzimit Nr.19, datë 03.11.2014, " Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompesimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar ", përjashtohen nga tarifa vendore për biznesin .

c) Përjashtohen nga tarifa vendore : Institucionet , subjektet dhe organizatat në pronësi të bashkisë Pukë, institucionet dhe subjektet e varësisë së bashkisë Pukë : Institucionet që shpenzimet operative ja mbulon vetë bashkia Pukë : Komunitetet fetare të njohura me ligj .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Për Kategoria " Familjarët ", struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit , është Ujësjiellës Kanalizime sh.a - Pukë .

Kategoritë : " Institucione shtetërore administrative , arsimore , kulturore , shëndetsore , sportive , etj., " OJF " dhe " Biznesi ", struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së ndriçimit është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë Bashkisë Pukë .

TARIFA PËR ZËNJEN E HAPSIRËS PUBLIKE :

Përkufizimi : Tarifa për zënie e hapsirave publike paguhet për zënie e hapsirave publike .Tarifa llogaritet si detyrim mujor i subjektit / individit .

BAZA E TARIFËS :

Baza e tarifës për zënie të hapsirave publike është sipërfaqja në m² , e cila vihet në shfrytëzim nga individë dhe subjekte për qëllime biznesi , aktivitete etj...

NIVELI I TARIFËS PËR ZËNIEN E HAPSIRAVE PUBLIKE .

Tab 19.

Nr.	ZËNIA E HAPËSIRAVE PUBLIKE	Tarifa në 2026
A	Zënia e hapësirës publike nga subjektet përsona fizik e juridik rezident dhe me seli administrative në Bashkinë Pukë .	zero lekë / m ² / muaj
B	Zënia e hapësirës publike nga subjektet përsona fizik e juridik jo rezident dhe me seli administrative jashtë territorit të Bashkisë Pukë .	100 lekë / m ² / muaj
C	Zënia e hapësirës publike ditore nga individ , subjekte , përsona fizik , përsona juridik , shoqata e të tjera të ngjashme me to , jo rezident në Bashkinë Pukë dhe me seli administrative jashtë territorit të Bashkisë Pukë, të cilët kanë për qëllim ekspozimin , promovimin e shitjeve të produkteve , shërbimeve e të tjera të ngjashme me to .	100 lekë / m ² / ditë por jo më pak se 1.500 lek

- ❖ **Për vitin 2026 , përjashtohen nga tarifa për zënie e hapësirës publike gjatë sezonit verorë të gjithë subjektet përsona fizik e juridik rezident / dhe me seli administrative në Bashkinë Pukë të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre ekonomiko – tregtar .**

DETYRIMI PËR PAGESEN :

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit harton planin për zënie e hapsirës publike në të gjithë territorin e bashkisë Pukë , ku përcakton zonën , sipërfaqen , periudhën dhe qëllimin e lejuar të shfrytëzimit . Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit pranë bashkisë Pukë , lidhur me administrimin e hapësirave publike , bazuar në VKM - në Nr.1096 datë 28.12'2015 " Për miratimin e rregullave , kushteve e procedurave për përdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike ", duhet të bëjë vijëzimin dhe miratimin e hapësirave publike si (sheshe , trotuare etj) para objekteve tregtare ku lejohet vendosja tavolinave apo shfrytëzimi / përdorimi i hapësirës publike dhe objekteve tjara për tregëtim .

Zyra Tatimore Vendore në bashkëpunim me Zyren Juridike , bazuar në planin e hartuar nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit , nënshkruan kontratat me subjektet që kanë paraqitur kërkesën për përdorim / shfrytëzim të hapësirës publike , monitoron dhe ndjek vjeljen e detyrimit .

Derdhja e të ardhurave për këtë tarifë në favor të bashkisë Pukë , bëhet menjëherë me nënshkrimin e kontratës mes palëve .

- ✓ Për subjektet të cilët rezultojnë debitor për hapësirat publike të shfrytëzueshme (përdorura për biznes) vitet e mëparshme , përfshirë edhe debitë e taksës së pasurisë dhe të tarifave tjera të shërbimit publik , të

mos u miratohen kërkesat për shfrytëzim të hapsirave publike (për tu përdorur për biznes) gjatë vitit korent (të mos nënshkruhen kontratat) nga zyrtarët përkatës deri në likuidimin e plotë të debisë për H.P si dhe debisë së plotë si biznes .

- ✓ Për të gjitha kategoritë taksapaguese të cilat rezultojnë debitor për taksa dhe tarifa vendore ndaj bashkisë Pukë , dhe për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit apo kanë kaluar të gjitha fazat e shqyrtimit administrativ dhe gjyqësor , drejtoritë , sektorët apo çdo zyrë e cila ka funksionin apo kompetencën për kryerjen e një apo disa shërbimeve , nuk do të kryejnë asnjë shërbim ndaj subjekteve debitore pa likuiduar më parë vlerën e plotë të detyrimeve tatimore vendore .

Strukturat përgjegjëse për vjeljen e të ardhurave nga zënia / përdorimi i hapësirave publike është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit dhe Policia Bashkiake .

- ❖ **BAZA LIGJORE PËR PIKEN "A" TË TABELËS 19 :** neni 35 , pika 2 , e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 9 , parag. 1.2 , pikat "a" dhe "c" , neni 54 , pikat "dh" e "f" të ligjit nr.139 /2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) , neni 2 , pika 4 , neni 6 , pika "c" , neni 7 , pika 1 , neni 15 , pika 3 e ligjit nr.68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar) .
- ❖ **BAZA LIGJORE PËR PIKAT "B" DHE "C" TË TABELËS 19 :** neni 35 , pika 1/c , e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 9 , parag. 1.2 , pikat "a" dhe "c" , parag. 1.3 , pika "b" , neni 35 , pika 5/b , neni 54 , pikat "dh" e "f" të ligjit nr.139 /2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) , neni 2 , pika 4 , neni 6 , pika "c" , neni 7 , pika 1 , neni 14 , pikat 1 , 4 , 5/a , neni 15 , pika 1/a e ligjit nr.68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar) .

TARIFAT E SHËRBIMEVE QË KRYHEN NGA STRUKTURA E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI NDAJ SHITETASVE DHE PËRSONAVE FIZIKË, JURIDIKË, VENDAS E TË HUAJ :

Tarifat e shërbimeve që kryen struktura e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi përcaktohen në bazë të Ligjit Nr. 152 /2015 , datë 21.12'2015 " Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi " , VKM – së Nr. 607, datë 29.07'2020 " Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin " .

Për rastet e ofrimit të shërbimeve bashkive të tjera " Tarifa e shërbimit për shuarjen e zjarreve apo për shpëtimin , në raste aksidentesh dhe fatkeqësish të tjera ... është 15.000 lek/orë pune " , sipas përcaktimeve të pikës 1 të VKM - së nr.707, datë 12.10'2016 " Për tarifën e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin , të ofruara nga bashkitë e pajisura me stacione të këtij shërbimi , në territorin e bashkive që nuk kanë stacione të shërbimit të MZSH- së " .

SHTOJCA 1 :

1. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri për objekte të destinuara për banim .

1.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi deri në 12 metër, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë .

1.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 12 deri në 24 metër, tarifa është 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë .

1.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 24 deri në 32 metër, tarifa është 20 000 (njëzet mijë) lekë .

1.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte me lartësi nga 32 deri në 54 metër, tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë .

2. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik (sektori i bujqësisë, sektori i industrisë, sektori i transportit, sektori i tregtisë, sektori i turizmit, sektori i shërbimeve, etj.) .

2.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 500 m², tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë .

2.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 1 000 m², tarifa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë .

2.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 2000 m², tarifa është 20 000 (njëzet mijë) lekë .

2.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi deri në 3000 m², tarifa është 30 000 (tridhjetë mijë) lekë

2.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objekte ku ushtrohet aktivitet ekonomik pavarësisht sektorit, për objekte me sipërfaqe të përgjithshme ndërtimi mbi 3000 m², tarifa është 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë

3. Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, përveç objekteve të përcaktuara në pikën 2, të kësaj shtojce, për objektet/ aktivitetet me rrezikshmëri të lartë zjarri .

3.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente për përpunimin e drurit me materiale në përpunim dhe/ose në ruajtje, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

3.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për fabrika dhe impiante ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbahen produktet e tekstit, natyrore/artificiale, produktet e linoleum-it dhe produkte të tjera të ngjashme, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

3.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, përpunimin dhe rigjenerimin e laboratorëve të gomës, depozitat e gomës, pneumatikëve dhe produkteve të ngjashme, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

3.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për depot ku prodhohen, përpunohen dhe/ose mbajnë plastikë, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

3.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimentet dhe impiantet për prodhimin, letër dhe karton, dhe përgatitja e produkteve të letrës në përgjithësi, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

4. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet ku janë të instaluar pajisje nën presion .

4.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 75 kg deri në 300 kg, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

4.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm, në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 300 kg deri në 1000 kg, tarifa është 15.000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë .

4.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për rezervuarë gazi të lëngshëm në sasi totale masive më të mëdha se ose të barabartë me 1000 kg, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë .

4.4 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/impiante ku lëngjet e ndezshme dhe/ose të djegshme me pikë ndezjeje prodhohen dhe/ose përdoren deri në 125°C, me sasi totale në cikël dhe/ose në ruajtje, më e madhe se 1 m³, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

4.5 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/ impiantet për përgatitjen e vajrave

vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri në 5 m³, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

4.6 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/implante për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajrave diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje deri 100 m³, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë .

4.7 Shërbimi për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për stabilimente/implante për përgatitjen e vajrave vajosëse, vajra diatermike dhe të ngjashme, me pikë flakërimi më të lartë se 125°C, me sasi më të larta të përgjithshme në cikël dhe/ose në ruajtje mbi 100 m³,tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë .

4.8 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së karburantit të lëngshëm, kontejnerët e palëvizshëm të karburanteve të lëngshëm deri në 9 m³, me pikë të ndezjes mbi 65°C, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

4.9 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme fikse për shpërndarjen e karburanteve të gaztë dhe tipit të përzier (të lëngshëm dhe të gaztë), tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë .

4.10 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për sisteme të shpërndarjes së gazit të karburantit për automjete motorike dhe sisteme të shpërndarjes së palëvizshme për benzinë, naftë dhe miks automobilistik, për përdorim publik dhe privat, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë.

5. Shërbimi për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për objektet/aktivitetet e mëposhtme :

5.1 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për hidrocentrale, HEC (primar, sekondar) etj., implanteve të prodhimit të energjisë elektrike, të rinovueshme, diellore, ere, etj., tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë .

5.2 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për vend depozitime të mbetjeve të ngurta, tarifa është 10.000 (dhjetë mijë) lekë .

5.3 Për vlerësimin dhe miratimin e projektit, dokumentacionit teknik të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për rrugë, hekurudha, ura, tunele, tarifa është 20.000 (njëzet mijë) lekë .

6. Për vlerësimin dhe miratimin e ndryshimeve të projektit të MZSH-së, të miratuar më parë nga struktura e MZSH-së, për shkak të instalimit të sistemeve të reja, zgjerimit apo ristrukturimit të aktiviteteve ekzistuese, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë .

7. Për dhënien e certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë .

8. Për ripërtëritjen periodike të certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 2 000 (dy mijë) lekë .

9. Për lëshimin e vërtetimit të zjarrit (shoqëruar nga raporti i ndërhyrjes) nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 1 000 (një mijë) lekë .

10. Për lëshimin e vërtetimit (shoqëruar nga akti i kontrollit i kryer nga inspektori i shërbimit të MZSH-së), për depozitat e gazeve të ndezshme, të ngurta, apo plazma në automjete të lëvizshme rrugore, nga shërbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, tarifa është 1 000 (një mijë) lekë .

11. Për inspektimin e objekteve për masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kur inspektimi nuk është i autorizuar nga shërbimi i MZSH-së, por kërkohet nga vetë subjektet fizikë dhe juridikë, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë për një orë .

12. Për vënien në dispozicion të personelit dhe të një automjeti në zhvillimin e aktiviteteve sportive, kulturore, si panairë, ekspozita, koncerte, shfaqje, festivale të ndryshme, në mjedise të hapura dhe të mbyllura publike, si dhe gjatë zhvillimit të aktiviteteve sportive kombëtare apo ndërkombëtare, tarifa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë .

13. Për ofrimin e shërbimeve subjekteve private me automjete zjarrfikëse, me pajisje zjarrfikëse, apo me auto shkallë, tarifa është 10 000 (dhjetë mijë) lekë për një orë .

14. Për ofrimin e shërbimit me motopompë (largim të ujërave për shkak të reshjeve), subjekteve private, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë për një orë .

15. Për trajnimin e personave, të subjekteve fizikë dhe juridikë për mbrojtjen nga zjarri nga strukturat e shërbimit të MZSH-së në Akademinë e Sigurisë (Qendra e Trajnimit Zjarrfikës), tarifa është 2 000 (dy mijë) lekë në ditë për person .

16. Për kryerjen e aktit të ekspertimit apo riekspertimit, nga strukturat e MZSH-së së bashkisë, në rastet e zjarreve të rena në objekt, kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë, tarifa është 20 000 (njëzetë mijë) lekë. Kjo tarifë nuk aplikohet kur akti i ekspertimit kërkohet nga Prokuroria .

17. Për të gjitha ndërhyrjet kur kërkohet nga subjekte fizikë e juridikë (zhbllokime dyersh, ashensorë, apo shërbime të tjera të ngjashme), që do të kryhen nga shërbimi zjarrfikës i bashkisë, tarifa është 2 000 (dy mijë) lekë.

TARIFA E SHËRBIMIT TË UJITJËS :

Fërmerët e fshatrave të Njësisë Administrative Luf – Qerret - Bashkia Pukë , të cilët përfitojnë nga shërbimi për ujitjen e kulturave bujqësore (tokave) që ofrohet nga Ujëmbledhësi Rezervuarit Kukaj , tarifohen me 100 lek / orë ujitje .

Agjent tatimor për mbledhjen e kësaj tarife për periudhën e vaditjes caktohet një punonjës shërbimi nga Njësia Administrative Luf - Qerret - bashkia Pukë .

- ❖ **BAZA LIGJORE** : Nenet 15 , 16 , 17 dhe 18 " Tarifa e shërbimit të ujitjes ", pikat 1 , 2 dhe 3 të ligjit nr.24 / 2017 datë 09.03'2017 " Për administrimin e ujitjes dhe kullimit ", neni 14 , pika 5/ç e ligjit nr.68 / 2017 datë 27.4'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore ", neni 9, pika 1.3/b e ligjit nr.139 / 2015 datë 17.12'2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) .

TARIFAT E APLIKIMEVE TË LEJEVE TË ZHVILLIMIT TË TERITORIT :

NIVELI I TARIFAVE TË URBANISTIKËS E PLANIFIKIMIT TERITORIT :

Tab.20

Nr.	Llojet e tarifave	lek/dosje	Tarifa 2026
1.	Tarifë aplikimi për leje zhvillimi	lek/dosje	7.000
2.	Tarifë aplikimi për leje ndërtimi	lek/dosje	12.000
3.	Tarifa të aplikimit të deklaratës paraprake të punimeve	lek	3.000
4.	Tarifa për kërkesat për leje riparimesh	lek	zero
5.	Tarifa për aplikim të çertifikatës së përdorimit për objektet me sipërfaqe deri 250 m ²	lek	10.000
6.	Tarifa për aplikim të çertifikatës së përdorimit për objektet me sipërfaqe mbi 250 m ²	lek	15.000
7.	Tarifa për ndryshim funksioni	lek	5.000
8.	Tarifa për ndryshim të subjektit zhvillues	lek	5.000
9.	Leje ndërtimi për rikonstrukcion	lek	2.000

- **Për vitin 2026 , përjashtohen të gjitha subjektet si (individ , përsona fizik , përsona juridik etj.) nga tarifa e shërbimit të urbanistikës e planifikimit teritorit për kërkesa leje riparimesh .**

BAZA LIGJORE PËR PIKEN "4" TË TABELËS 20 : neni 35 , pika 2 , e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 14 , pika 2 e ligjit nr.68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar) , neni 32 , pika 2 , neni 54 , pikat "dh" e "f" të ligjit nr.139 /2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) .

BAZA LIGJORE: neni 35 , pika 2 , e ligjit nr.9632 / 2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 9 , parag. 1.3/h , neni 32 , pika 1 , neni 54 , pikat "dh" e "f" të ligjit nr.139 / 2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) .

Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) , neni 2 , pika 4 , neni 6 , pikat "c" dhe "d" , neni 7 ,
1 , neni 14 , pikat 1 dhe 3 , neni 16 i ligjit nr.68 / 2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore "
ndryshuar) , neni 6 i vendimit nr.408 / 2015 " Për miratimin e rregullorës së zhvillimit të territorit "
ndryshuar) .

pika
(i
(i

- ✓ Struktura e ngarkuar për vjeljen e këtyre tarifave është Sektori të Ardhurave pranë bashkisë Pukë , ndërsa ajo për lëshimin e autorizimeve të pagesave për tarifën e urbanistikës do jetë Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (Urbanistika) pranë bashkisë Pukë dhe e cila përcakton objektet , sipërfaqen , numerin e kateve etj.. sipas përcaktimeve në legjislacionin përkatës në fuqi .

TARIFA PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKËSORE (TELEFONI , ENERGJI , KABLLOR , INTERNET ETJ..) .

TV.

A) Për linjat ajrore lekë / ml / vit 10 ;

B) Për linjat nëntokësore lekë / ml / vit 20 ;

- Për rrjetët kabllore telefonike , ndërlidhese apo të shërbimit informatik , tarifën vendore vendosen vetëm në rastin kur subjektet përdorin rrjetet infrastrukturore , si :

Tubacione , kanale etj... të cilat janë ndërtuar dhe janë në pronësi të njësisë të vetëqeverisjes vendore . Të ardhurat e siguruara prej tyre shërbejnë për përballimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e rrjetit në përdorim .

A. Afati i pagesës : Për biznesin e vogël afati për likuidimin e tarifës së linjave ajrore dhe nëntokësore është deri me 20 Shtator të vitit fiskal, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

B. Afati i pagesës : Për biznesin e madh afati për likuidimin e tarifës së linjave ajrore dhe nëntokësore është deri me 30 Shtator të vitit ushtrimor, dhe pas kësaj date me kamatë vonesë (Gjobë) në masën 0.06% e detyrimit vjetor për çdo ditë por jo më shumë se 365 ditë .

- ❖ **BAZA LIGJORE :** Neni 9, pika 1.3/b të Ligjit nr. 139 / 2015, datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , neni 14, pikat 1 - 4 të ligjit nr.68 / 2017, datë 27.04'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " , neni 35 pika 2 e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 12 të ligjit nr.95 / 2018 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9632 , datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS : është Zyra Tatimore Vendore pranë bashkisë Pukë . Struktura përgjegjëse e cila pajisë subjektin me leje ku përcaktohet shtrirja , gjatësia lineare për kilometër dhe kohëzgjatja e lejës , është Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit (Urbanistika) pranë bashkisë Pukë .

TARIFA LEJESH , LICENSASH DHE AUTORIZIMESH NË FUSHEN E TRANSPORTIT RRUGOR :

Mbështetur në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998 " Për Transportin Rrugor " (i ndryshuar) , ligjin nr.10 / 2016 datë 11.2'2016 , për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8308, datë 18.3'1998 " Për transportet rrugore " (i ndryshuar) , Udhëzimin e MPPTT nr. 15, dt. 24.07'2007 " Për kriteret e procedurave të lëshimit të licencave, autorizimeve dhe çertifikatave, për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e transportit rrugor " (i ndryshuar) , Udhëzimi i MPPTT nr. 20, datë 10.10'2007, " Për modelet e licencave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor " , Udhëzimit të Ministrisë Transportit dhe Industrisë nr. 5627, datë 18.11.2016, " Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit " , përcaktohen tarifën e lejeve, licencave dhe të autorizimeve në fushën e transportit rrugor, Udhëzimit të MTI nr. 5628, datë 18.11'2016 " Për miratimin e rrjetit të linjave ndërqytetëse " , Udhëzimit të MTI nr. 5630, datë 21.11'2016, " Për kriteret e licencimit për të kryer kontrollin dhe provën e mjeteve me motor dhe të rimorkiove të tyre, kur janë bërë një a më shumë ndryshime të karakteristikave konstruktive ose funksionale apo të sistemeve të pajisjeve " , Shkresa nr. 6154/2 prot.datë 29.12'2016 të MTI " Për miratimin e ndryshimeve dhe shtesat në tarifën e pagesave për licenca / çertifikata që lëshohen në transportin rrugor të udhëtarëve " , në zbatim edhe të shkresës nr. 17905/1 prot., datë 27.12'2016 e MF të D.P.B. dhe D.M.Buxhetit .

Këto tarifa mbështeten në aktivitetin e zyrës së transportit dhe shërbimeve në bashki dhe të ardhurat e grumbulluara janë të ardhura që ndahen sipas përcaktimeve në Udhëzimet e Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit .

Për liçencat e automjeteve me afat një vjeçar, vlera llogaritet duke e pjesëtur me detyrimin sipas afatit në vite .

Shënim :

- Për dublikatë me të njëjtin përmbajtje dhe afat vlefshmërie paguhet 30 % e vlerës së plotë të dhënë në tabelë
- Për rastet e ndryshimeve në liçencë / çertifikatë që kanë të bëjnë me përdoruesit e mjetit, fushës së operimit etj., paguhet 30 % e vlefshësisë së plotë .
- Në bashkinë Pukë , niveli i tarifave për leje , liçenca , autorizime dhe çertifikata në fushën e transportit rrugor është sipas tabelave të përcaktuara në këto udhëzime .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Agjenti tatimor : Do të jetë Zyra e Shërbimeve në Bashki e cila lëshon leje, liçenca dhe autorizime dhe përlllogarit tarifën përkatëse sipas përcaktimeve ligjore në fuqi për (lejet, liçensat apo autorizimet) .

Struktura e ngarkuar për faturimin e këtyre shërbimeve është Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Pukë .

TARIFAT PËR PARKIMIN E AUTOMJETEVE TË TRANSPORTIT NË VENDPARKIME PUBLIKE DHE TARIFAT PËR PARKIMET E REZURVUARA :

BAZA LIGJORE: neni 35 , pika 2 , e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 6 , pika "c" , neni 7 , pika 1 , neni 14 , pika 1 , neni 15 , pikat 1/c dhe 3 të ligjit nr.68 /2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar) , neni 9 , parag. 1.3/b , neni 32 , pikat 1 , dhe 2 , neni 35 , pika 5/b , neni 54 , pikat "dh" e "f" të ligjit nr.139 /2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) , neni 7 e në vijim të ligjit nr.8378 , datë 22.07.1998 " Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë " (i ndryshuar) , neni 7 , e në vijim të ligjit nr.89 /2022 " Për Policinë Bashkiake " .

Tarifës së Parkimit të Automjeteve i nënshtrohen të gjithë personat fizik, juridik rezidentë në Bashkinë Pukë të cilët posedojnë mjete transporti (automjete) pavarësisht llojit të tij dhe që shfrytëzojnë vendparkimet e përcaktuara nga bashkia me përjashtim të autobusave të linjave ndërqytetase dhe rrethqytetase .

Në përputhje edhe me VKB për miratimin e Terminalit të Autobuzave sipas planimetrisë së paraqitur nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit Teritorial pranë Bashkisë Pukë , nivelet e tarifës së parkimit të mjeteve në vendparkimin e miratuar, për çdo kategori mjeteesh janë si më poshtë :

Tab.21

Nr	Lloji Mjetit	Niveli Tarifës lek/ditë
1.	Autobuza të linjave ndërqytetase	zero lek/ditë/mjet
2.	Autobuzë të linjave rrethqytetase	zero lek/ditë/mjet
3.	Kamiona deri në 3.5 ton e tjerë të ngjashme me to në përdorim / pronësi të subjekteve jo rezident në Bashkinë Pukë .	100 lek/ditë/mjet
4.	Kamiona mbi 3.5 ton e tjerë të ngjashme me to në përdorim / pronësi të subjekteve jo rezident në Bashkinë Pukë .	100 lek/ditë/mjet
5.	Automjete në përdorim / pronësi të subjekteve personat fizik e juridik që nuk janë rezident në Bashkinë Pukë .	50/lek/orë/qëndrimi
6.	Autovetura deri në 6+1 vende në përdorim / pronësi të subjekteve jo rezident në Bashkinë Pukë e të tjera të ngjashme me to .	50/ lek/orë/qëndrimi

■ Për vitin 2026 , përjashtohen nga tarifa e shërbimit të parkimit autobusat e linjave ndërqytetase dhe ato qytetase .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

1. Rolin e agjentit tatimor do ta luaj një punonjës i bashkisë Pukë (Drejtorisë së Shërbimeve) i cili do të arkëtoj çdo ditë / javë tarifen e parkimit (paradhënie) nga shoqërit e transportit të udhëtarve , përsone fizikë , juridikë dhe individët jo rezident në bashkinë Pukë sipas vlerave të përcaktuara në tabelë .
2. Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pranë bashkisë Pukë , në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike , Drejtorinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit dhe Policinë Bashkiake , ngarkohen për zbatimin e masave shtrënguese sipas përcaktimeve ligjore , me qëllim vjeljen dhe administrimin e tarifës së parkimit , vetëm atëherë kur subjektet e mësipërme nuk likujdojnë vullnetarisht tarifen e parkimit .
3. Të ardhurat nga tarifa e parkimit të automjeteve derdhet 100% në buxhetin e bashkisë Pukë .
4. Zyra e shërbimeve (transportit) në bashki luan rolin e agjentit tatimor për tarifën që kanë të bëjnë me liqensimin , lëshimin e autorizimeve e të tjera shërbime të përcaktuara në legjislacionin përkatës .
5. Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit pranë bashkisë Pukë harton planin për vendodhjen e mundshme të vendparkimeve të miratuara dhe ato të rezervuara .

Tab.21/1

Nr	Lloji Mjetit	Niveli Tarifës lek/ditë për parkimet e rezervuar
1.	Automjete të transportit të perzier deri 3.5 ton e të tjerë të ngjashëm me to në përdorim / pronësi të subjekteve jo rezident në Bashkinë Pukë .	100 lek/ditë/mjet
2.	Automjete të transportit të mallrave mbi 3.5 ton e të tjerë të ngjashëm me to në përdorim / pronësi të subjekteve jo rezident në Bashkinë Pukë .	100 lek/ditë/mjet
3.	Furgona e të tjerë të ngjashëm me to në përdorim / pronësi të subjekteve jo rezident në Bashkinë Pukë .	100 lek/ditë/mjet

Subjektet e biznesit të vogël apo të madh mund të marrin leje parkimi **vetëm për një vendparkim** . Kontratat për vendparkimet e rezervuara nuk mund të lidhen për një periudhë kohore me të shkurtër se 6 muaj .

Përfituesit e rezervimeve të vendparkimeve të miratuara janë të detyruara të lidhin kontratë me sektorin juridikë pranë Bashkisë Pukë , pasi subjekti përkatës është paisur me lejen përkatëse nga strukturat e transportit pranë Bashkisë Pukë apo Drejtorisë së Urbanistikës Planifikimit dhe Mbrojtjes së Teritorit .

Për subjektet që lidhin kontratë me afat 6 - mujor dhe paguajn të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së kontratës, përfitojnë reduktim në masën 5 % të vlerës së detyrimit . Subjektët që lidhin kontratë me afat 12- mujorë dhe paguajnë të plotë detyrimin në momentin e lidhjes së kontratës, përfitojnë reduktim në masën 10 % të vlerës së detyrimit .

Koha e vendparkimeve të rezervuara është sipas orarit zyrtarë 8⁰⁰ : 16⁰⁰ , specifikime të tjera më të plota trajtohen në kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes palëve .

MËNYRA E PAGESËS : Të gjithë subjektet që përfitojnë nga rezervimi i vendparkimeve të miratuara janë të detyruar të lidhin kontratë me Sektorin Juridike pranë bashkisë Pukë, pasi subjekti ka marrë lejen përkatëse nga strukturat e transportit pranë bashkisë Pukë apo Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Administrimit të Teritorit dhe që kanë bërë likujdimin e menjëhershëm të parkimit të rezervuar .

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Struktura e ngarkuar për vjeljen e tarifës së parkimit është Drejtoria e Shërbimeve Publike, Drejtoria Urbanistikës Planifikimit dhe Mbrojtjes së Teritorit (për parkimet e rezervuara të automjeteve të transportit sipas tabelës së mësipërme tab. 21/1) dhe Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore pasi të ketë marrë autorizimin për tarifën e tjera të parkimit .

Drejtoria e Shërbimeve apo ajo e Urbanistikës Planifikimit dhe Mbrojtjes së Teritorit është përgjegjëse për dhenien e lejes së parkingut të rezervuar . Sektori Juridikë harton kontratën tip për parkimet e rezervuara sipas kërkesave

NIVELET E TARIFËS PËR DHËNIE LICENCE PËR TREGTIMIN E NAFTËS BRUTO DHE NËNPRODUKTEVE TË SAJ :

Dhënie licësa për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj në zbatim të ligjit nr.8450, datë 24.02'1999 " Për përpunimin , transportimin dhe tregtimin e naftës , të gazit dhe nënprodukteve të tyre " (i ndryshuar) ; VKM nr.344, datë 19.04'2017 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.970 , datë 02.12'2015 të KM " Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj ", pikat 9 e 10 të tij .

Tarifë për dhënien dhe përsëritjen e licënsave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj .

1. Dhënie dhe përsëritje e licencave për stacionet e shitjes së karburantëve , gazit të lëngshëm , të naftës për automjetet dhe vajrave lubrifikante për 5 vjet , Lekë / Liçencë / 1.000.000
2. Dhënia e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për veprimtarinë e tregtimit për përdorim nga konsumatorët fundorë për 5 vjet , Lekë / Liçencë / 100.000

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E KËSAJ TARIFE : Është zyra përkatëse e cila pajis me licencë stacionin e shitjes së karburantit, gazit të lëngshëm të naftës për automjete dhe vajra lubrifikante dhe pajis me licencë njësitë e shitjes së lëndëve djegëse dhe bombëlave të gazit të lëngshëm, të naftës për veprimtari tregtimi , përdorim rezidencial .

TARIFA TË TJERA VENDORE :

Tab 22.

Nr	Emërtimi i Tarifës	Njësia	Tarifa 2026
1	Tarifa të përherëshme :		
1.1	➤ Në zbatim të ligjit nr.10465 datë 29.09.2011 " Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë " i ndryshuar , Akti Normativ Nr.dt.16.08'2012 ; VKM Nr.230 , dt 20.03'13 ; VKM nr.683, datë 03.09.2020 " Për krijimin ,organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterenarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve " dhe Urdhërit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr.6229/1 prot, datë 08.09.2021 " Për kryerjen e aktiviteteve të kontrollit në thërtore dhe tregje " , shërbim i cili kalon në funksion të Autoritetit Kombëtar të Veterenarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve .	lek/kokë	150
1.2	➤ për bagëti të trasha ➤ për therje bagëti të imta	lek/kokë	100
2	Të ardhura nga tarifa shërbimi:		
	a. Dhënie në përdorim stadiumi (fushë futbollit) për një ndeshje futbollit një skuadre jo vendase .	lek	50.000
	b. Nga dhënia në përdorim e ambjenteve të qendrës sociale për aktivitete të ndryshme .	lek	20.000
2.1	Bileta sporti – tribuna kryesore	lek	200
2.2	Bileta sporti – vendet e tjera	lek	100

2.3	E ardhura nga dhënia në përdorim ditor të përkohshëm për sallën e madhe të Pallatit të Kulturës	lek/aktivitet	15.000
2.4	E ardhur nga dhënia në përdorim ditor të përkohshëm për sallën e vogël të Pallatit të Kulturës.	lek/aktivitet	5.000
2.5	Të ardhura jo tatimore nga : ➤ Regjistrimi i konviktorve ➤ Tarifë për kopshte ➤ Tarifë për çerdhet ➤ Të ardhura nga tregtimi ditor me automjete deri 1.5 ton brenda rrethimit Tregu Lirë ➤ Të ardhura nga tregtimi ditor me automjete nga 1.5 deri 3 ton brenda rrethimit T. Lirë ➤ Për automjetet mbi 3 ton brenda rrethimit Tregu i Lirë ➤ Tarifë ditore e tregtarëve në ambjentet e brendshme të tregut qytetit, pronë e bashkisë Pukë (Likujdimi /javë/ 600 për çdo person , subjekteve shitës brenda tregut për një m²) . ➤ Për shitësit ambulant të cilët shfrytëzojnë hapësirat e brendshme të “ Tregut lirë ” pronë e bashkisë Pukë, për tregtimin e mallrave apo materialeve për llogari të vet, për ditët të cilët nuk janë aktiv dhe që kanë zënë vendin sipas kushteve të përcaktuara në legjislacionin përkatës, si dhe rregullave të vendosura nga Këshilli Bashkiak ,tarifa ditore për këte kategori të jetë 50/lek/dite . ➤ Subjektet shitës të cilët kërkojnë sipërfaqe të shfrytëzueshme më shumë se një m² brenda tregut,tarifa të llogarit në bazë të kushteve dhe përcaktimeve të përcaktuara në VKM - në Nr.54 , datë 5.2.2014 “ Për përcaktimin e kritereve , të procedurës e të menyrës së dhënies me qera , enfitozoë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore ” (i ndryshuar)	Lek /nxënës/vit kuota ditore/lek lek/fëmijë lekë/ditë lekë/ditë lekë/ditë lekë/ditë lekë/ditë	3.000 100 100 200 300 500 100 50
3.	➤ Zënia e hapësirës publike ditore nga individ, subjekte përsone fizik, juridik dhe shoqata e të tjera të ngjashme me to, jo rezident në Bashkinë Pukë dhe me seli administrative jashtë territorit të Bashkisë Pukë, të cilët kanë për qëllim ekspozimin, promocionin e shitjeve të produkteve, shërbimeve, e të tjera të ngjashme me to.	100 lekë / m2 / ditë por jo më pak se 1.500 lek	100 lek / m2 / dite , por jo me pak se 1.500 lek / dite

- ❖ **BAZA LIGJORE** : Neni 9 pika 1.3/b , neni 33 - taksa të përkohëshme vendore , neni 35 - të ardhura që rrjedhin nga burimet e veta vendore , pikat 1 dhe 5 , shkronjat “a” deri “ç” të ligjit nr.139 / 2015 datë 17.12'2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) , neni 14 pikat 1 - 4 të ligjit nr.68 / 2017 datë 27.4'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " , neni 35 , pikat 1 dhe 2 të ligjit nr.9632 datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) . Pjesë e grupit të tarifave vendore janë edhe tarifa nga aktivitetet ekonomike dhe funksionesh të cilat përmbushen nga bashkia Pukë si e ardhura jo tatimore për akomodim në konvikt e konviktorëve nga fshatrat e rrethit Pukë .

TË ARDHURA TË TJERA :

TARIFA TË TJERA VENDORE DHE ADMINISTRIMI I TYRE:

- ❖ **BAZA LIGJORE** : Neni 35 " Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore " i ligjit nr.139 /2015 datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore " , neni 35 " Tarifat vendore dhe administrimi tyre " i ligjit nr.9632 , datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) ;
- Për ambulantët ditor që tregtojnë prodhime familjare, pagesa të jetë 50 lek / ditë në ambjentet jashtë tregut;
 - Për tregtarët ambulantë të cilët tregtojnë mallrat / materialet me automjetet e tyre, pagesa ditore të jetë 1500 lek / ditë qëndrimi për tregtim në sheshin " Imer Bardhoshi " në vijëzimet e përcaktuara më parë ;

Për administrimin e tarifave dhe të ardhurave të mësipërme, ngarkohet :

- Për tarifën e thirrjes së bagëtive ngarkohet veterineri Bashkisë .
- Për të ardhurat nga veprimtaritë ekonomike, ngarkohet Zyra e Kulturës dhe Sportit dhe drejtoria e Qendrës Sociale dhe Zyra e Financës .
- Për të ardhurat nga bileta sporti, ngarkohet zyra e shërbimeve në Bashki .

TARIFË PËR PËRDORIMIN E MJEDISEVE SPORTIVE NË STADIUMIN " ISMAIL XHEMALI " :
PËRKUFIZIMI :

" Klub sportiv " është personi juridik, që ushtron veprimtari sportive në një sport ose shumë sporte.

" Mjedis sportive " është një hapësirë e mbuluar ose jo, e rrethuar ose jo, e destinuar për organizimin e veprimtarive sportive, si lojëra sportive, gara sportive, palestra sportive ose fitnesi apo e përdorur përkohësisht për organizimin e veprimtarive sportive promocionale, lojërave zbavitëse dhe veprimtarive sportive rekreative.

" Objekt sportive " është sendi i paluajtshëm, i ndërtuar në përputhje me kushtet e nevojshme për zhvillimin e një apo disa sporteve, në bazë të rregullave teknike, të miratuara nga federata kombëtare e sportit përkatës.

" Terren sportiv " është çdo mjedis apo sipërfaqe e hapur, në të cilën ushtrohet veprimtari sportive.

NIVELI TARIFËS : Niveli tarifës për përdorimin apo frekuentimin e fushës sportive në stadiumin " Ismail Xhemali " .

Nr.	EMERTESA	NJËSIA	VLERA
1	Tarifa e përdorimit / frekuentimit të fushës sportive .	Lekë / ditë	10.000

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Struktura përgjegjëse për vjeljen apo arkëtimin e kësaj tarife është sektori i të ardhurave vendore në bashkëpunim me strukturat tjera të përcaktuara në organiken e miratuar .

BAZA LIGJORE: Neni 9, pika 1.3/b, neni 23/9 të Ligjit nr. 139 /2015 , datë 17.12.2015

Për vetëqeverisjen vendore " , neni 35, pika 2 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 8, pika 3, neni 30, pika 2, neni 32, neni 33 i ligjit nr.79 /2017 " Për sportin " (i ndryshuar) , neni 14 " Tarifat vendore " , pikat 1 - 4 , gërma "e" , e ligjit nr.68 /2017, datë 27.04'2017

Për financat e vetëqeverisjes vendore " .

TARIFË PËR FREKUENTIMIN E PARKUT TË AVENTURËS :

Me realizimin e projektit të parkut të aventurave në Njësinë Administrative Pukë për ndërtimin e lojërave të modeleve të ndryshme për grupmosha të caktuara përfshirë ndërtimin e " zipline " prej 1.2 km , propozojmë tarifimin për frekuentimin / përdorimin e lojërave përfshirë linjën " zipline " .

NIVELI TARIFËS :

Niveli i tarifave për frekuentimin e Parkut të Aventurës Pukë .

Nr.	EMERTESA	NJËSIA
1	Tarifë e udhëtimit / frekuentimit " zipline " .	Lek / udhëtim / person 1.500 lek
2	Tarifë për frekuentimin e lojërave të modeleve të ndryshme në Parkun e Aventurës Pukë për grupmosha të caktuara .	Lek / orë / 100 lek / person

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Adresa: Bashkia Pukë, sheshi "Gjergj Kastrioti Skenderbeu", e-mail: bashkiapuke@yahoo.com, faqe zyrtare www.bashkiapuke.gov.al

Struktura përgjegjëse për vjeljen apo arkëtimin e kësaj tarife është sektori i të ardhurave vendore në bashkëpunim me strukturat tjera të përcaktuara në organiken e miratuar .
BAZA LIGJORE: Neni 9, pika 1.3/b, neni 23/9 të ligjit nr.139 /2015, datë 17.12.2015
 Për vetëqeverisjen vendore ", neni 35, pika 2 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), neni 14 " Tarifat vendore ", pikat 1 - 4 , gërma "e" , e ligjit nr.68 /2017, datë 27.04'2017
 Për financat e vetëqeverisjes vendore " .

TË TJERA

PËRKUFIZIMI :

" Startup - e " janë individët dhe personat fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar të Republikës së Shqipërisë, të cilët, referuar objektit të aktivitetit të tyre, janë konceptuar, krijuar dhe veprojnë me qëllim nisjen e realizimit dhe zhvillimit të një modeli biznesi, produkti dhe shërbimi inovativ dhe/ose teknologjik të veçantë, me potencial rritjeje të shpejtë, të zbatueshëm në praktikë, për përmirësimin e ndjeshëm të modeleve të biznesit, produkteve dhe shërbimeve ekzistuese .

LEHTËSIRA TATIMORE NGA PËRJASHTIMI I TARIFAVE VENDORE PËR BIZNESET E REJA ME STATUSIN E STARTUPIT :

Individi , personi fizik ose juridik nga momenti i marrjes së statusit si " startup " nga institucionet përgjegjëse sipas përcaktimeve të ligjit nr.25 /2022 " Për mbështetjen dhe zhvillimin e " startup – ve " (i ndryshuar) , përjashtohet për 2 vitet e para nga të gjitha tarifat e shërbimit në kuptim të neneve 14 - 17 të ligjit nr.68 /2017 me përjashtim të rastëve kur në ligje të veçanta përcaktohet ndryshe .

BAZA LIGJORE: Neni 35 , pika 2 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) , neni 54 , gërma "f" e ligjit nr.139 /2015 " Për vetëqeverisjen vendore " (i ndryshuar) , neni 6/c e në vijim të ligjit nr.68/ 2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar) .

TARIFË PËR FREKUENTIMIN / PËRDORIMIN E QENDRËS INOVACIONIT :

NIVELI TARIFËS :

Niveli i tarifës për frekuentimin / përdorimin e qendrës inovacionit .

Nr.	EMERTESA	NJËSIA
1	Dhënie në përdorim salle për të tretë (për biseda, takime etj) .	Lek / rast / 10.000 lek

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS :

Strukturat e ngarkuar për vjeljen e tarifës/ve janë sektori i zhvillimit të artit dhe kulturës në koordinim me sektorin e tatim – taksave vendore .

BAZA LIGJORE: Neni 9, pika 1.3/b, të ligjit nr.139 /2015 , datë 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore ", neni 35, pika 2 e ligjit nr.9632 /2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar), neni 14 " Tarifat vendore ", pikat 1 - 4 , e ligjit nr.68 /2017, datë 27.04'2017 " Për financat e vetëqeverisjes vendore " (i ndryshuar) .

- Tarifë për shitjen e lëndës drusore dhe prodhimeve të dyta pyjore, si dhe të ardhura tjera nga dhënia në përdorim e sipërfaqeve të fondit pyjor e kullësor .

SHTOJCA NR. 1

TARIFAT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM TË FONDIT PYJOR KOMBËTAR PËR VEPRIMTARITË E USHTRUARA NË KËTË FOND

1. Ngritje fidanishte pyjore				
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet

3	Pyll, shkurre	3 960	3 740	3 300
4	Kullotë	3 960	3 740	3 300
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	2 970	2 860	2 200

2. Bazë didaktike dhe eksperimentale kërkimore-shkencore në fushën e pyjeve

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
1	Pyll, trungishte	4 950	4 675	4 400
2	Pyll, cungishte	3 960	3 740	3 300
3	Pyll, shkurre	3 960	3 740	3 300
4	Kullotë	3 960	3 740	3 300
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	2 970	2 860	2 200

3. Për mbarështimin e florës së egër dhe kultivimin e bimëve të ndryshme

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
1	Pyll, cungishte	23 760	22 770	19 800
2	Pyll, shkurre	23 760	22 770	19 800
3	Tokë me bimësi pyjore, djerr inproduktive	19 800	18 975	13 200

4. Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
1	Pyll, trungishte	36 000	34 000	30 000
2	Pyll, cungishte	24 000	23 000	20 000
3	Pyll, shkurre	24 000	23 000	20 000
4	Kullota	24 000	23 000	20 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	18 000	17 000	15 000
6	Inproduktive	18 000	17 000	15 000

5. Agropylltari

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
1	Tokë me bimësi pyjore, djerr	15 000	13 000	10 000

6. Për qëllime pushimi, argëtimi, për veprimtari turistike kampingje (kënde lodrash, shëndetësore, shoqërore dhe mjedise sportive, shplothëse, kulturore etj.

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
1	Pyll trungishte	198 000	132 825	110 000
2	Pyll cungishte	138 600	99 000	82 500
3	Pyll shkurre	138 600	99 000	82 500
4	Kullota	138 600	99 000	82 500
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	99 000	57 200	49 500
6	Inproduktive	99 000	57 200	49 500

7. Për vendosje antene të telefonisë fikse, të lëvizshme, televizive, radio-komunikimit

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
		1-5 vjet	6-10vjet

1	Pyll trungishte	11 250 000	10 000 000
2	Pyll cungishte	8 500 000	8 000 000
3	Pyll shkurre	8 500 000	8 000 000
4	Kullota	8 500 000	8 000 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	6 500 000	5 500 000
6	Inproduktive	5 500 000	5 000 000

8. Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë dhe fotovoltaike (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.).

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit		
		1 vit	2-5 vjet	6-10vjet
1	Pyll trungishte	240 000	230 000	210 000
2	Pyll cungishte	192 000	184 000	176 000
3	Pyll shkurre	192 000	184 000	176 000
4	Kullota	192 000	184 000	176 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	156 000	150 000	143 000
6	Inproduktive	156 000	150 000	143 000

9. Për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objekteve të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe.

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit	
		1-5vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	120 000	96 000
2	Pyll cungishte	96 000	78 000
3	Pyll shkurre	96 000	78 000
4	Kullota	96 000	78 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	76 800	62 000
6	Inproduktive	76 800	62 000

10. Për shtrirje tubacionesh dhe linjash në sipërfaqe, si dhe ndërtim kanalesh (uji, naftë, gaz, tensioni elektrik etj.)

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa si	pas kohëzgjatjes së kontratës lek/km/vit	
		1 vit	2-5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll trungishte	240 000	220 000	175 000
2	Pyll cungishte	190 000	176 000	145 000
3	Pyll shkurre	190 000	176 000	145 000
4	Kullota	190 000	176 000	145 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	160 000	145 000	110 000
6	Inproduktive	150 000	145 000	110 000

11. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lek/km/vit	
		1 vit	2-5 vjet
1	Pyll trungishte	70 000	50 000
2	Pyll cungishte	50 000	35 000
3	Pyll shkurre	50 000	35 000
4	Kullota	50 000	35 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30 000	25 000
6	Inproduktive	25 000	20 000

12. Vendosije kaminash për prodhim qymyr druri dhe eshkës së kovaçit, furrë gëlqereje, sheshe për depozitim e përkohshëm të materialeve të ndryshme (pika transiti) etj.

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit
1	Tokë me bimësi pyjore, djerrë	250 000
2	Inproduktive	100 000

13. Ndërtim linje të tensionit të lartë

Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës km/vit
1	Pyll trungishte	60 000
2	Pyll cungishte	35 000
3	Pyll shkurre	25 000

SHTOJCA NR.2

TARIFAT DHE ÇMIMET PËR SHFRYTËZIMIN E FONDIT PYJOR KOMBËTAR

1. Ngritja e kampingjeve, qendrave dhe objekteve të lëvizshme

Nr. rend.	Emërtimi	Tarifa (lek/ditë/copë)
1.	Çadra deri 4 vende	100
2.	Çadra mbi 4 vende	200
3.	Ruletë	500
4.	Barakë portative	250

2. Shpërblimi i dëmeve të shkaktuara nga shfrytëzimi i fondit pyjor

Nr.	Emërtimi i dëmit	Njësia e matjes	Vlera (lek)
1.	Prerje fidanësh, lastarësh e drurësh me diametër:		
	- deri në 2 cm	copë	250
	- nga 2.1-4 cm	copë	500
	- nga 4.1-6 cm	copë	2.700
	- nga 6.1-8 cm	copë	3.100
	- nga 8.1-10 cm	copë	5.100
	- nga 10.1-20 cm	copë	8.000
	- nga 20.1-30 cm	copë	15.000
	- nga 30.1-40 cm	copë	20.000
	- nga 40.1-60 cm	copë	24.000
	- mbi 60 cm	copë	34.000
2.	Prerje fidanësh, lastarësh e drurësh në masë:		
	-në pyje të rinj (deri në 10 cm diametër)	ha	400.000
	-në pyje të rritur (mbi 10 cm diametër)	ha	650.000
	- në shkurre	ha	125.000

Shënim. Prerje në masë quhet prerja e mbi 50% të drurëve në njësi të sipërfaqes

3.	Dëmtim në çfarëdo mënyre i fidanëve, filizave e drurëve me diametër:		
	- deri në 2 cm	copë	320
	- nga 2.1-4 cm	copë	540
	- nga 4.1-6 cm	copë	760
	- nga 6.1-8 cm	copë	950

	- nga 8.1–10 cm	copë	1.250
	- nga 10.1–20 cm	copë	1.600
	- nga 20.1–30 cm	copë	2.200
	- nga 30.1–40 cm	copë	2.700
	- nga 40.1–60 cm	copë	3.200
	- mbi 60 cm	copë	5.400
4.	Dëmtim në masë mbi 50% të sipërfaqes me çfarëdo mënyre në pyllëzimet e reja, pyjet e rinj e fidanishte:		
	- në pyllëzimet e reja, pyjet e rinj e fidanishte	ha	320.000
	- në pyje të rritur (mbi 10 cm diametër)	ha	630.000
	- në shkurre	ha	108.000
5.	Dëmtim nga zjarri:		
a)	Kur vlerësohet materiali drusor:		
	- në trungishte	ha	250.000
	- në cungishte	ha	80.000
	- në shkurre	ha	50.000
	- në pyllëzime e fidanishte	ha	200.000
b)	Kur materiali drusor është i dëmtuar plotësisht:		
	- në trungishte	ha	1.500.000
	- në cungishte	ha	700.000
	- në shkurre	ha	400.000
	- në pyllëzime e fidanishte	ha	1.200.000
6.	Shpyllëzimi i fondit pyjor ose i pyjeve pa miratimin përkatës, pa përdorimin e tokës:		
	- në trungishte	ha	7.000.000
	- në cungishte	ha	4.000.000
	- në shkurre	ha	2.000.000
	- në pjesë të tjera të fondit pyjor	ha	1.500.000
7.	Zënie ose përdorim pa leje i fondit ose i pyjeve pa i dëmtuar ato:	ha	2.500.000
8.	Përvetësim dhe shitja pa leje:		
	- lëndë punimi	m ³	60.000
	- dru zjarri	mst	30.000
	- dru zjarri ngarkese kali	barrë	9.000
	- dru zjarri ngarkese gomari	barrë	6.000
	- dru zjarri ngarkese njeriu	barrë	3.500
	- hunj të ndryshëm deri në diametër 4 cm	copë	1.400
	- bandiera, bishta veglash, furde e furka, e të tjera si këto me diametër 4.1–12 cm	copë	4.000
9.	Prodhim, përvetësim dhe shitje pa leje		
a.	Fruta e fara:		
	- të njoma	kg	2.300
	- të thata	kg	4.500
b.	Rrëshirë pishe e katran	kg	1.200
c.	Fletë dafine:		
	- të njoma	kg	2.300
	- të thata	kg	4.500

d.	Bimë mjekësore e tanifere:		5.400
	- të njoma	kg	10.000
	- të thata	kg	
e.	Rrënjë e kucka shqope, mare, bushi e të tjera si këto	kg	10.000
f.	Thupra shëlgju e lloje të tjera të kësaj natyre:		
	- të njoma	kg	1.100
	- të thata	kg	2.000
	- të zhveshura	kg	3.000
g.	Qymyr druri, eshk kovaçi, e të tjera të kësaj natyre	kg	30.000
h.	Fuçi, kade, govata druri, e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia.	copë	15.000
i.	Kosha, shporta e të tjera të kësaj natyre prej thupra shëlgju e lloje të tjera pyjore, pavarësisht nga madhësia	copë	10.000
10.	Ndërtim pa leje i furrave të gëlqeres, kamina për qymyr druri, eshkë kovaçi, katrani e të tjera të kësaj natyre, pavarësisht nga madhësia	copë	8.000
11.	Dëmtimi ose zhdukja e objekteve të mbarështimit, gjeodezike e topografike dhe të tjera të kësaj natyre, në fondin pyjor	copë	5.400
12.	Dëmtimi ose zhdukja e ndërtimeve apo strehimeve për shtimin e gjahut e të tjera si këto, kudo që ndodhen	copë	10.800
13.	Dëmtimi ose zhdukja e pikave dhe kullave të vrojtimit për ruajtjen e florës dhe faunës nga sëmundjet, insektet dhe zjarret	copë	8.000
14.	Dëmtimi i rrethimeve në fondin pyjor ose vende të tjera si këto	ml	5.400
15.	Kryerja e germimeve ose punimeve të tjera në fondin pyjor për nxjerrjen e gurëve, rrës, zhavorrit, dheu, humusit, plisave të barit e të tjera si këto	m ²	7.000
16.	Hapja e gropave pa leje dhe mosmbulimi i tyre	m ³	4.500
17.	Shkulja e cungjeve pa leje	copë	27.000
18.	Hapja pa leje në fondin pyjor e guroreve e karrierave	m ²	45.000
19.	Hapja e rrugëve, linjave telefonike, telegrafike, televizive, gazsjellëse.	m ³	49.500

	naftësjellës, kanaleve, linjave të tensionit të lartë, ujësujellësve e të tjera të kësaj natyre në fondin pyjor, pa miratimin përkatës		
20.	Kullotja pa leje në fondin pyjor:		
	- për gjedhet	krerë	2.700
	- për të leshtat	krerë	1.350
	- për të dhirtat	krerë	1.800
	- për derrat	krerë	2.200
	- për shpendët	krerë	450
	- për njëthundrakët	krerë	2.200
21.	Kositja dhe grumbullimi pa leje në fondin pyjor të barit, gjetheve, krandeve e të tjera të kësaj natyre.	kV	3.500
22.	Vendosja emullarëve të çfarëdo lloji e madhësie pa leje në fondin pyjor dhe jashtë vendeve të miratuara	copë	2.700

SHTOJCA NR.3

TARIFAT PËR PRODHIMET DRUSORE DHE JO DRUSORE PYJORE, PËR GRUMBULLIMIN DHE NXJERRJEN E PRODHIMEVE TË DYTA PYJORE DHE JO PYJORE

3/1 Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë

Nr. rendor	Emërtimi	Njësi matje	Tarifa (lek)	
			E hollë deri 22 cm	E mesme dhe e trashë mbi 22 cm
	I. Lëndë punimi në këmbë			
	a) Halorë			
1	Pishë e zezë	m ³	3 000	3 500
2	Pishë mesdhetare (pishë e butë, pishë e egër, pishë deti)	m ³	2 500	3 200
3	Bredh	m ³	3 500	4 500
	b) Fletorë			
1	Ah	m ³	2 000	3 500
2	Dushk	m ³	2 500	4 000
	II. Dru zjarri			
	a) Të forta			
1	Dushk, ah, panjë, frashër, rrap, akacie, lofatë, gështenjë, mare, shkozë, mëllezë, bli. lajthi, thanë, bush.	m ³		600
	b) Të buta	m ³		
1	Halorë, shelg, plep dhe vërri			250

3/2. Tarifat bazë të lëndës drusore në këmbë, për llojet industriale

Nr. rendor.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifa (lekë)
	Lëndë druri në këmbë		
I	Arrë, gështenjë, panjë, vidh	m ³	7 000

2	Carac, eukalipt, man, mëllezë, plep, rrap, shëlg, shkozë	m ³	3 000
3	Bli, frashër, vërrë	m ³	5 000

3/3. Tarifat për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta

Nr. rend.	Emërtimi	Njës. e matj.	Tarifa (lek)
A.	Grumbullim në fondin pyjor:		
1.	Fashina, shkarpa	Mst	35
2.	Mbeturina pylli të çdo lloji	m ³	40
3.	Thupra të çdo lloji	kV	55
4.	Kucka, rrënjë	kV	100
5.	Cungje	m ³	150
6.	Hunj	copë	60
7.	Bandiera	copë	100
8.	Eshkë kovaçi	kV	500
9.	Katran	kV	700
10.	Rrëshirë pishe	kV	350
11.	Bar për blegtorinë	kV	20
12.	Gjethe për blegtorinë	kV	200
13.	Lule të ndryshme	kV	450
14.	Gjethe të ndryshme	kV	150
15.	Rrënjë të ndryshme	kV	250
16.	Herba të ndryshme	kV	200
17.	Fruta, fara dhe sytha	kV	500
18.	Lëvore	kV	350
19.	Kërpudha	kV	2 500
20.	Boçe të ndryshme	kV	500
21.	Degë të gjelbra, me dhe pa lule, për buqeta	kV	1000
B.	Nxjerrja ose grumbullim në sipërfaqen e fondit pyjor:		
a)	Gurë, rrëzë dhe zhavorr	m ³	35
b)	Dhedhe humus	m ³	200
c)	Prodhim qymyr druri në sipërfaqen e fondit pyjor	kV	100

Shënim . Tarifat e germës a, të pikës B të përdoren vetëm në rastin kur grumbullimi i materialeve të ndërtimit bëhet nga banorët e zonave rurale, për nevojat e tyre vetjake.

Në mbeturinat e pyllit do të futet vetëm ai material drusor (i kalbur, gjysmë i kalbur), i cili nuk plotëson parametrat për dru zjarri.

3/4. Tarifat e shitjes së pemëve të krishtlindjeve dhe të vitit të ri .

Nr. rend.	Specifikimi	Njësia e matjes	Tarifa (lek)
1.	me lartësi deri në 1 m	copë	1 000
2.	me lartësi 1 deri 3m	copë	2 000
3.	me lartësi 3 deri 5 m	copë	3 000
4.	me lartësi 5 deri 7 m	copë	5 000
5.	me lartësi mbi 7 m	copë	10 000

3/5. Tarifat e shitjes së fidanëve nga ripërtëritja natyrore, e shpatullave dhe e kalemave.

Nr. rend.	Emërtimi	Njësia e matjes	Tarifa (lek)
1.	Fidanë, shpatulla dhe kalema:		

- me moshë 1-vjeçare	copë	10
- me moshë 2-vjeçare	copë	30
- me moshë mbi 2-vjeçare	copë	50

VKM –ja nr.559 datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim / përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ” (e ndryshuar), përcakton se :

1. Miratimin e çmimeve dhe tarifave për veprimtaritë që zhvillohen në Fondin Pyjor Kombëtar, sipas përcaktimeve të këtij vendimi dhe shtojcave, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, si më poshtë vijon:

a) Për dhënien në shfrytëzim/përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar dhe për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në fondin pyjor nga shfrytëzimi/përdorimi i tij.

b) Për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore dhe për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jopyjore:

2. Tarifat për dhënien në përdorim të Fondit Pyjor Kombëtar janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Tarifat dhe çmimet për shfrytëzimin e Fondit Pyjor Kombëtar janë sipas shtojcës 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Tarifat për sipërfaqet, që shfrytëzohen për heqjen nga Fondi Pyjor Kombëtar, përcaktohen duke marrë në konsideratë:

a) investimet e kryera për pyllëzimin (ripyllëzimin), si dhe ato gjatë periudhës së rritjes, në sipërfaqen që hiqet nga Fondi Pyjor Kombëtar;

b) shpenzimet e kryera për mbrojtjen e tokës, për shfrytëzim të qëndrueshëm dhe produktiv;

c) shpenzimet për ndërtimin e infrastrukturës përkatëse;

ç) vlerën e burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese (lënda drusore, flora spontane, fauna e egër, kullota etj.), si produkt i humbur;

d) investimet që do të kryhen për pyllëzimin (ripyllëzimin), për sipërfaqen që do të zëvendësojë sipërfaqen e hequr nga Fondi Pyjor Kombëtar.

5. Tarifat dhe çmimet për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore, për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jopyjore janë sipas shtojcës nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Për shitjen e lëndës drusore në këmbë, lëndë punimi dhe dru zjarri për njësi/m³ dhe materialit drusor të asortuar, që shitet në anë të rrugës, çmimi i shitjes përcaktohet, sipas çmimeve të tregut, por jo nën çmimin e kostos së prodhimit, e cila llogaritet sipas tarifave të kësaj shtojce .

❖ **BAZA LIGJORE** : Ligji Nr.57 / 2020, datë 30.4'2020 " Për pyjet " (i ndryshuar) ; VKM Nr.1353, date 10.10'2008 " Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kriterëve e procedurave të zvogëlimit të sipërfaqës të vëllimit të fondit pyjor " (i ndryshuar) ; VKM Nr.108, datë 27.01'2009 " Për kriteret e cilësimit të shkeljeve, me pasoja të rënda, në pyje " ; VKM –ja nr.559 datë 29.7.2022 “ Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim / përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore ” (e ndryshuar) ; VKM Nr.433, date 08.06'2016 " Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish – Komunave / Bashkive " ; VKM Nr.438, datë 08.06'2016 " Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore " (i ndryshuar) ; Udhëzimi Nr.4, date 12.9'2008 " Për mbajtjen e kadastrës së Fondit Pyjor dhe Kullosor " ; Udhëzimi Nr.1, datë 9.6'2016 " Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të Fondit Pyjor dhe Kullosor Publik ", Udhëzimi Nr.2, datë 3.3'2017 " Për kërkesat teknike të caktimit të ngastrave, grupngastrave dhe ekonomive pyjore për trajtime me prerje rigjeneruese , rregullat për vjeljen e materialit drusor me qëllim sigurimin e druve të zjarrit për ngrohje ".

DETYRIMI PËR PAGESËN :

Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki, është strukturë e specializuar në nivel vendor, me attribute menaxhuese, kontrolluese/inspektuese, teknike dhe këshillimore, që administron fondin pyjor kombëtar në pronësi, si dhe lëshon/pezullon/shfuqizon lejet për ushtrimin e aktivitetit për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për subjektet e interesuara.

Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki, harton planin për shfrytëzimin e fondit pyjor e kullosor në të gjithë territorin e bashkisë Pukë, ku përcakton zonen, sipërfaqen, periudhën dhe qëllimin e lejuar të shfrytëzimit mbështetur në legjislacionin për fondin pyjor e kullosor të ndryshuar, si dhe akteve tjera nënligjore në zbatim të ligjit.

Struktura përgjegjëse për qeverisjen e pyjeve në bashki, merret me administrimin e fondit pyjor e kullosor dhe bazuar në planin e hartuar, bën përllogaritjet e sipërfaqeve për shfrytëzimin / ndërtimin etj... si dhe nënshkruan kontratat e qirasë me subjektet kontraktore që kanë paraqitur kërkesën për shfrytëzim të sipërfaqeve nga fondi pyjor e kullosor, monitoron dhe ndjek shlyerjen e detyrimit që rrjedhin nga lidhja e kontratave me palet kontraktore në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi.

STRUKTURA PËRGJEGJËSE PËR VJELJEN E TARIFËS : Organi përgjegjës për vjeljen e të ardhurave në sektorin e pyjeve e kullotave është struktura përgjegjëse për pyjet në bashki, ndërsa procedura e mbledhjes së tyre apo ekzekutimit të detyrueshëm rregullohet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative. Zyra e Taksave dhe Tarifave Vendore, me autorizim të strukturës përgjegjëse në bashki për pyjet e kullotat, lëshon faturen për arketim me qëllim arkëtimin e të ardhurave nga shfrytëzimi i fondit pyjor e kullosor si dhe ndjek vjeljen e tyre në bashkëpunim me sektorin e shërbimit pyjor dhe sektorin juridik pranë bashkisë Pukë.

KAPITULLI III – të :

TË ARDHURA JO TATIMORE :

TË ARDHURA NGA DHËNIA ME QIRA E ASETEVE NË PRONËSI TË BASHKISË .

Sipas përcaktimeve ligjore pasuritë që jepen me qira janë ndërtesat, trualli i lirë, funksional (jo ndërtesë), makineritë e paisjet dhe linjat e prodhimit.

Të ardhurat nga qiratë paguhen nga përfituesi dhe shfrytëzuesi i pronës në pronësi të bashkisë, bazuar në kontratën e lidhur mes palëve.

Drejtoria Juridike, Njësia e Prokurimit, dhe sektori i Aseteve kryejnë procedurën e plotë të dhënjes me qira deri në hartimin e kontratës dhe kërkojnë lëshimin e faturës nga ana e Zyrës Tatimore Vendore. Ndjekja dhe zbatimi i kontratës kryhet nga Sektori i Aseteve.

-Për objektet pronë e qeverisjes vendore, që jepen me qira vjetore, të zbatohet VKM Nr. 54, datë 05.02.2014 " Për përcaktimin e kriterëve, dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore " (i ndryshuar).

TË ARDHURA NGA SEKUESTRIME DHE ZHDËMTIME :

Bazuar në Ligjin Nr.10296 : datë 08.07'2010, " Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ", si dhe Udhëzimin nr.30, datë 27.12'2011, " Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik " (i ndryshuar), të gjitha njësitë e sektorit publik kanë detyrimin të marrin masat e nevojshme për dokumentimin, mbrojtjen, qarkullimin dhe nxjerrjen nga përdorimi i aktiveve, më qëllim menaxhimin me efektivitet dhe ruajtjen e tyre nga dëmtimi dhe keqpërdorimi . Nëpunësit Autorizues të të gjithë niveleve të njësive publike kanë detyrimin që të kryejnë të gjitha analizat deri në vlerësimin për ngarkim të shkaktarëve që lejojnë veprime abuzive në trajtimin e aktiveve .

TË ARDHURA NGA SHITJA E MALLRAVE DHE E SHËRBIMEVE :

Sipas përcaktimeve ligjore janë të ardhura që përfshihen në zërin të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve. Aktivitet që pas vlerësimit nxirren jashtë përdorimit, kur mund të përdoren si vjetërsira / mbeturina / materiale të riciklueshme, hiqen nga regjistri i aktiveve në përdorim, bëhen hyrje në magazinë dhe u shiten me ankand ndërmarrjeve që i grumbullojnë.

TË ARDHURA NGA SHITJA E AKTIVVE TË QËNDRUESHME TË TRUPËZUARA :

Sipas përcaktimeve në ligjin " Për vetëqeverisjen vendore ", akteve normative dhe procedurave ligjore, Bashkitë krijojnë të ardhura nga shitja e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara.

PËRCAKTIME :

✓ **Si të regjistrohen qytetarët për taksat vendore ;**

Çdo subjekt taksapagues ka detyrimin ligjor që 15 ditë nga momenti i regjistrimit pranë Q.K.B të dorëzoj

dokumentacionin e plotë pranë Zyres Tatimore Vendore, si mëposhtë vijon:

1. Fotokopje NIPT
2. Ekstrakt nga Q.K.B.
3. Fotokopje e kartës së identitetit
4. Kontratë qeraje ose dokument i pronësisë (bashkëlidhur kartelë, planimetri, planvendosje e objektit)

✓ **Si të regjistrohen bizneset pranë Zyres Tatimore Vendore për taksat vendore ;**

Çdo subjekt taksapagues ka detyrimin ligjor që 15 ditë nga momenti i regjistrimit pranë Q.K.B, të dorëzoj dokumentacionin e plotë pranë sporteleve tona, si mëposhtë vijon:

1. Fotokopje NIPT
2. Ekstrakt nga Q.K.B.
3. Fotokopje e kartës së identitetit
4. Statuti dhe kopje e Aktit të Themelimit për bizneset me status (Biznes i madh, VIP, SHPK dhe OJF)
5. Kontratë qeraje ose dokument i pronësisë (bashkëlidhur kartelë, planimetri, planvendosje e objektit)

✓ **Si të regjistrohen OJQ dhe Ente në Zyren Tatimore Vendore për taksat vendore ;**

Për tu regjistruar si O.J.Q. apo Ent, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, ju duhet të dorëzoni pranë sporteleve tona të asistencës dokumentat si më poshtë:

1. Fotokopje e NIPT
2. Statuti dhe kopje e Aktit të Themelimit
3. Vendim Gjykatë
4. Fotokopje e kartës së identitetit të administratorit
5. Kontratë qeraje ose dokument i pronësisë (bashkëlidhur kartelë, planimetri, planvendosje e objektit).

Për të gjitha subjektet që aplikojnë për çregjistrim ose pezullim deri në datën 20 Shtator, që është afati i fundit ligjor për shlyerjen e detyrimeve të subjekteve, ngarkesa për tarifatat do të jetë përpjestimisht nga data 01 Janar e vitit fiskal deri në datën e aplikimit të çdo subjekti, por me afat veprimi deri në 20 Shtator sipas përcaktimit të mësipërm, me përjashtim të rasteve kur konstatohet ndryshe nga Sektori i Kontrollit Zyra Tatimore Vendore (kur subjekti ushtron aktivitet edhe pas aplikimit për çregjistrim), në rast të tillë, ngarkesa do të jetë vjetore.

Edhe për subjektet që alikojnë për çregjistrim apo pezullim pas datës 20 Shtator dhe nuk kanë paguar detyrimet brenda afatit ligjor të shlyerjes së tyre, ngarkesat për tarifatat do të jetë vjetore.

Për të gjitha subjektet e reja ngarkesa për tarifatat do të jetë nga data e hapjes së aktivitetit pranë QKB deri në fund të vitit fiskal .

Për subjektet tregtare, kategoria “ biznes i madh dhe i vogel ” , që kryejnë **aktivitet sezonal**, ngarkesa për tarifatat do të jetë nga data e riaktivizimit në QKB deri në pezullimin apo çregjistrimin e aktivitetit të tyre, me përjashtim të rasteve kur konstatohet ndryshe nga sektori i kontrollit Zyra Tatimore Vendore (kur subjekti vazhdon të ushtrojë aktivitet dhe pas aplikimit për çregjistrim) ngarkesa do të jetë vjetore.

Për subjektet tregtare, kategoria “ biznes i madh dhe i vogel ” , të cilët për arsye objektive kryejnë **veprime për mbyllje** në QKB (aplikim për çregjistrim ose pezullim aktiviteti) **brenda muajit**, ngarkesa për tarifatat do të jetë vetëm për atë muaj pasi nuk kanë konsumuar ushtrimin e aktivitetit me përjashtim të rasteve kur konstatohet ndryshe nga sektori i tatimeve (kur subjekti vazhdon të ushtrojë aktivitet edhe pas aplikimit për çregjistrim/pezullim) ngarkesa do të jetë vjetore .

PËRCAKTIMI I VENDNDODHJES SË BIZNESIT :

Tatimpaguesit e biznesit të vogël apo i madh janë të detyruar të paguajnë tarifatat dhe taksat vendore mbi biznesin për çdo vendndodhje biznesi, në përputhje me nivelin e tarifave dhe taksave vendore të përcaktuara për llojin e biznesit sipas vendimit të Këshillit Bashkiak.

Bizneset nënadministrimin e të njëjtit taksapagues që ushtrohen në një vendndodhje (në një godinë) do të taten dhe tarifohen si vendndodhje biznesi me vete.

Një " Vendndodhje biznesi " është një zonë e dallueshme dhe e ndarë si në të njëjtën godinë, ashtu edhe në godina të ndryshme

Për shembull :

- a) Kur veprimtari të ndryshme ekonomike kryhen nga një taksapagues në të njëjten dhomë, konsiderohen si një vendndodhje e një biznesi .
- b) E njëjta veprimtari ekonomike e kryer nga një taksapagues në dy dhoma , që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen një biznes, pra konsiderohen si një " vendndodhje biznesi " .
- c) Dy veprimtari të ndryshme ekonomike të kryera nga një tatimpagues në dy dhoma që kanë komunikim nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy " vendndodhje biznesi " .
- d) Disa veprimtari ekonomike të ndryshme ose e njëjta veprimtari ekonomike e kryer në dy dhoma fqinje, që nuk komunikojnë me njëra - tjetren nga brenda, konsiderohen dy biznese, pra konsiderohen si dy " Vendndodhje biznesi " .

ANKIMIMI : Taksapaguesit kanë të drejtë të deklarojnë pasuritë e paluajtshme në pronësi apo përdorim. Në rast se vlera e deklaruar është e ndryshme nga vlera e llogaritur me çmimin e vlerësuar si vlerë e bazës së taksës merret vlera më e lartë . Çdo taksapagues ka të drejtë të ankohet me shkrim për shumën dhe menyren se si janë vlerësuar detyrimet e tij, të kërkojë rimbursime si dhe të apelojë kundër çdo veprimi ose mosveprimi nga strukturat përkatëse në bashkinë Pukë .

Taksapaguesi ka të drejtë të korigjojë të dhënat në lidhje me llogaritjen e taksës së ndërtesës duke bërë një kërkesë për korigjim në zyrën tatimore ose zyrën e agjentit të mbledhjes së taksës. Zyra tatimore brenda 30 ditëve bën shqyrtimin e kërkesës. Nëse pas marrjes së përgjigjes taksapaguesi nuk bie dakord, ai ka të drejtë që bazuar në nenin 7 të ligjit nr.9632 datë 30.10'2006 " Për sistemin e taksave vendore " (i ndryshuar) t'i drejtohet strukturës vendore të apelimit tatimor . Shkalla e fundit e ankimit është Gjykata Administrative.

Ankimimi paraqitet me shkrim pranë bashkisë Pukë brenda 30 ditëve nga marrja e dëgjimit për aktin administrativ, dhe përmban :

- Emrin, adresën dhe NIPT-in e apeluesit ;
- Vitin tatimor, me të cilin lidhet apelimi ;
- Natyren dhe Shumën e tatimit ose gjobës që është subjekt apelimi ;
- Baza ku mbështetet apelimi ;

Në rastin e paraqitjes së ankimit, duhet përmbushen kriteret e mëposhme :

- Subjekti duhet të përmbushë kërkesat e ligjit për parapagimin e detyrimeve përpara depozitimit të ankimit administrative .
- Procedura e apelimit dhe procedura e shqyrtimit të apelimit tatimor, bazohen në përcaktimet e bëra në Ligjin " Për Procedurat Tatimore " dhe të Udhëzimit të Ministrisë së Financave në zbatim të tij.
- Komisioni i Apelimit Tatimor shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të ankimit .
- Kundër vendimit të komisionit, subjekti ka të drejtë të ankohet në Gjykatën Administrative brenda afateve ligjore nga çasti i marrjes në dëgjim për vendimin e mësipërm .

LLOJET DHE NIVELET E GJOBAVE QË DO TË VENDOSEN NGA POLICIA BASHKIAKE NË RASTET E SHKELJEVE DHE KUNDRAVAJTJEVE ADMINISTRATIVE.

Bazuar në ligjin nr. 139 /2015, " Për vetëqeverisjen vendore ", ligjin nr. 8224, datë 15.05'1997, " Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake " (i ndryshuar) me ligjin nr. 8335, datë 23.04'1998, ligjin nr. 107/2014, datë 31.07.2014, " Për planifikimin e territorit " (i ndryshuar) , ligjin nr. 10465, datë 29.09'2011, " Për shërbimin veteriner në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar) , ligjin nr. 9920, datë 19.05'2008, " Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar) , ligjin nr. 10279, datë 20.05'2010, " Për kundravajtjet administrative " (i ndryshuar) , nenin 6/b, nenin 7/3, 10/3 e në vijim ..., njësia vendore (bashkia) ka të drejtë të vendosë nëpërmjet Këshillit Bashkiak, llojet e gjobave dhe nivelin e tyre deri në 20.000 lekë . Në rastet kur kundravajtjet administrative parashikohen në aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak , masa e dënimit përcaktohet në këto akte . Në çdo rast masa e dënimit nuk mund të jetë më e madhe se 20.000 lekë .

1. Gjoba nga kontrollet dhe inspektimet tatimore.	Sipas ligjit Nr.9920, dt.19.5'2008 "Për Procedurat Tatimore në R.Sh" (i ndryshuar) dhe VKB - ve ;
2. Niveli i gjobave për kryerjen e aktivitetit tregëtar pa licencë, autorizim apo leje përkatëse.	

a. Mospajisja me liçensë, autorizim apo çertifikatë përkatëse transporti :	
• transport udhëtarësh taksi (1+4)	10.000 lekë
• transport udhëtarësh taksi (1+8)	15.000 lekë
• transport udhëtarësh me autobus	15.000 lekë
• mjete të tonazhit të lartë	20.000 lekë
• hyrja pa autorizim në rrugët kryesore të qytetit për mjetet e tonazhit të mesëm dhe të lartë	15.000 lekë
• lëvizja e automjeteve në linja ndërqytetase dhe rrethqytetase që nuk respektojnë dispozitat ligjore.	10.000 lekë
b. Mospajisje me liçensë për tregëtimin me pakicë të karburanteve dhe njësive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombulave të gazit të lëngshëm.	20.000 lekë
c. Mospajisje me leje për tregëti ambulante, kantinë	10.000 lekë
ç. Mos pajisje me leje për shërbim me tavolina jashtë lokalit në hapësirë publike (trotuar, sheshe e.t.j) .	10.000 lekë
d. Mospajisje me leje për ushtrim aktiviteti "24 orësh" mbas orarit të lejuar.	10.000 lekë
dh. Mospajisje me leje për zënie të hapësirës publike :	
✓ Veprimtarive (ekspozim malli, promocione, panairë, ekspozita dhe evente të ndryshme) të cilat do të zhvillohen në hapësirat publike .	10.000 lekë
✓ Zënie hapësirë publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit .	
✓ Zënie hapësirë publike nga tregtarët ambulantë.	
✓ Rezërvim i parkingut pa leje nga bashkia . .	
e. Mospajisje me leje për vendosje reklame :	
• E thjeshtë	10.000 lekë
• Elektronike	10.000 lekë
ë. Shfrytëzim i hapësirave publike për vendosjen e antenave të kompanive celulare, internetit, TV etj pa leje .	20.000 lekë
f. Vendosja pa leje e antenave valore për kompanitë celulare dhe radiotelevizive .	5.000 lekë
g. Mosrespektim i tabelave të qarkullimit rrugor, dhe tabelave të tjera kufizuese të vendosura nga organet kompetente .	5.000 lekë
gj. Ndotje akustike (zhurma të krijuara nga altoparlantë, bori etj të ngjashme me to .	10.000 lekë
h. Mosmarrja e masave për izolimin e zhurmave nga ambjentet e lokalit /restorantit .	
Në rastet e konstatimit të muzikës me këngëtare ose me aparatura të dixhitalizuara në individualizim të çdo subjekti që operon me aktivitet tregëtar (bar – kafe, bar – restorant e.t.j) , përveç rasteve të pajisura me leje nga Bashkia .	
3. Niveli i gjobave për dëmtim dhe ndërhyrje në infrastrukturën rrugore pa leje të posaçme.	
a. Dëmtim rruge	20.000 lekë
b. Bllokim rruge	20.000 lekë
c. Dëmtim bordure	20.000 lekë
ç. Dëmtim trotuari	20.000 lekë
d. Bllokim trotuari	20.000 lekë
dh. Dëmtim, bllokim, vjedhje pusete	20.000 lekë
4. Ndotje të rrugëve nga mjetet e transportit për punimet në qytet	

a.përsona juridikë	20.000 lekë
b.përsona fizikë	15.000 lekë
c.qytetarë	10.000 lekë
5.Niveli i gjobave për ndotje e ambjentit / hapësirës publike është :	
5/1.Hedhje e mbetjeje urbane në rrugë,trotuar,kudo në hapësirën publike,jashtë vendeve të përcaktuara :	
a.përsona juridikë	20.000 lekë
b.përsona fizikë	15.000 lekë
c.qytetarë	10.000 lekë
5/2.Hedhje inerte në vende të pamiratuara :	
a.përsona juridikë	20.000 lekë
b.përsona fizikë	15.000 lekë
c.qytetarë	10.000 lekë
6.Niveli i gjobave për dëmtimet dhe ndërhyrjet në rrjetin e shpërndarjes dhe ndriçimit rrugor pa lejë të posaçme.	
a. Lidhje në rrjetin ajror të ndriçimit publik	20.000 lekë
b. Dëmtim i shtyllave të ndriçimit publik	20.000 lekë
c. Dëmtim i ndriçuesve të ndriçimit publik	20.000 lekë
ç. Përdorimi i shtyllave të rrjetit shpërndarës apo ndriçimit rrugor si suport për montimin e reklamave, kapjen e kabllove etj.	20.000 lekë
d. Ndërhyrje në kuadrot elektrik publik	20.000 lekë
dh. Dëmtim i traseve, kabllove dhe linjave ajrore nga punimet që kryhen pranë tyre me leje dhe pa leje si dhe shkulja e shtyllave.	20.000 lekë
7. Niveli i gjobave për dëmtime dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit.	
a. Lidhje e pa miratuar në tubacion	20.000 lekë
b. Dëmtim i pusetave	20.000 lekë
c. Dëmtimi i tubacioneve nga punimet që kryhen pranë tyre me leje ose pa leje.	20.000 lekë
ç. Dëmtimi i matësave të ujit të pijshëm	20.000 lekë
8. Niveli i gjobave për ndërhyrje dhe dëmtime në hapësirat e gjelbërta publike.	
a. Dëmtim i hapësirave publike të gjelbërta	20.000 lekë
b. Dëmtim, prerje, krasitje e pemëve	20.000 lekë
c. Zënie e hapësirës së gjelbër pa leje	20.000 lekë
ç. Vendosje tabelash, pankartash, banderolash, posterash, njoftimesh në pemet dekorative .	10.000 lekë
d. Mos ndërtimi i bazamenteve të kontenierëve të mbetjeje urbane të subjekteve të ndërtimit për objektet mbi 5 kate.	20.000 lekë
dh. Hedhje e mbeturinave jashtë pikave të përcaktuara të depozitimit të mbetjeje organike, inetre, e.t.j.	20.000 lekë
e .Në rast të mosmarrjës së masave për izolimin e kafshëve të luksit	5.000 lekë
9.Niveli i gjobave per sektorin e kontrollit veterinar.	
a. Për mishin e therur të tregëtuar të pa çertifikuar nga sektori i kontrollit veterinar .	10.000 lekë
b. Mbajtja e kafshëve të prodhimit brenda territorit të Njësisë Administrative Pukë.	10.000 lekë

c. Në rast të mosmarrjes së masave për izolimin kafshëve të luksit	5.000 lekë
ç. Në rast të mbajtjes së bletëve, lepujve, shpendëve (pula, pata, pëllumba, e.t.j të ngjashme me to) në ambientet e banesave kolektive apo banesave individuale brenda territorit të Njësisë Administrative Pukë.	10.000 lekë
d. Në rast të konstatimit të tregëtimit të kafshëve të prodhimit jashtë tregjeve të miratuara nga Bashkia Pukë.	5.000 lekë
dh. Në rast të konstatimit të therrjeve të kafshëve të prodhimit jashtë vendeve të përcaktuara nga Bashkia Pukë.	10.000 lekë
10. Niveli i gjobave për inspektorët e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore.	
a. Mos deklarim i personave që kërkojnë strehim kundrejt pagesës në subjektet me emërtim hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim dhe numri i netëve të qëndruara në hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër.	20.000 lekë
11. Niveli i gjobave për mosrespektim të kushteve në shërbimin e transportit të udhëtarëve.	
a. Mos vendosja e emërtimit të linjës	5.000 lekë
b. Mos respektimi i intenerarit, orarit dhe qëndrimi jashtë stacionit të miratuar .	10.000 lekë
12. Të tjera gjoba ...	
a. Dëmtimi i fasadave dhe ndërhyrja në çati.shkallë,themele e tjera të ngjashme me to pa leje nga strukturat e veçanta pranë Bashkisë Pukë .	10.000 lekë
b. Zënia e hapsirave të përbashkëta në pallate si shkallë, koridore e tjera të ngjashme me to me dru zjarri apo sende .	5.000 lekë
c. Kullotja e bagëtive në hapësirat e gjelbërta (lulishtet e qytetit) .	5.000 lekë
ç. Kullotja e bagëtive në varreza publike dhe mjedise të tjera të gjelbërta brenda qytetit .	10.000 lekë
d. Ndotja e mjediseve dhe hapësirave publike nga bagëtit në qytet .	5.000 lekë
dh.Ndotja e mjediseve nga djegja e inerteve apo materialeve plastike apo të ndryshme .	5.000 lekë
e. Bllokimi i daljeve emërgjente të pallatit nga banorët .	5.000 lekë
ë. Vëndosja e çistërname të ujit në taracat e pallateve të banimit .	5.000 lekë
f. Ndërhyrja në banesa , pallate etj te ngjashme me to për meremetime , punime te ndryshme nga familjarët pa lejen përkatëse të lëshuar nga strukturat kompetente pranë B.Pukë .	5.000 lekë
13. Mosrespektimi i rregullave të qarkullimit rrugor	
a. Parkim i gabuar (neni 7 i Ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998) Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar .	1.000 lekë
b. Qarkullimi i mjetit duke shkelur rregullat e qarkullimit (sinjalistiken)	1.000 lekë
c. Mosmarrja e mjetit me karrotrec sipas përcaktimeve të Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë i ndryshuar .	5.000 lekë

Shënim : Për vendosjen e gjobave lidhur me poseduesit e mjeteve të transportit rrugorë që nuk janë përmendur në këtë vendim, Policia Bashkiake t'i referohet Ligjit nr. 8378 datë 22.07.1998 (Kodi Rrugor i rrepublikës së Shqipërisë (i ndryshuar) .

✓ Detyrimi për zbatimin e Paketës Fiskale të vitit 2026

- a) Struktura e ngarkuar për mbledhjen e këtij detyrimi është Zyra Tatimore Vendore në Bashkinë Pukë dhe të gjitha drejtoritë dhe zyrat të cilat lidhen me zbatimin e elementëve të kësaj Paketë Fiskale.
 - b) Për të gjithë rastet e gjobave për kundravajtjet e konstatuara ngarkohet për vendosje dhe arkëtim Policia Bashkiake e cila për kundravajtje dhe gjoba brenda kuadrit ligjor të policisë bashkiake koordinon veprimtarinë e saj me Policinë e Qarkullimit Rrugor dhe të Rendit.
 - c) Mbajtja dhe kontabilizimi gjobave dhe sanksioneve bëhet nga Zyra e Financës në Bashki.
- II. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Zyra e Tatim Taksave (Zyra Tatimore Vendore) si dhe të gjitha drejtoritë .
- III. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes, sipas nenit 55 pika 6, e ligjit 139 /2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore ”.
- IV. Vendimi u shpall me date **12. 02.2026**.

Vota te vlefshme gjithsej 9

Vota pro 9, Vota kunder 0 , Vota abstenim 0

SEKRETARI

Hazbi Terbuni



KRYETARI

Gjon GJOKA



02.03.26

H. Duda
Gj. Nëntori
Shkodër



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

145/1
Nr. .prot.

Shkodër, më 25.02.2026



Lënda: Mbi vendimin Nr.6 datë 11.02.2026 të Këshillit të Bashkisë Puke.

KËSHILLIT TE BASHKISE PUKE

Prefekti përcaktuar në dispozitat e ligjit Nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut" i ndryshuar, ligjit Nr.139/2015 "Për Vetqeverisjen Vendore" i ndryshuar, 54/f, neni 55/3, neni 64 germa c, Udhërit të Kryeministrit nr.21/2025 "Për detyrat e administratës së Prefektit", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.39/2025 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut si dhe aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", Ligjit Nr.9632 dt.30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar, VKM Nr.132 dt. 7.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "Ndërtesa" e bazës së taksës për kategoritë specifike, natyrën dhe prioritet e informacionit dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës" i ndryshuar, Shkresës Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë (Drejtoria e Metodologjisë dhe Ligjore) Nr.30/2prot datë.6.05.2025, Dokumentacionit të dërguar nga Sekretari i Këshillit Bashkiak Puke Nr.213/4prot datë.12.02.2026, **shqyrtoi VKB Puke Nr.6 dt.11.02.2026: "Mbi miratimin e paketës fiskale për vitin 2026"**.
Prefekti ju autorizon të procedoni konform procedurave të mëtejshme ligjore.
Duke ju falënduar për bashkëpunimin.

